



**UNIVERSITETI “HAXHI ZEKA”
Fakulteti i Agrobiznesit**

Plani Strategjik 2023-2026

PËRMBAJTJA

Përmbajtja.....	2
Shkurtesat.....	5
Fjala e Dekanit për Planin Strategjik 2023-2026.....	6
Hyrja dhe Qëllimi.....	7
Metodologjia e Hartimit të Planit Strategjik.....	8
I. Fakulteti i Agrobiznesit.....	11
1. Informacionet themelore mbi fakultetin.....	11
2. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e Fakultetit të Agrobiznesit.....	14
3. Modeli i integritit funksional të FAG-të.....	17
3.1.Organizimi i FAG-it sipas parimit të fakultetit të integruar.....	18
II. ANALIZA E MJEDISIT TË PLANIT STRATEGJIK 2023-2026 / FAG.....	19
Hyrje.....	19
1. Analiza e tregut të punës.....	20
1.1. Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas grup moshave.....	20
1.2. Punësimi sipas profesioneve.....	21
1.3. Programet studimore të FAG-it dhe tregu i punës.....	23
1.4.Vlerësimi bazë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të FAG-të.....	24
1.5.Përmbledhje e të gjeturave	26
1.6. Sfidat e arsimit të lartë	27
2. Analiza e konkurrencës si pjesë e planit të zhvillimit strategjik të FAG-të	28
2.1. IAL-të publike dhe private	28
2.2. Fakulteti i Agrobiznesit pranë Universitetit “Haxhi Zeka”	31
2.3. Universiteti “Hasan Prishtina” - Prishtinë	32
2.4. Universiteti “Isa Boletini” – Mitrovicë	33
2.5. Universiteti “Ukshin Hoti” – Prizren	34
2.6. Kolegji “AAB”	34
2.7. Kolegji “UBT”	35

2.8. Kolegji “Universum”	36
2.9. Kolegji “Biznesi”	36
2.10. Kolegji “ICBM” - Mitrovicë	37
2.11. Matrica e krahasueshmërisë së programeve.....	38
3. Analiza e bazës ligjore	38
4. Analiza e profilit të Fakultetit	42
4.1. Vendndodhja e Fakultetit.....	42
4.2. Historiku i shkurtër i Fakultetit të Agrobiznesit.....	43
4.3. Aktet juridike të FAG-it.....	46
4.4. Struktura organizative e FAG-it.	47
4.5. Burimet njerëzore	49
4.5.1.Publikimet e aktiviteteve kërkimore-shkencore	50
4.6. Infrastruktura e FAG-së	50
4.7. Objektet.....	52
4.8. Pajisjet	53
4.9. SEMS-i	54
4.10.Studentët, numri aktual dhe pritshmeritë	54
5. Analiza SWOT – Fakulteti i Agrobiznesit.....	66
5.1. Krahasimi me fakultetet e tjera	68
5.2. Identifikimi i faktorëve kritikë të suksesit	70
III. Analiza e gjendjes se objektivave strategjike	71
1. Prioritetet strategjike	71
1.1.PRIORITETI STRATEGJIK 1 – Menaxhimi i brendshëm	72
1.2.PRIORITETI STRATEGJIK 2 - Mësimdhënia	73
1.3.PRIORITETI STRATEGJIK 3 – Sigurimi i cilësisë	77

1.4.PRIORITETI STRATEGJIK 4 – Shkenca, kërkimet dhe arti	80
1.5.PRIORITETI STRATEGJIK 5 – Ndërkombëtarizimi	83
1.6.PRIORITETI STRATEGJIK 6 – Studentët	88
1.7.PRIORITETI STRATEGJIK 7 – Ndërmarrësia	90
1.8.PRIORITETI STRATEGJIK 8 – Infrastruktura.....	93
IV. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI	95
1. Mekanizmat për zbatim	95
1.1. Monitorimi dhe raportimi.....	96
V. Buxheti i strategjisë	96
VI. PËRFUNDIME	98
VII. SHTOJCA 1: PLANI I VEPRIMIT	99
VIII. SHTOJCA 2: BUXHETI I STRATEGJISË	109

SHKURTESAT

UHZ	Universiteti “HAXHI ZEKA”, Pejë
PSFAG	Plani Strategjik i Fakultetit të Agrobiznesit
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
QE	Qendra për Ekselencë
ISHA	Instituti për Shkencë dhe Arte
ZKSH	Zyra për Kërkime Shkencore
BKI	Bordi Këshillëdhënës Industrial
TI	Teknologjia e Informacionit
D	Departamente
ZSC	Zyra për Sigurim të Cilësisë
ZK	Zyra e Karrierës
ZS	Zyra e Studentëve
PS	Parlamenti Studentor

Fjala e Dekanit për Planin Strategjik 2023 - 2026

Mirë se vini në Fakultetin e Agrobiznesit në Universitetin Publik «Haxhi Zeka» Peje. Planeti ynë përballet me shumë sfida, ku ndër me seriozet është kriza ushqimore për të cilën është edhe misioni i universiteteve në bashkëpunim me institucionet për të gjetur zgjidhje për të ushqyer planetin tonë, për të mbrojtur shëndetin e njerëzve dhe mjedisin, për të administruar burimet tona bujqësore në mënyrë të qëndrueshme për një të ardhme me të mire të të rinjve dhe familjeve tona.

Neve si fakultet, ofrojmë përvojë arsimore dhe praktike universitare me fokus në bujqësi, mjedis dhe ushqim duke kontribuar ekonomisë në rajon e me gjere me interes të përgjithshëm publik. Fakulteti jone përbehet nga 3 Departamente dhe rreth 500 studentë në nivelin e studimeve Bachelor dhe Master:

- **Agromjedis dhe Agroekologji** - BSc, 180 ECTS
- **Teknologjia e Prodhimit Bimor** - BSc, 180 ECTS
- **Teknologji Ushqimore** - BSc, 180 ECTS
- **Sisteme të Qendrueshme të Prodhimit të Ushqimit** - MSc 120 ECTS *i krijuar dhe mbështetur akademikësh nga programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian.*
- **Menaxhim Mjedis**, - MSc 120 ECTS.

Të diplomuarit tanë, kanë kërkesë të lartë për punësim nga bizneset, institucionet qeveritare dhe industriale si rezultat i performances se larte të fakultetit tonë, me ambiente superiore të klasave, laboratorë moderne, qasjes sonë personale me në qendër studentet si dhe për praktikat e avancuara ndaj mësimdhënies dhe të mësuarit të cilat aplikojmë.

Përvetësimi i sfidave akademike është vetëm një pjesë e një përvoje të suksesshme të Fakultetit tone në zhvillimin e aftësive akademike, ndër personale, drejtuese dhe sociale të studenteve tanë. Për të përmirësuar këto aftësi, studentët, mund të marrin pjesë në organizime të shumta studentore, konferenca shkencore, të kryejnë kërkime nën mentorimin e profesorëve të fakultetit si dhe duke shtuar edhe shumë aktivitete të tjera brenda dhe përreth kampusit universitar të Pejës si një mundësi thelbësore për t'u bërë një i diplomuar i gatshëm për veten dhe shoqërinë.

Partneritetet tona të shumta me universitete evropiane, kanë zhvilluar dhe vazhdojnë të zhvillojnë kapacitetet tona akademike e kërkimore shkencore me përfshirjen e profesorëve tanë në projekte të ndryshme bashkëpunimi duke sjellë në rajonin tone dhe shoqërinë Kosovare, experiencat me të avancuara shkencore për një të ardhme të qëndrueshëm. Këto partneritete u mundësojnë edhe studenteve tanë të përfitojnë bursa ndërkombëtare dhe shkëmbim studimesh edhe praktike “Internships” në një universitetet partner në Evropë nëpërmjet programit Erasmus+, gjithashtu edhe të përfshihen në projekte të ndryshme të Bashkimit Evropian për zhvillim akademik dhe shkencor.

Shpresoj se do të merrni pak kohë dhe do të mësoni gjithçka rreth Fakultetit të Agrobiznesit si dhe ju mirëpresim të na vizitoni ose ti drejtoheni burimeve tona të internetit për të gjetur me shume informacione dhe mundësi specifike. Mos ngurroni të na kontaktoni në +383 (0) 39 422 072 ose info@unhz.eu.

Sinqerisht,

Prof. Dr. Nexhdet SHALA

Dekan i Fakultetit të Agrobiznesit

HYRJA DHE QËLLIMI

Fakulteti Agrobiznesit si njësi akademike e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë është i angazhuar në aktivitete mësimore, kërkimore-shkencore dhe hulumtuese, që përgatitë studentë konkurrues për tregun e punës, lider të së ardhmes në fushat e bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit që do të kontribuojnë në zhvillimin e gjithmbarshëm të shoqërisë kosovare dhe më gjerë.

Fakulteti i Agrobiznesit vepron duke u bazuar në Planin strategjik tre vjeçar për periudhën 2023-2026 që e ka zhvilluar Universiteti “Haxhi Zeka”. Shih linkun më poshtë;

<https://unhz.eu/rregullore2/#167594531284528d2fb45a0f7:~:text=Plani%20Strategjik%20i%20Universiteti%20p%C3%ABr%20viti%202023%2D2026>

Fakulteti Agrobiznesit si njësi akademike e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë udhëhiqet nga Dekani dhe dy Pro-dekanë. Menaxhimi i punëve dhe detyrave administrative të përditshme përkrahet nga koordinatori për cilësi dhe zhvillim akademik, zyrtarët ligjorë dhe administrativ si dhe nga asistentët administrativ. Aktualisht, personeli akademik i përhershëm përbëhet nga, 2 Profesorë të Rregullt, 6 Profesor të Asocuar, 8 Profesorë asistent, dhe 2 asistentë. Përveç personelit të rregullt akademik, Fakulteti i Agrobiznesit angazhon edhe personel akademik në cilësi të bashkëpunëtorëve (ligjërues dhe asistentë).

Fakulteti i Agrobiznesit aktualisht ka rreth 492 studentë të përfshirë në tre programe studimi në ciklin Bachelor, dhe dy programe Master . Studentët që studiojnë në programet e përmendura të studimit kryesisht janë nga Regjioni i Dukagjinit që përfshinë komunat: e Pejës, Deçanit, Klinës, Istogut Gjakovës, Junikut, Rahovecit, Malishevës, Prizrenit, etj. Si dhe nga regjionet e tjera të Kosovës. Në Fakultetin e Agrobiznesit vijojnë mësimin edhe student jashtë territorit të Kosovës (nga Shqipëria dhe Mali i zi).

Implementimi i programeve të studimeve bëhet përmes ofrimit të njohurive teorike (ligjërata seminare) si dhe pjesës praktike (ushtrime laboratorike dhe punë praktike në sektorin privat.

Ligjëratat mbahen në amfiteatër dhe në sallat e dedikuara për ligjërata, ndërsa ushtrimet laboratorike mbahen në hapësirat e laboratorëve të cilët ofrojnë kushte të mira dhe janë të pajisur me pajisje që iu përshtaten nivelit të studimeve në këtë institucion.

Biblioteka universitare e cila shfrytëzohet nga studentët e Agrobiznesit është e vendosur në godinën e Fakultetit Juridik, në të cilën studentët mund të shfrytëzojnë literaturën në formë fizike dhe elektronike të dedikuar për studimet në fushën e agrobiznesit, shkencave ushqimore dhe të bioteknologjisë. Salla e teknologjisë informative e pajisur me kompjuter që gjendet në godinën e Fakultetit të Juridikut po ashtu në Fakultetin e Agrobiznesit, janë në dispozicion të studentëve të Agrobiznesit.

Plan programet e Fakultetit të Agrobiznesit janë të hartuara sipas modelit evropian të transferim të kredive ECTS ndërsa raporti në mes punës teorike dhe asaj praktike është 60% me 40%. Gjatë studimeve, studentët përpos njohurive teorike përvetësojnë edhe shkathtësi praktike përmes punës hulumtuese në laboratorët e fakultetit si dhe laboratorët në Institutin Bujqësor të Kosovës, në Pejë.

Fakulteti i Agrobiznesit ka marrëveshje për internship me ndërmarrje të ndryshme të cilat operojnë në Kosovë e posaçërisht në Regjionin e Dukagjinit, si dhe ka një varg marrëveshjesh të nënshkruara me universitete të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare për bashkëpunim në fushën e hulumtimeve dhe mobilitetit studentor dhe të profesorëve.

Arsye të brendshme dhe të jashtme shfaqën nevojën për miratimin e dokumentit "Strategjia e FAG-ut 2023-2026". Arsyet e brendshme i gjejmë në nevojën për një dokument zhvillimi strategjik që do të shërbejë si bazë për krijimin e planeve vjetore të zhvillimit, në të cilat projektet dhe programet do të përputhen me qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Ky dokument paraqet vazhdimësinë e realizimit të zhvillimit të fakultetit në kuadër të universitetit, i cili filloi me themelimin e tij, në vitin 2011. Në këtë mënyrë, fakulteti, si asnjëherë më parë, vendos synime dhe pritshmëri konkrete para themeluesit, akademikëve, studentëve dhe publikut të gjerë, duke qëndruar i hapur ndaj të gjitha ideve dhe kritikave që synojnë përmirësime. Arsyet e jashtme lindin nga kërkesat e ligjeve dhe dokumenteve strategjike të miratuara në nivele të ndryshme të qeverisjes në Republikën e Kosovës, si dhe atyre në nivel evropian, të cilat duhet të arrihen nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të projekteve.

Zakonisht, formulimi i një strategjie është një procedurë e përhershme (planet strategjike të hartuara monitorohen vazhdimisht), "Strategjia e FAG 2023-2026" përfshin edhe kërkesat që dalin nga korniza përkatëse ligjore dhe strategjike për përballimin e sfidave të brendshme dhe të jashtme, përmbushjen e pritshmerive të komunitetit akademik, themeluesve dhe publikut të gjerë.

Ky dokument tregon strategjinë e përgjithshme të fakultetit, në formulimin e së cilës janë përfshirë specifikat e fakultetit, si njësi organizative pranë universitetit "HAXHI ZEKA". Mbështetur në këtë dokument, fakulteti do të përgatisë plane vjetore, në të cilat do të specifikohen qartë aktivitetet, qoftë në aspektin e përmbajtjes, bartësve, buxhetit dhe kohës, të cilat duhet të zbatohen për të arritur qëllimet strategjike afatgjata të fakultetit dhe afirmimin e mëtejshëm të fakultetit tonë.

Përfundimisht, qëllimi për ta transformuar fakultetin synon një strukturë të integruar, por të decentralizuar, e aftë për t'iu përgjigjur në mënyrë të justifikuar ekonomikisht, të gjitha sfidave për tregun e punës në bujqësi, mjedis dhe ushqim për të kontribuar ekonomisë në regjion e më gjerë me interes të përgjithshëm në kohët moderne, zhvillimit të shkencës dhe transferimit të njohurive, duke krijuar kushte për studime multidisiplinare, ndërdisiplinore dhe kërkimore.

Metodologjia e Hartimit të Planit Strategjik

Ky plan strategjik është zhvilluar si produkt nga takimet, këshillimet dhe përfshirjet aktive të të gjithë personelit në FAG-it, shoqërisë civile, komunitetit të biznesit, të diplomuarve (alumni) dhe studentëve aktualë.

Suksesi i tij është rezultat i përfshirjes së palëve të interesit në zbatim të tij. Kjo përfshirje ka zënë fill qysh në krye të këtij dokumenti. Përfshirja aktive e menaxhmentit, administruesve, mësimdhënësve, studentëve, të diplomuarve dhe parterëve në punëtori për zhvillimin e planit ishte vendimtare për përcaktimin e saktë të rrugëtimit strategjik të FAG-it në të ardhmen. Plani, në versionin e tanishëm, është edhe rezultat i punës së tyre. Propozimet e tyre janë pjesë përmbajtjesore e tij. Inputet e strukturuar dhe të ndara me palët e treta mundësuan ndërlidhje dhe krahasim të prioriteteve dhe rezultateve, duke mundësuar kështu validitet dhe besueshmëri për çdo pjesë të këtij plani.

Fillimisht FAG pati themeluar "Komisionin për Hartimin e Planit Strategjik 2023-2026",¹ si ekip përgjegjës për ta drejtuar procesin e planifikimit strategjik. Pastaj, janë themeluar edhe grupet e tjera punuese, me ekspertë

¹Vendimi me emrat e anëtarëve të Ekipit Hartues të Planit Strategjik 2023-2026 gjendet në shtojcën 2 të këtij dokumenti.

të fushave të ndryshme. Për zhvillimin e këtij planit atrategjik të FAG-it janë mbajtur disa punëtori dhe me dhjetëra takime të grupeve punuese. Në mbështetje të grupeve punuese për përpilimin e Planit Strategjik 2023-2026 ka ndihmuar edhe HERAS PLUS (Higher Education Research and Applied Science Plus), OJQ “Syri Vizion”, “Let`s Do it Peja”, Komuna e Pejës, studentët e diplomuar, përfaqësuesit e studentëve, përfaqësuesit e bizneseve etj.

Tetë grupet punuese kanë qenë: Grupi Punues për Menaxhimin e Brendshëm, Grupi Punues për Mësimdhënie, Grupi Punues për Sigurim të Cilësisë, Grupi Punues për Kërkime Shkencore, Grupi Punues për Bashkëpunim Ndërkombëtar, Grupi Punues për Studentët, Grupi Punues për Ndërmarrësi dhe Grupi Punues për Infrastrukturë.

Procesi i hartimit të “Planit Strategjik 2023 – 2026” ka kaluar nëpër disa faza, nëpër të cilat janë zhvilluar aktivitete të ndryshme:

- ✚ Faza 1: Përgatitja. - Në mbledhjen e mbajtur të Këshillit Fakultetit, më 06.11.2023, janë emëruar anëtarët e “Komisionit për Hartimin e Planit Strategjik”. Gjatë muajit qershor zyrtarët e FAG-ut i kanë bërë përgatitjet për fillimin e hartimit të planit strategjik, duke përgatitur Planin e Punës për hartimin e Planit Strategjik.
- ✚ Faza 2: Përcaktimi i fushave dhe analiza e gjendjes. - Më 12-13.07.2022 është zhvilluar një punëtori , me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve të FAG-ut, studentëve, të diplomuarve dhe palëve të interesit. Në ditën e parë të punëtorisë, pjesëmarrësit janë informuar në detaje rreth procesit të hartimit të planit strategjik dhe kanë përcaktuar fushat në të cilat do të përfshihen në kuadër të këtij plani. Gjithashtu, gjatë kësaj punëtorie është bërë edhe analiza e gjendjes për fushat që janë përfshirë në këtë plan, e cila është realizuar përmes analizës SWOT. Bazuar në njohuritë e pjesëmarrësve janë identifikuar sukseset, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet për secilën nga fushat e përfshira në kuadër të këtij plani. Veç kësaj, gjatë kësaj faze janë mbledhur të dhëna dhe statistika zyrtare që kanë ofruar zyrtarët e UHZ-së për të gjitha fushat e përfshira në këtë plan, në mënyrë që analiza e gjendjes të jetë sa më e saktë dhe gjithëpërfshirëse.
- ✚ Faza 3: Përcaktimi i vizionit, misionit dhe objektivave strategjike. - Në këtë fazë është organizuar një punëtori, më 14.07.2023, me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve të FAG-ut, studentëve, të diplomuarve dhe palëve të interesit. Pas realizimit të analizës së gjendjes dhe përcaktimit të fushave strategjike, pjesëmarrësit kanë diskutuar dhe kanë vendosur për vizionin dhe misionin e këtij plani të FAG-ut. Gjithashtu, nga rezultatet e analizës së gjendjes, pjesëmarrësit i kanë përcaktuar objektivat strategjike të këtij plani, të cilat synohen të arrihen deri në përfundimin e zbatimit të këtij plani strategjik.
- ✚ Faza 3: Përcaktimi i rezultateve të pritshme, aktiviteteve, indikatorëve dhe analiza e rrezikut. Në këtë fazë është organizuar një punëtori, më 06-07.10.2023, me pjesëmarrjen e të gjithë akterëve të FAG-ut, studentëve, të diplomuarve, OJQ-ve dhe HERAS +. Në këtë punëtori, pjesëmarrësit i kanë identifikuar sfidat kryesore për secilën fushë/OS, i kanë përcaktuar rezultatet e pritshme për secilën fushë/OS, si dhe i kanë caktuar dhe përshkruar aktivitetet e parapara për secilën fushë/OS. Në ditën e dytë të kësaj punëtorie, më 07.10.2023, janë përcaktuar treguesit objektivisht të matshëm (indikatorët) për secilin objektiv strategjik. Gjithashtu,

gjatë kësaj punëtorie pjesëmarrësit kanë identifikuar dhe përshkruar supozimet dhe rreziqet që mund të ndikojnë në zbatimin e këtij plani strategjik.

- ✚ Faza 4: Planifikimi i buxhetit dhe planit të zbatimit. - Në këtë fazë, në bashkëpunim me Departamentit e Financave, grupet punuese kanë përcaktuar buxhetin për të gjitha aktivitetet e parapara për periudhën tri vjeçare të këtij plani, duke e ndarë në kategori, varësisht prej burimit të financimit, si dhe kanë detajuar planin e zbatimit të këtij plani strategjik për periudhën tri vjeçare, duke përcaktuar institucionet/organet përgjegjëse për zbatimin e tyre.
- ✚ Faza 5: Hartimi i dokumentit të Planit Strategjik. - Në bazë të dokumenteve të hartuara dhe të dhënave e sugjerimeve të ofruara gjatë gjithë procesit, Komisioni për hartimin e Planit Strategjik ka integruar të gjitha pjesët në një dokument dhe e ka finalizuar draftin e “Planit Strategjik të Fakultetit të Agrobiznesit, Pejë 2023 – 2026”, i cili i është dorëzuar për procedim të mëtutjeshëm.
- ✚ Faza 6: Diskutimi publik i dokumentit të Planit Strategjik. – Me qëllim që të marrë vërejtje, komente e sugjerime nga të gjitha palët, të brendshme e të jashtme, FAG ka organizuar diskutime publike me të gjitha palët, duke aplikuar forma, metoda dhe medie të ndryshme të komunikimit. Në kuadër të kësaj janë organizuar diskutime publike me stafin e FAG-ut, me studentët e FAG-ut, me përfaqësues të institucioneve lokale e qendrore, me komunitetin e biznesit dhe me publikun e gjerë.
- ✚ Faza 7: Përfshirja e sugjerimeve dhe finalizimi i dokumentit të Planit Strategjik. – Pas organizimit të diskutimeve publike me palët e ndryshme, FAG i ka marrë parasysh të gjitha vërejtjet e komentet dhe ka përfshirë në planin strategjik të gjitha sugjerimet relevante që kanë dalë gjatë diskutimeve publike. Më pas, “Plani Strategjik i Fakultetit të Agrobiznesit, Pejë 2023 – 2026” ka marrë formën përfundimtare si dokument, i gatshëm për miratim nga organet e UHZ-së.

I. FAKULTETI I AGROBIZNESIT

1. Informata themelore mbi FAKULTETIN

Fakulteti i Agrobiznesit njësi akademike pranë, Universiteti “Haxhi Zeka” është institucion publik i arsimit të lartë që merret me arsimin e lartë në dy ciklet e studimit, si dhe me punën kërkimore-shkencore, që synojnë përfshirjen dhe përmirësimin e njohurive, thellimin e mendimit dhe arsimit, aktivitetëve arsimore, artistike, kulturore, sociale, pastaj zhvillimin ekonomik, promovimin e shoqërisë demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta të mësimdhënies dhe të kërkimeve shkencore.

Tabela nr. 1. Të dhëna për Fakultetin e Agrobiznesit

EMRI	FAKULTETI I AGROBIZNESIT
THEMELUESI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
DATA E THEMELIMIT	14.11.2011
DEKAN	Prof.Dr. Nexhdet Shala
ADRESA	Pejë Rr. UÇK
SHTETI	Kosovë
TELEFONI	+383 39 422 072
E-MAILI	info@unhz.eu

Në procesin mësimor-shkencor në fakultet marrin pjesë 18 mësimdhënës në marrëdhënie të rregullt pune në FAG dhe një numër i caktuar bashkëpunëtorësh të jashtëm. Përveç kësaj, fakulteti ka të punësuar 9 punëtorë, të cilët kryejnë detyra profesionale, administrative-teknike dhe ndihmëse. Në Fakultet ekzistojnë 4 fusha të ngushta shkencore, që janë të harmonizuara me Rregulloren për fushat dhe fushat më të ngushta shkencore dhe artistike.

Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të vet, fakulteti i Agrobiznesit udhëhiqet nga vlerat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- ✚ Integriteti profesional dhe akademik - Të hapur dhe të sinqertë në veprimet tona;
- ✚ Gjithë përfshirja dhe barazia - Vlerësojmë diversitetin, përfshirjen, kujdesin, respektin dhe mirëpresim gjithsecilin;
- ✚ Liria e shprehjes dhe e të menduarit – Nxisim dhe vlerësojmë lirinë e shprehjes dhe mendimin kritik akademik;
- ✚ Konkurrueshmëria - Dëshira dhe motivimi për t’u bërë më të suksesshëm dhe më të dallueshëm;
- ✚ Shërbimi ndaj bashkësisë- Bashkëpunim me grupe të interesit për t’ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tyre.

Fakulteti zyrtarisht filloi t’i zbatojë programet e studimit në përputhje me parimet e Bolonjës, sipas plan-programeve të akredituara, nga viti akademik 20012/13.

Me vizionin që ka FAG, orientohet drejt programeve të profilizuara studimore në harmoni me kërkesat e tregut në fushën e Bujqësisë, mjedisit, ushqimit dhe në fushat tjera të ndërlidhura

Përveç vizionit të sipërshënuar, FAG-it i materializon synimet e veta sa vijon:

- ▶ zhvillim të vazhdueshëm e të qëndrueshëm për sigurimin e cilësisë në fakultet;
- ▶ Përmirësim i cilësisë së programeve të studimit;
- ▶ mësimdhënies dhe kushteve të punës;
- ▶ përfshirje aktive të studentëve në të gjitha segmentet e punës dhe vendimmarrjes;
- ▶ rritje e efikasitetit të studimeve;
- ▶ zhvillim i punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarisë artistike;
- ▶ përmirësimi i cilësisë së komunitetit të përgjithshëm akademik në FAG;
- ▶ organizimi racional i burimeve.

Fakulteti i Agrobiznesit në Pejë përbëhet nga këto Departamente:

Tabela nr. 2: FAG-it

NR. EMRI I DEPARTAMENTEVE	
1	Teknologji e Prodhimit Bimor
2	Agromjedis dhe Agroekologji
3	Teknologji Ushqimore
3	Sistemet e qëndrueshme të prodhimit ushqimor
2	Menaxhim Mjedis

Tabela nr. 3: Përshkrimi i fakultetit

N	Fakulteti	Përshkrimi
1	i Agrobiznes	Synon të jetë një qendër akademike bashkëkohore studimi, kërkimi dhe transferimi të njohurive në fushën specifike për menaxhim të agrobiznesit me plan-programe novatore, ku studentet e diplomuar gjejnë veten e tyre dhe kontribuojnë me dije e profesionalizëm në fushën e agrobiznesit, agroekologjisë dhe teknologjisë ushqimore. Programet përmbajnë karakter profesional dhe i përgatisin studentët të mendojnë për biznesin dhe agrobiznesin në dimensione të shumta, duke marrë njohuri themelore. Mësimi zhvillohet në dy nivele: baçelor dhe master.

- ✚ Me qëllim të mbështetjes dhe zbatimit të misionit dhe vizionit, përveç bibliotekës, risi është themelimi i tre njësive të reja organizative si dhe rritja e rolit të Qendrës së Karrierës në kuadër të Universitetit.
- ✚ **INSTITUTI PËR KËRKIME SHKENCORE DHE ARTE** në strukturën vetë përfshin secilin fakultet nëpërmjet departamenteve përkatëse. Qëllimi i institutit për Shkencë është rritja e aktiviteteve kërkimore, shkencore e artistike. Realizimi i aktiviteteve të saj planifikohet të realizohet nëpërmjet aplikimit për projekte relevante, me përfshirje të personelit akademik, hulumtuesve të brendshëm e të jashtëm, studentëve të niveleve të ndryshme, me qëllim që t'u krijohen atyre mundësi të marrin pjesë në zbatimin e projekteve hulumtuese dhe t'i shfrytëzojnë të gjitha të dhënat për qëllime studimi;
- ✚ **QENDRA PËR EKSELENCË** është themeluar për ta përkrahur personelin akademik që të mund t'i zgjerojë më tutje shkathtësitë profesionale dhe profilizimin nëpërmjet trajnimeve specifike për

metodologjitë e avancuara të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Në të ardhmen e afërt, UHZ synon që kjo qendër të pasurohet mbi konceptet e ekselencës digjitale. Fokusi i kësaj qendre është i orientuar në inovacion, hulumtime, zhvillim dhe trajnime, me trajnerë vendorë e ndërkombëtarë;

✚ **QENDRA PËR PËRKRAHJEN E BIZNESEVE** është themeluar me qëllim të përmbushjes së objektivit të shtatë të Planit për Zhvillim Strategjik 2023-2026 të UHZ-së, që ndërlidhet me ndërmarrësin.

Meqë shumica e programeve të ofruara në njësitë akademike kanë komponentë nga biznesi, kjo qendër fokusohet në aktivitete konkrete për t'i motivuar studentët të mëshirohen me shpirtin e ndërmarrësisë, si dhe t'i ndihmojë ata që të hapin biznese të reja. Kjo do realizohet me partnerë dhe me industrinë nëpërmjet inkubatorëve të biznesit. Po ashtu, kjo qendër do mbajë lidhje të afërta me bizneset partnere për t'iu përgjigjur nevojave të tyre me studentë në studime si dhe me të diplomuarit në fushën e punësimit. Aktiviteti i kësaj qendre do jetë primar në përgatitjen dhe zbatimin e programeve profesionale të nivelit të pestë (5). Tani UHZ është në fazën përfundimtare të përgatitjes së një programi të tillë për udhërrëfyes turistik;

✚ **QENDRA E KARRIERËS** ka kapacitete për ta zgjeruar më tej rolin e saj, në mënyrë që të shërbej si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës. Me qëllim promovimin e studentëve të UHZ-së dhe kërkimin e mundësive të reja të punësimit, kjo qendër krijon dhe mirëmban kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë. Gjerë më tani, qendra e zhvillon aktivitetin e vet nëpërmjet pjesëmarrjes në panairë të punës dhe në ngjarje të ngjashme. Nëpërmjet kësaj qendre këtë vit është konsoliduar "Alumni i UHZ-së". Kjo qendër është duke u angazhuar në certifikimin e zyrtarëve të karrierës në fushat përkatëse. Aktiviteti i saj është orientuar edhe në rrjetëzimin e qendrës sonë me qendra të karrierës të universiteteve të tjera. Në mënyrë të veçantë, është duke u studiuar mundësia e rrjetëzimit të saj me zyrat e karrierës së shkollave të mesme, të cilat kanë programe të ngjashme me ato që i ofron UHZ-ja;

Tabela nr. 4: Programet e studimit në Fakultetin e Agrobiznesit

Nr.	Programet e studimit të vlerësuara gjatë vitit 2022	Numri i studentëve, i miratuar nga KSHC-ja	Periudha kohore e ri akreditimit	Vendimi
FAKULTETI I AGROBIZNESIT				
1	Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc	50	2022-2025	Ref: 944/22 18.07.2022
2	Agromjedis dhe Agroekologji, BSc	50	2022-2025	Ref: 944/22 18.07.2022
3	Teknologji Ushqimore, BSc	60	2022-2025	Ref: 1778/22 20.10.2022
4	Sistemet e qëndrueshme të prodhimit ushqimor, MSc	25	2021-2024	Ref: 3025/21 12.08.2021
5	Menaxhim Mjedis, - MSc 120 ECTS.	25	2021-2024	Ref: 3025/21 12.08.2021

2. Misioni, Vizioni dhe Vlerat e Fakultetit të Agrobiznesit

Grupi punues ka qenë i kujdesshëm që misioni të jetë në harmoni të plotë me objektivat strategjike dhe rezultatet që do prodhojë ky dokument strategjik. Prandaj, në “Planin Strategjik të FAG 2023 – 2026”, më poshtë theksohet se:

Misioni. - Fakulteti i Agrobiznesit është njësi akademike pranë Universitetit “Haxhi Zeka” që ofron mësimdhënie dhe mësim nxënie cilësore, për kuadrot profesionalisht të afta për tregun e punës në bujqësi, mjedis dhe ushqim për ti kontribuar ekonomisë në regjion e më gjerë me interes të përgjithshëm publik.

Vizioni. - “ Fakulteti i Agrobiznesit orientohet drejt programeve të profilizuara studimore në harmoni me kërkesat e tregut në fushën e Bujqësisë, mjedisit, ushqimit dhe ne fushat tjera të ndërlidhura”

Vlerat. - Në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të vet, Fakulteti i Agrobiznesit do të udhëhiqet nga vlerat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

- ✚ Integriteti profesional dhe akademik - Të hapur dhe të sigurtë në veprimet tona!
- ✚ Gjithë përfshirja dhe barazia - Vlerësojmë diversitetin, përfshirjen, kujdesin, respektin dhe mirëpresim gjithsecilin!
- ✚ Liria e shprehjes dhe e të menduarit - Inkurajojmë dhe vlerësojmë lirinë e shprehjes dhe mendimin kritik akademik!
- ✚ Konkurrueshmëria - Dëshira dhe motivimi për t’u bërë më të suksesshëm dhe më të dallueshëm!
- ✚ Shërbimi ndaj komunitetit - Bashkëpunim me grupe të interesit për t’ju përgjigjur sa më mirë nevojave të tyre!

Deklarata mëposhtme e misionit, e përcaktuar në Planin Strategjik 2023 – 2026, është si në vijim:

“Fakulteti i Agrobiznesit është njësi akademike pranë Universitetit “Haxhi Zeka” që ofron mësimdhënie dhe mësim nxënie cilësore, për kuadrot profesionalisht të afta për tregun e punës në bujqësi, mjedis dhe ushqim për ti kontribuar ekonomisë në regjion e më gjerë me interes të përgjithshëm publik”.

Gjatë punës përgatitore dhe aktiviteteve që i kanë zhvilluar grupet punuese për të krijuar dhe kompozuar një plan strategjik sa më real dhe më të zbatueshëm, në përputhje me objektivat dhe nevojat për ndryshime institucionale dhe programore, rezultoi se misioni ishte i domosdoshëm. Prandaj, pas diskutimesh e analizash të shumta, grupet punuese vendosën që të ruhet thelbi i deklaratës të misionit dhe në kuadër të saj të përfshihen dhe forcohen elementet e reja, karakteristike për Fakultetin e Agrobiznesit ne Pejë. Në këtë vazhde, u vendos që së pari, përveç se FAG është institucion i arsimit të lartë që transferon dije, të pasqyrohet rritja e potencialit të studentëve, me fokus tregun e sotëm dinamik, të punës.

Andaj, pas të gjitha të diskutimeve me grupet e interesit, personelin akademik e administrativ, studentët, partnerët, përfaqësuesit e bizneseve, alumni, etj, proceduralisht u vendos që deklarata e misionit dhe e vizionit të jetë si më poshtë:

Fakulteti I Agrobiznesit misionin e vet e mbështet në transformimet shoqërore të cilat sot po ndodhin në rajonin evropian dhe në Ballkanin Perëndimor, të cilat synojnë ndryshimin, reformimin dhe

tranzicionin drejt një shoqërie më demokratike, në të cilën ka sundim të ligjit, pastaj drejt tregut të punës në bujqësi, mjedis dhe ushqim për ti kontribuar ekonomisë në regjion e më gjerë etj., për të cilat nevojiten vetëdije dhe njohuri të avancuara. Për këtë synim, fakulteti, së bashku me personalin e tij, përpiqet të marrë përgjegjësinë që i takon.

Misioni. i FAG-ut është i përqendruar në përmirësimin e cilësisë së jetës të popullsisë nëpërmjet ndjenjës dhe bindjes që ka për një rol më të rëndësishëm në zhvillimin e bujqësis dhe ushqimit në vend, duke organizuar studime akademike për të rinjtë, edukim të ndërmarrësve të ardhshëm, të aftë për të krijuar strategji të qëndrueshme sociale, ekonomike dhe teknologjike dhe për t'i vlerësuar e valorizuar burimet njerëzore, që do ta kualifikojnë me sukses brezin e ri akademik për t'u përballur me bujqësin, mjedisin ushqimin, tregun dinamik të punës dhe sfidat e së ardhmes.

Me sloganin "*institucion që transferon dije*" dhe "*realizon potencialin e studentëve drejt tregut dinamik*", duke u nisur nga përvojat e vendeve të suksesshme shoqërore, ekonomike dhe teknologjiksht të zhvilluara, fakulteti përmes procesit të studimit dhe formimit praktik, duke aplikuar standarde moderne arsimore, përpiqet që të punësojë personel akademik mirë të profilizuar për fusha multidisiplinare me njohuri operacionale, me fokus zhvillimin e aftësive krijuese të studentëve. Pra, misioni ynë shoqëror është të edukojmë inxhinier të bujqësis dhe ushqimit, të aftë e me shpirt për të krijuar strategji të qëndrueshme sociale, ekonomike, duke i vlerësuar burimet njerëzore që do të kualifikojnë me sukses këtë brez akademik të gatshëm për t'u përballur me mjedisin e tyre bujqësinë dhe ushqimin sfidat e të sotmes dhe të së ardhmes. Në këtë drejtim, fakulteti zbaton sistem mësimor të dialogut të mbështetur nga mentorët, i kompozuar si një punëtor krijuese e personelit mësimdhënës dhe ekipit të autorëve me reputacion të lartë shkencor e pedagogjik, njohuri, ekspertizë dhe përvojë praktike, të aftë për të marrë përgjegjësi për rezultatet e tyre për arsimimin e brezit të ri. Arsimimi i studentëve realizohet duke përdorur standarde moderne në sistemin e vlerësimit, organizimin e studimeve, metoda të avancuara didaktike, mbështetur në një kornizë kurrikulare të bazuar në praktikat më të mira të universiteteve evropiane, me zbatim të parimeve të Bolonjës dhe të reformës evropiane të arsimit të lartë. Përcaktimi i numrit optimal të lëndëve të detyrueshme studentëve u garanton lirinë për t'u përcaktuar në mënyrë të pavarur për lëndët zgjedhore dhe opsionale, me zgjedhje brenda kuadrit të grupeve studimore multidisiplinare, ose përvetësim paralel të njohurive dhe aftësive kolaterale brenda njësive akademike dhe njësive organizative funksionale brenda universitetit (si: Qendra për Përkrahjen e bujqësisë, ushqimit, Biznesit, Qendra për Karrierë...), të cilat studentëve u mundësojnë të marrin diploma me kualifikim përkatës sipas nevojave dhe ëndrrave që kanë ata për të sotmen dhe të ardhmen.

Njohuritë dhe aftësitë teorike dhe praktike të cilat studentët i fitojnë gjatë studimeve, janë krijuar për t'i kualifikuar studentët për të kryer punë të ardhshme në një mjedis të bujqësis, ushqimit teknologjisë së lartë, duke u mundësuar atyre të zhvillojnë iniciativën, sipërmarrjen, aftësinë për të vlerësuar psikologjiksht dhe për t'i udhëhequr grupet dhe ekipet e punës, pastaj aftësinë për të marrë vendime në edhe kur nuk u mjafton koha, aftësinë për të mësuar më tej gjatë gjithë jetës, aftësinë për t'u përqendruar vetëm në informacion përkatës në mjediset e bollëkut të informacionit dhe të ndotjes së informacionit, aftësinë për të përpunuar punë të shumta njëkohësisht, aftësinë për të udhëhequr projekte komplekse, si dhe aftësinë për t'i integruar në mënyrë kreative njohuritë dhe praktikat nga fusha të ndryshme profesionale, në veçanti orientimin e tyre drejt tregut dinamik.

Për nevoja të arsimimit dhe zhvillimit të kërkimit shkencor, angazhohet personel me dinjitet shkencor dhe me koeficientë të mirë kompetence, të aftë dhe të gatshëm që ta marrin përsipër rrezikun dhe përgjegjësinë për rimëkëmbjen e bashkësive të tyre lokale dhe globale, dhe shndërrimin e Kosovës në "shoqëri të dijes" ose "shoqëri të të mësuarit". Efikasiteti dhe efektiviteti i studimeve, atraktiviteti i programeve mësimore me komponentë multidisiplinare, që korrespondojnë me sfidat e ardhshme teknologjike, studentëve nëpërmjet aplikimit të teknologjive pedagogjike ndërvepruese në organizimin dhe realizimin e procesit mësimor-shkencor, padyshim që prodhon shkallë të lartë kalueshmërie në funksion të njohurive dhe aftësive që u jepen studentëve, por që gjithashtu rezulton në motivim të lartë të studentëve. Në praktikën e tij, fakulteti i zbaton gjithashtu parimet e të mësuarit gjatë gjithë jetës (longlife learning) dhe të realizimit të së drejtës demokratike për studim dhe arsimim, promovimin e transparencës evropiane të studimeve dhe lëvizshmërisë së studentëve dhe profesorëve, promovimin e "dimensionit evropian" (vlerat e një Evrope të bashkuar) në arsimin e lartë, mobilitetit të studentëve dhe profesorëve dhe ndërkombëtarizimit në përgjithësi.

Fakulteti i Agrobiznesit orientohet drejt programeve të profilizuara studimore në harmoni me kërkesat e tregut në fushën e Bujqësisë, mjedisit, ushqimit dhe në fushat tjera të ndërlidhura

Vizioni i fakultetit është të pozicionohet si lider në fushën e arsimit të lartë, arsimit profesional dhe kërkimit shkencor në realizimin e misionit të tij bujqësor, mjedisor dhe ushqimor, duke i arritur standardet më të larta evropiane në organizimin e studimeve, aplikimin e metodave didaktike dhe të një kornize të kurrikule të bazuar në përvojat dhe traditat më të mira të fakulteteve amerikane dhe atyre evropiane, mbi bazën e reformave të nisura nga Procesi i Bolonjës për ristrukturimin e sistemit evropian të arsimit të lartë. Duke planifikuar dhe zbatuar aktivitete mësimore, artistike dhe kërkimore - zhvillimore dhe forma të tjera të punës me studentët, fakulteti i agrobiznesit dëshiron ta krijojë imazhin e një institucioni që do të bëhet një faktor i rëndësishëm në zhvillimin bujqësisë, mjedisit, ushqimit lokal, rajonal e më gjerë.

Vizioni ynë është të krijojmë një fakultet me një reputacion global për përsosmëri akademike dhe të krijojmë shoqëri të dijes në Kosovë, duke synuar nivelin e fakulteteve evropiane dhe atyre botërore. Gjithashtu, ne dëshirojmë të sigurojmë pjesëmarrje globale të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse përmes një qasjeje të formësuar përmes inovacionit, integritetit dhe frymëzimit.

Në kuadër të zhvillimit të ardhshëm të fakultetit, ne do të përqendrohemi në:

- ✚ Formimin e studentëve shumë të kënaqur, me ndjenjë të fortë përkatësie në komunitetin ku ata jetojnë dhe punojnë;
- ✚ Përfshirjen e një numri më të madh të personelit akademik jo vetëm vendës, por edhe ndërkombëtar, të cilët do ta njohin universitetin si një vend kolegjial të punës, zhvillimit dhe përparimit, ndërsa në një afat optimal, edhe regjistrimin e studentëve nga Evropa;
- ✚ Të regjistrojë më shumë studentë në studimet pasuniversitare, të cilët do të joshen nga atraktiviteti i kompetencave ndërkulturore arsimore, kërkimore-shkencore dhe veprimit ndërmarrës;
- ✚ Zhvillimi i mbështetjes së fortë filantropike, me fokus të veçantë studentët me aftësi të jashtëzakonshme kërkimore;

- ✚ Zhvillimin e mëtejshëm të mësimin në distancë në kuadër të arsimit elektronik, i cili është në përputhje me ndryshimet e përditshme në teknologjitë e reja të përdorshme në kuadër të zbatimit të pikave të mësipërme;
- ✚ Krijimin dhe zhvillimin e universitetit si institucion i arsimit të lartë, si vend i shkëlqyer ndërveprues në kuadër të ndërkombëtarizimit të procesit arsimor dhe kërkimor-shkencor, për ta arritur ndërkombëtarizimin në të gjitha ciklet e studimit, dhe futjes në klasa të gjuhës angleze;
- ✚ Organizimin e programeve të përbashkëta studimore me universitete ndërkombëtare me reputacion në të gjitha ciklet e studimit, për t'u mundësuar studentëve të marrin diploma të dyfishta;
- ✚ Modernizim të vazhdueshëm të kornizës kurrikulare dhe hartimin e programeve të reja të studimit në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe kërkesat e teknologjisë moderne;
- ✚ Inkurajimin dhe forcimin e praktikave studentore në të gjitha programet e studimit, në mënyrë që të diplomuarit të jenë konkurrues dhe të aftë për të punuar në sektorët ekonomikë, socialë, në tregun dinamik të punës.

Fakulteti I Agrobiznesit është i pëkushtuar të kontribuojë për komunitetin lokal, rajonal dhe global përmes arritjeve konkrete në procesin arsimor të arsimit të lartë që po zhvillohet dhe përmirësohet vazhdimisht përmes integritit dhe inovacionit, formave frymëzuese të përhapjes dhe aplikimit të njohurive dhe aftësive. Në të ardhmen, do t'i krijojme parakushtet e duhura për realizimin e partneriteteve inovative me subjektet bujqësore mjedisore dhe ushqimore, me fokus të vazhdueshëm në qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e mëtejshëm të pamjes akademike të të gjitha programeve të studimit, me një plan zhvillimor dhe të qëndrueshëm ndaj mbrojtjes së mjedisit, bujqësisë dhe ushqimit me mbijetesën e qytetit të Pejës si qytet i studentëve, i shkencës dhe dijes.

3. Modeli i integritit funksional të FAG-it

Shfrytëzimi maksimal i të potencialeve arsimore, kërkimore, artistike dhe inovative për qëllimet e përcaktuara në strategji, si në nivel evropian ashtu edhe në atë kombëtar, është i mundur vetëm në kushte të hapësirës së krijuar për rrjedhën e ideve, njerëzve dhe fakulteteve me vlera tradicionale akademike të dëshmuara, të cilat mund t'u përgjigjen sfidave të reja vetëm si institucione të forta dhe të integruara. Praktika e zonës evropiane të arsimit të lartë, nevoja për të siguruar një nivel të lartë cilësie në fushën e arsimit të lartë dhe në fushën e shkencës dhe zhvillimit teknologjik, nevoja për të përmirësuar lëvizshmërinë dhe mundësitë e punësimit të ekspertëve me arsim të lartë, imponon sfida të shumta në sistemet komplekse shkencore dhe arsimore-fakultete edhe në Republikën të Kosovës. Përpjekjet për arritjen e qëllimeve të përcaktuara strategjikisht dhe krijimin e bazës për zhvillimin e shoqërisë së dijes kërkojnë forcimin e rolit të fakultetit si forcë lëvizëse e shoqërisë. Këto kërkesa imponojnë nevojën e transformimit të strukturës organizative të fakultetit në një përpjekje për t'i kthyer sistemet komplekse shkencore dhe arsimore në institucione të forta të integruara.

Fakulteti I Agrobiznesit është i bindur se modeli i integritit funksional të fakultetit është një model i përgjithshëm që përfshin funksionet dhe detyrat më të rëndësishme që duhet të kryhen në nivelin e një fakultetit të integruar. Modeli përfshin gjithashtu tendencat moderne në zhvillimin e menaxhimit dhe

organizimit të fakultetit në zonën evropiane të arsimit të lartë, që synojnë rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të sistemit dhe përdorimin racional të burimeve materiale dhe njerëzore në një mjedis konkurrues. Në të njëjtën kohë, modeli i një sistemi të integruar dhe të decentralizuar u zhvillua me idenë e domosdoshmërisë të krijimit të kushteve për rritjen e motivimit të të gjitha pjesëve të fakultetit, nga departamentet deri te ekipet kërkimore dhe individët, mësimmshënësit, studiuesit dhe studentët. Kjo, për të valorizuar iniciativën, idetë dhe rezultatet e tyre në të gjitha fushat e punës së fakultetit, së bashku me përmirësimin e shërbimeve ekzistuese dhe zhvillimin e shërbimeve të reja fakultative që duhet të ofrojnë mbështetje cilësore profesionale për aktivitetet gjithnjë e më të larmishme dhe ndërthurjen e disiplinave klasike.

Për FAG-it, zbatimi i modelit nënkupton:

- ✦ një marrëdhënie pune asimetrike ndërmjet fakultetit dhe universitetit, e cila do të mundësonte lëvizshmërinë e stafit mësimmshënës dhe posaçërisht studentëve;
- ✦ regjistrimi i studentëve në fakultet;
- ✦ studime të përbashkëta në nivel të programeve master dhe, në të ardhmen, edhe në ato doktorale;
- ✦ përqindje domethënëse të përfaqësuesve të fakultetit për sa i përket numrit të anëtarëve të organit drejtues të fakultetit, me përfaqësim të studentëve, themeluesve dhe përfaqësuesve të biznesit;
- ✦ Zbatimi i plotë i legjislacionit ekzistues;
- ✦ Përshtatjen e standardeve për akreditimin e një fakulteti me programe të integruar ndërdisiplinor si institucione arsimore dhe shkencore më fokus drejt bujqësisë, mjedisit dhe ushqimit;
- ✦ ndryshimin e akteve ligjore të fakultetit në përputhje me ndryshimet e propozuara, me qëllim të rritjes së efikasitetit të punës, cilësisë dhe autoritetit në vendimmarrje, si dhe
- ✦ rritjen e funksionalitetit në punën e të gjitha organeve profesionale të fakultetit.

Modeli i integritit funksional propozon integrimin si proces dhe përfaqëson një formë të përgjithshme, ku zbatimi duhet të përshtatet me specifikat e fakulteteve individuale. Në këtë kuptim, çdo fakultet, në varësi të kompleksitetit, shtrirjes dhe shkallës së arritur të integritit në strukturën e tij organizative, do ta përshtasë modelin e përgjithshëm me kushtet e tij, duke miratuar një zgjidhje që nënkupton cilësinë dhe ekspertizën e nevojshme dhe justifikon fondet e investuara. Në zbatimin e modelit, është e nevojshme të zbatohen vazhdimisht idetë e integritit pa centralizim, me një ndarje racionale të detyrave dhe funksioneve, si dhe të drejtave dhe përgjegjësiave vendimmarrëse në të gjitha nivelet e strukturës së menaxhimit të sistemit kompleks fakultativ.

3.1. Organizimi i FAG-it sipas parimit të fakultetit të integruar

Realizimi i qëllimeve që synojnë rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit nënkupton arritjen e një cilësie të lartë të strukturës organizative të fakultetit, kryesisht përmes lidhjes kuptimplote dhe efektive të njësisë organizative në tërësi. Në këtë kuptim, përbërja e fakultetit mund të përfshijë: departamentet, institute, qendrat, bibliotekat, laboratorët e përbashkët, seminare, zyra, fonde, fondacione dhe njësi të tjera organizative brenda të cilave funksionet integruese të sistemit në përputhje me Statutin e Universitetit. Duke u nisur nga qëllimet bazë të modelit të organizimit funksional, është e nevojshme integrimi i të gjitha

njësive organizative në universitet, të cilave u besohen detyra dhe përgjegjësi të caktuara njësive të tij organizative.

Kompetencat dhe përgjegjësitë përcaktohen me Statutin dhe aktet e përgjithshme të universitetit. Fakulteti funksionon si një njësi akademike pranë Universitetit që ka nënsistemet e veta: akademike, sipërmarrëse dhe administrative. Fakulteti menaxhohet nga menaxhmenti i Fakultetit.

Në nivel universitar krijohen: Qendra Kompjuterike e Universitetit, Qendra e Zhvillimit të Karrierës, Qendra për Ekselencë, Qendra për Përkrahjen e Bizneseve, biblioteka dhe institucionet e përfaqësimit studentor.

II. ANALIZA E MJEDISIT TE PLANIT STRATEGJIK 2023-2026/FAG

HYRJE

Zhvillimi i arsimit në Kosovë për një fuqi punëtore që u përshtatet nevojave të tregut përbën kushtin parësor drejt produktivitetit maksimal. Marrë parasysh pozitën e periudhës së paraanëtarësimit të Kosovës në Bashkimin Evropian, është kyçe që fuqia punëtore të sigurojë konkurrueshmëri të aftësive me tregun vendor të punës në radhë të parë e më pastaj edhe me atë evropian.

Ofrimi i programeve të studimit të cilat nuk i reflektojnë nevojat reale të tregut të punës mbetet mangësi strukturore e arsimit të lartë në Kosovë. Njëkohësisht, këtyre programeve u mungon edhe ndërdisiplinarteti, pjesa e mësimit praktik, si dhe ndërlidhja me kërkimin shkencor. Rreth 60% e programeve studimore që ofrohen janë nga fusha e edukimit, arteve dhe shkencave humane, shkencave shoqërore dhe shërbimeve. Numri më i madh i studentëve dhe programeve arsimore janë në kategorinë e shkencave shoqërore dhe drejtësisë. Orientimi i studentëve në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë mbetet i ulët. Vërehet një dallim i theksuar në orientim në fusha të caktuara të studimit në arsimin e lartë sipas gjinisë. Femrat janë të prirura të jenë të orientuara (mbi 90%) në programet e edukimit, shkencave natyrore, shkencave shoqërore, mjekësisë, komunikimit dhe gjuhësisë. Gjersa, meshkujt dominojnë në fusha të studimit të informatikës, humanistikë, gjeografi/gjeologji dhe inxhinieri/teknologji. Një orientim i baraspeshuar gjinor vërehet në fushat e arkitekturës, biznesit dhe drejtësisë. Shkalla e orientimit të studentëve në fushat e studimit në shkenca shoqërore, humane, biznes dhe juridik është shumë e lartë në krahasim me dinamikën e tregut.

Ndërlidhje e ulët e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, oferta e kufizuar e programeve ndërdisiplinare të studimit, kërkon ndërlidhje më të mirë të arsimit të lartë me tregun e punës përmes harmonizimit të programeve të studimit. FAG, e vetëdijshme për situatën e përgjithshme të arsimit të lartë në Kosovë, për vështirësitë që hasin të diplomuarit në punësim, për kërkesat e sektorin privat për profesione specifike, në "Planin Strategjik 2023-2026" ka paraparë zhvillimin e programeve të reja profesionale të nivelit të 5 të KKK-së. Në këtë mënyrë, përmes rritjes së numrit dhe llojshmërisë së programeve të ofruara, universiteti synon edhe rritjen e numrit të studentëve të interesuar për t'i ndjekur ato. Programet që ofrohen dhe njohuritë/shkathtësitë që fitohen nga studentët nuk janë çdoherë në përputhje me nevojat e tregut të punës. Prandaj, FAG duhet të zhvillojë vazhdimisht hulumtime për programet që ofrohen dhe për nevojat e tregut të punës. Brenda hulumtimit, duhet të trajtohen edhe mundësitë e orientimit të njohurive dhe shkathtësive drejt nevojave të tregut të punës dhe vetëpunësimit. Qëllimi i analizës së të dhënave të mbledhura nga hulumtimet, raportet dhe publikimet lidhur me tregun e punës është rishikimi i programeve aktuale dhe hartimi i programeve të reja, të përputhshme me kërkesat e komunitetit të biznesit.

1. Analiza e tregut të punës

Ky dokument mbi analizën e tregut të punës, si pjesë e analizës së mjedisit në të cilin operon FAG-it, është bazuar në dokumentet e strategjisë së UHZ-ja, dokumentet zyrtare të qeverisë së Republikës së Kosovës, në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në raporte, botime dhe punime kërkimore të botuara nga agjencitë e ndryshme vendore dhe të huaja. Disa nga burimet e informacioneve të marra për këtë analizë janë:

- ✚ “Strategjia e Arsimit 2022- 2026” e Republikës së Kosovës, 2022;²
- ✚ “Kosovo in Figures 2021”, Agjencia e Statistikave të Kosovës, 2021;³
- ✚ “Assessment on Labor Market Relevance for the Existing Study Programs of the University “Haxhi Zeka” in Peja”, 2022;⁴
- ✚ “Baseline Assessment Report for the University Haxhi Zeka”, HERAS plus, 2021;⁵
- ✚ “Analizë e Sistemit Arsimor në Kosovë”, Friedrich-Ebert-Stiftung / Kosova, 2018;⁶
- ✚ “Sigurimi i cilësisë në arsimin dhe aftësimin profesional skeda e vendit në Kosovë”, ETF, 2020;⁷
- ✚ “Politikat arsimore për nxënësit në rrezik dhe ata me paaftësi në Evropën Juglindore”, Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), 2007;⁸
- ✚ “Kërkesat e tregut të punës dhe kapacitetet e shkollave profesionale në Kosovë”, raport hulumtues, OJQ ETA, 2022;⁹
- ✚ “Sigurimi i cilësisë në nivelin e ofruesve të arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë gjendja aktuale”, EU, ADA / ALLED 2, 2021;¹⁰
- ✚ “Arsimi dhe tregu i punës në Kosovë dhe në Bashkimin Evropian”, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë”, 2018¹¹, etj,

Përveç burimeve të sipërpërmendura, kjo analizë bazohet edhe në hulumtime dhe publikime të tjera të cilat kanë dhënë informacione gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të plota mbi të cilat janë vendosur objektivat strategjike, aktivitetet dhe prioritetet me qëllim të realizimit të misionit dhe vizionit të FAG gjatë viteve 2023 – 2025.

1.1. Shkalla e papunësisë në Kosovë sipas grupmoshave

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, shkalla më e madhe e papunësisë për pesë vjetët e fundit është te grupmoshat e paraqitura në tabelën e mëposhtme. Nga tri grup moshat, prin ajo prej 15-24 vjet, me shkallën më të lartë të papunësisë. Kjo shkallë është më e madhe te femrat sesa tek meshkujt. Shprehur në përqindje, ajo është rreth 30% më e lartë, varësisht nga viti i përfshirë në këtë analizë:

Tabela nr.5. Shkalla e papunësisë sipas gjinisë dhe grupmoshës, shprehur në përqindje Burimi. ASK, 2022

		Shkalla e papunësisë (%) sipas gjinisë dhe grup moshës											
Vitet		2017			2018			2019			2020		
Gjinia		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Shkalla e papunësisë	15-24	48.4	63.5	52.7	51.5	64.7	55.4	44.1	60.3	49.4	45.2	57.2	49.1
	25-34	37.2	50.7	40.5	37.9	43.5	39.3	26.5	43.4	31.3	27.2	41	31.4

(%) sipas grup moshës	35-44	23.4	25.9	24	25	19.6	23.8	18.5	20.9	19.1	19.4	21.7	20.1
-----------------------	-------	------	------	----	----	------	------	------	------	------	------	------	------

2 Për më shumë shiko vegëzën: <https://masht.rks-gov.net/en/category/documents/>

3 Për më shumë shiko vegëzën: <https://ask.rks-gov.net/media/6975/kosovo-in-figures-2021.pdf>

4 Për më shumë shiko vegëzën: <https://unhz.eu/dokumente-tjera/>

5 Për më shumë shiko vegëzën: 1. <https://rb.gy/5jvmlx> 2. <https://unhz.eu/dokumente-tjera/>

6 Për më shumë shiko vegëzën: <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/15187.pdf>

7 Për më shumë shiko vegëzën: <https://rb.gy/4lqoou>

8 Për më shumë shiko vegëzën: <https://rb.gy/7e2zj6>

9 Për më shumë shiko vegëzën: <https://issuu.com/etea.ks/docs/raporti>

10 Për më shumë shiko vegëzën: <http://alled.eu/wp-content/uploads/2021/07/Quality-assurance-ALBë.pdf>

11 Për më shumë shiko vegëzën: <https://rb.gy/hcitxg>

Përkundër normave të larta të papunësisë, një analizë e punësimit nëpër degë të ndryshme ekonomike do të mundësojë identifikimin e sektorëve me perspektivë punësimi. Rrjedhimisht, në vijim të kësaj analize prezantohen të dhënat lidhur me punësimin sipas profesioneve të ndryshme.

1.2. Punësimi sipas profesioneve

Nga të dhënat e analizuara për dy vjetët e fundit të disponueshme në bazën e të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për punësimin sipas profesioneve të ndryshme, del se në vitin 2019 janë punësuar gjithsej 366.270 persona, nga të cilët janë femra vetëm 83.644 ose 22% nga numri i përgjithshëm i të punësuarve.

Ndërsa, në vitin vijues (2020), punësimi ka rënë për 15.414 persona ose 4.2%. Kjo rënie e punësimit ngjet për shkak të ngadalësimit të rritjes ekonomike si pasojë e pandemisë.

Megjithatë, sa i përket punësimit në baza gjinore, në këtë periudhë punësimi i femrave ka shënuar një rritje simbolike prej 2% në krahasim me vitin paraprak 2019. Në vijim paraqitet tabela me të dhënat përkatëse të ndara në aspektin gjinor dhe sipas profesioneve:

Tabela nr.6. Shkalla e punësimit sipas profesionit dhe gjinisë, shprehur në mijëra të punësuar Burimi: ASK, 2022

Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë për vitet 2019 dhe 2020 (mosha 15 e më shumë)							
Punësimi sipas profesioneve (në mijëra)		2019			2020		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
	Menaxherët	26.911	5.198	32.109	26.089	5.525	31.614
	Profesionistët	31.150	27.189	58.339	29.954	29.074	59.028

Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesionalë	15.469	6.516	21.985	15.054	6.706	21.760
Punëtorë zyresh dhe asistentë	12.893	8.564	21.457	13.224	9.690	22.914
Punëtorë për shërbim dhe shitje	66.468	18.917	85.385	62.835	18.686	81.521
Punëtorë të kualifikuar (aftësuar) në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	8.570	1.584	10.154	6.996	1.963	8.959
Punëtorë të zejeve dhe profesion.të ngjashme	33.410	5.331	38.741	30.680	4.296	34.976
Operatorët dhe instaluesit në fabrika e makina	20.409	0.521	20.930	19.090	0.612	19.702
Profesionet elementare	67.346	9.824	77.170	59.852	10.530	70.382
Gjithsej	282.626	83.644	366.270	263.774	87.082	350.856

Tabela vijuese ilustron të dhënat e njëjta të punësimit sipas profesioneve, mirëpo të shprehura në përqindje. Kjo për shkak të thjeshtësimit të analizës me qëllim hetimin e trendit të kërkesës në tregun e punës sipas sektorit të prodhimit, shërbimeve, tregtisë, bujqësisë, administratës, menaxhimit, zejeve etj. Sipas hulumtimit, rezulton se sektori i profesioneve elementare bashkë me sektorin e shërbimeve dhe të shitjeve prijnë në mesin e profesioneve të listuara. Ky dominim i punësimit ndërsektorial është së paku dyfish në raport me profesionet pasuese, si: zejet dhe profesione të ngjashme, profesionistët, menaxherët etj. Megjithatë, nga të dhënat zyrtare nuk specifikohet se cilat janë profesionet elementare të kërkuara nga ndërmarrësit. Një studim më i hollësishëm do të jepte një pasqyrë të saktë orientimi për të rinjtë dhe për institucionet e arsimit që ofrojnë programe profesionale në kuadër të kornizës së pestë kombëtare të kualifikimeve.

Është me rëndësi të theksohet se gjinia femërore ka zënë punë mesatarisht tri herë më shumë sesa ajo mashkullore te kategoria “profesionistët”. Në këtë kategori bie numri më i madh i femrave të punësuar në dy vjetët e fundit të analizës. Në anën tjetër, punësimi më i dobët i femrave duket të jetë te kategoria “operatorët dhe instaluesit në fabrika dhe makina”, me një pjesëmarrje totale prej vetëm 0.7%. Kjo ngaqë meshkujt zënë vend punësimi në këtë kategori rreth 10 herë më shumë sesa femrat, mbase për shkak të natyrës së rëndë të punës, interesit të mangët të femrave për këtë sektor ose mungesës së kualifikimit. Sidoqoftë, kjo mbetet për t’u hulumtuar në të ardhmen. Në vijim të analizës së mësipërme, pasojnë të dhënat përkatëse të punësimit të shprehura në përqindje. Mënyra e përlogaritjes përkon me secilin profesion veç e veç dhe të ndara sipas aspektit gjinor për vitet 2019 dhe 2020.

Tabela nr.7. Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmoshës, e shprehur në përqindje Burimi: ASK, 2022

Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë për vitet 2019 dhe 2020 (mosha 15 e më shumë) shprehur në përqindje							
Pjesëmarrja e punësimit sipas profesioneve (%)	2019			2020			
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	
	Menaxherët	9.5	6.2	8.8	9.9	6.3	9.0

Profesionistët	11.0	32.5	15.9	11.4	33.4	16.8
Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesionalë	5.5	7.8	6.0	5.7	7.7	6.2
Punëtorë zyrash dhe asistentë	4.6	10.2	5.9	5.0	11.1	6.5
Punëtorë për shërbim dhe shitje	23.5	22.6	23.3	23.8	21.5	23.2
Punëtorë të kualifikuar (aftësuar) në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	3.0	1.9	2.8	2.7	2.3	2.6
Punëtorë të zejeve dhe profesion. të ngjashme	11.8	6.4	10.6	11.6	4.9	10.0
Operatorët dhe instaluesit në fabrika e makina	7.2	0.6	5.7	7.2	0.7	5.6
Profesionet elementare	23.8	11.7	21.1	22.7	12.1	20.1
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

1.3. Programet studimore të FAG-të dhe tregu i punës

Ekspertët e “Heras+”, në shtator të vitit 2022 kanë bërë një studim lidhur me përputhshmërinë e programeve studimore të Fag-it pranë UHZ-së me tregun e punës.¹¹ Analiza empirike e studimit përfshin të dhëna të bazuara në një pyetësor të aplikuar për studentët dhe të diplomuarit e të gjitha niveleve dhe të të gjitha programeve të UHZ-së, FAG-it. Pyetësorë shtesë u janë ndarë të diplomuarve, përfaqësuesve të institucioneve publike dhe sektorit privat në kuadër të programit studimor: Për më tepër, disa nga programet e përfshira në studim kanë nevojë të reformohen për të reflektuar nevojat aktuale të tregut të punës. Më poshtë, prezantohen rezultatet e përmbledhura të këtij hulumtimi për 3 programet studimore të fakultetit, përkatësisht për tre variablat në vijim:

- ✚ Lidhja e programeve me tregun e punës;
- ✚ Njohuritë e të diplomuarve për tregun e punës dhe
- ✚ Nëse FAG-it duhet t’i reformojë programet e saj

Tabela nr. 8. Rezultatet e studimit të shprehura në përqindje

Burimi: “Assessment on labor market relevance for the existing study programs of the FAG”, 2022

Programet e UHZ	FAG ka programe adekuate për tregun e punës	Të diplomuarit kanë njohuri adekuate për tregun e punës	FAG duhet të reformojë programet
Menaxhmenti dhe mjedisi – master	81%	89%	33%
Agro-mjedis dhe agro-ekologji - bachelor	93%	94%	33%
Teknologjia e prodhimit bimor – bachelor	77.8%	86%	43%

Gjithashtu, ky studim kërkimor vë theks shqetësues sa i përket punësueshmërisë së të diplomuarve të FAG-it, e cila rezulton të jetë më pak se 50%. Prandaj, kjo çështje duhet të trajtohet jo vetëm nga niveli i programeve individuale, por edhe nga nivelet menaxhuese të universitetit, rekomandon raporti.

[12](#) Shiko raportin:

<https://drive.google.com/file/d/1IO1sëqE6O2NROeSZiN8a1hx3DDmqjëTS/view?usp=sharing>

Sipas rezultateve të studimit por edhe bazuar në gjendjen aktuale të ekonomisë vendore, mundësitë për punësim janë të kufizuara në Pejë dhe rajon. Raporti sugjeron se FAG-it duhet ta hartojë kornizën për krijimin e programeve dhe të diplomuarve profesionistë të cilët do të krijojnë mundësi, përkatësisht aktivitete sipërmarrëse të vetëpunësimit, në vend që të presin punësim nga administrata publike apo nga institucionet shtetërore.

1.4. Vlerësimi bazë për zhvillimin e kapaciteteve institucionale të FAG

Më 17 nëntor 2021, projekti “HERAS Plus” ka lansuar “Raportin e vlerësimit bazë për universitetin ‘Haxhi Zeka’, FAG-it, Pejë”.¹² Raporti është një pasqyrë gjithëpërfshirëse e zhvillimit institucional të universitetit, e bërë në nëntë dimensione të ndryshme, njëri prej të cilëve është tregu i punës. Sipas këtij raporti, përafrimi me tregun e punës është ndër sfidat kryesore të institucioneve të arsimit të lartë të Kosovës, prandaj edhe FAG-it dhe UHZ-së. Kjo sfidë përfshin kryesisht punësueshmërinë e të diplomuarve, zhvillimin e aftësive dhe kompetencave të duhura, si dhe zhvillimin e profileve të të diplomuarve, të cilat nevojiten në tregun e punës.


Të dhënat nga sondazhi i vitit 2020, me 1640 të diplomuar në FAG pranë UHZ, tregojnë se vetëm rreth një e katërta e tyre (24.8%) janë të punësuar (nga të cilët 64%, femra). Të dhëna të tilla konfirmojnë punësueshmërinë si një sfidë e të diplomuarve universitarë dhe kjo situatë tregon nevojën e shfaqur që FAG të përcaktojë më mirë strategjinë dhe të ndërmarrë masa për rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve.

FAG, përmes “Zyrës së Karrierës”, në vazhdimësi po bën përpjekje për të ofruar më shumë mundësi praktike për studentët dhe për të bashkëpunuar me të diplomuarit e FAG-it për t'u lidhur më mirë me tregun e punës dhe për të adresuar nevojat e tij. Në gusht të vitit 2020 UHZ-ja ka themeluar “Shoqatën Alumni”, si organizatë jofitimprurëse, me qëllim të lidhjes së UHZ-së me të diplomuarit e këtij fakulteti. FAG-it pret që nisma e tillë për një lidhje më të mirë me tregun e punës të jep rezultate konkrete dhe efekt gjatë viteve të ardhshme.

Raporti thekson se shkalla e punësimit të të diplomuarve është ende e vogël. Prandaj, për ta adresuar këtë sfidë, në Planin Strategjik 2023-2026” të FAG-it janë përfshirë masat konkrete fakultative. FAG ka planifikuar përditësimin e programeve të studimit sipas nevojave të tregut të punës, hartimin e programeve të reja profesionale, si dhe përmirësimin e shërbimeve të orientimit në karrierë. Gjithashtu, në vitin 2022 UHZ-ja ka marrë vendim për të themeluar “Qendrën për Përkrahjen e Bizneseve”, për të përforcuar lidhjen e saj me tregun e punës.

Një nga synimet e Strategjisë së FAG, ka qenë barazia gjinore. Të dhënat e vitit 2020 për studentët tregojnë se në FAG numri i studentëve meshkuj është pak më i ultë se ai homologeve të tyre femra. Megjithatë, baraspesha gjinore mes studentëve në FAG është shumë afër (shiko figurën e mëposhtme).


¹²Shiko raportin: https://drive.google.com/file/d/1ru9oFCVvarA_AHSUTB4_1_Km97Jvy_Fa/view



Grafiku nr. 1. Krahasimi i studentëve të UHZ sipas gjinisë

Burimi: “Baseline Assessment for institutional capacity development at UHZ”, Heras plus, 2021

Sa i përket përkatësisë etnike të studentëve të regjistruar në UHZ, shumica e studentëve joshqiptarë vijnë nga bashkësia etnike boshnjake, pastaj rom, ashkali dhe egjiptase, ndërsa shumë pak prej tyre janë turq, serbë, malazezë etj. Për të dhëna të detajuara shiko figurën e mëposhtme.



Grafiku nr. 2. Studentët sipas përkatësisë kombëtare

Burimi: “Baseline Assessment for institutional capacity development at UHZ”, Heras plus, 2021

Rekomandimet e ekspertëve të “Heras Plus” mbi përafrimin e UHZ-së, FAG-t me tregun e punës janë si në vijim:

- ✚ FAG-UHZ duhet të përcaktojë më mirë strategjinë për përafrimin me tregun e punës dhe të ndërmarrë masa për rritjen e punësueshmërisë së të diplomuarve të saj. Masa të tilla mund të jenë që praktika të bëhet e detyrueshme për të gjitha programet e studimit dhe caktimi i një numri më të madh të ECTS-ve për praktikë;
- ✚ FAG-UHZ duhet të hartojë/zgjerojë listën e partnerëve relevantë të industrisë dhe të krijojë bashkëpunim me ta për ta lehtësuar në vazhdimësi punën praktike dhe punësimin për studentët;
- ✚ FAG-UHZ duhet të forcojë rolin e “Zyrës së Karrierës” dhe të përmirësojë shërbimet e saj për të shtrirë dhe ofruar shërbime të orientimit në karrierë për të gjithë studentët në nevojë. Shërbimet e reja mund të jenë, për shembull, shpërndarja e fondeve të vogla për ide konkurruese të studentëve për fillimin e bizneseve të reja dhe ofrimi i mbështetjes drejt pavarësimin të tyre;
- ✚ FAG-UHZ mund të krijojë ndërmarrje “spin-off”, të cilat do të shërbenin si mbështetëse e ideve novatore të studentëve, si dhe do të gjeneronin të ardhura shtesë për universitetin duke ofruar shërbime për partnerët industrialë.

1.5. Përmbledhje e të gjeturave

Në pikëpamje shumëdimensionale, bazuar nga informacionet e numërta të analizuara, në formë të përmbledhur rezulton se:

- 1) Përkundër ekzistimit të normës së lartë të papunësisë, që luhet mes 27 dhe 40 % varësisht nga burimi i informacionit, ndërmarrjet kosovare në vazhdimësi ankohen për vështirësitë me të cilat ballafaqohen në aspekt të gjetjes së punëtorëve me kualifikime të kërkuara, të nevojshëm për kryerjen e detyrave specifike në profesione të ndryshme;
- 2) Në analizën e realizuar nga dokumente të sipërshënuara rezulton se janë evidentuar mungesa më të mëdha në shkathtësi të punëtorëve në sektorin e prodhimit, dhe pikërisht në ato profile të natyrës teknike që në kushte normale adresën e kanë tek shkollimi dhe aftësi profesionale;
- 3) Shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore në tregun e punës është rreth 40 %, ndërsa edhe më shqetësuese është pjesëmarrja e femrave, me rreth 17%. Kjo nënkupton se rreth 60 % e fuqisë punëtore të moshës 15-64 vjeçare nuk janë aktiv në tregun e punës;
- 4) Sipas Eurostatit, pjesëmarrja e fuqisë punëtore në Kosovë, krahasuar me vendet e BE-së, është rreth 74 %;
- 5) Rreth 72% e fuqisë potenciale punëtore mbetet e paangazhuar, gjë që nënkupton një potencial të madh të humbur për Kosovën;
- 6) Pjesëmarrja e fuqisë punëtore mbetet posaçërisht shqetësuese në mesin e femrave, vetëm rreth 17 % e së cilave janë aktive në tregun e punës, përderisa mbi 490 mijë figurojnë si joaktive në këtë treg;
- 7) Një e dhënë tjetër shqetësuese është papunësia jashtëzakonisht e lartë në mesin e të rinjve të grup moshës 15-24 vjeçare, 49 % e të cilëve figurojnë si të papunë në vitin 2020;

- 8) Këto të dhëna edhe mund të jenë tregues i ndërlidhjes së dobët mes tregut të punës dhe sistemit arsimor në vend, një shqetësim ky i ngritur shumë shpesh nga komuniteti i biznesit në vend;
- 9) Kjo gjendje karakterizohet edhe me dukurinë e punësimit informal. Ajo arsyetohet me faktin e papajtueshmërisë të deklarimeve që bëhen në Trustin Pensional në raport me paraqitjen e numrit të të punësuarve;
- 10) Vështirësi në gjetjen e kadrove të kualifikuara të fuqisë punëtore, të cilët kanë shkathtësitë e nevojshme për të kryer punë të natyrave të ndryshme sipas kërkesës në tregun e punës;
- 11) Hendek strukturor në përgatitjen e fuqisë së shkathtë punëtore që reflekton nevojat e sektorit privat, dukuri e quajtur ndryshe si: “Boshllëku i Shkathtësive”;
- 12) Dukuria e mospërputhjes në mes të kërkesës dhe ofertës në tregun vendor të punës, në veçanti në sektorët e prodhimit, tregtisë dhe shërbimeve profesionale;
- 13) Sipas të dhënave zyrtare për dy vitet e fundit të analizës, punësimi më i lartë rezultoi të jetë te kategoria e profesioneve elementare, që nënkupton hartimin e programeve të reja profesionale;
- 14) Domosdoshmëria e joshjes së të rinjve për të studiuar, përmes përmirësimit të infrastrukturës dhe edukimit digjital;
- 15) Barrën e kësaj përgjegjësie duhet ndarë si institucionet arsimore, ashtu edhe bizneset të cilat nuk japin kontribut të mirëfilltë në këtë aspekt;

1.6. Sfidat e arsimit të lartë

Në mënyrë specifike si sfida të arsimit të lartë përcaktohen me sa vijon:

- 1) Mosrespektimi i standardeve të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë;
- 2) Mospërshtatja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës;
- 3) Prania e pamjaftueshme e punës kërkimore-shkencore në institucionet e arsimit të lartë
- 4) Korniza e pakompletuar ligjore për arsimin e lartë;
- 5) Bashkëpunimi joefektiv ndërkombëtar në arsimin e lartë;
- 6) Proporcioni i ulët dhe i pakënaqshëm në raportin personel universitarë / studentë;
- 7) Kapacitete të dobëta administrative dhe infrastrukturë jo adekuate;
- 8) Mungesa e një plani të financimit të bazuar në efikasitet dhe llogaridhënie;
- 9) Rënia e interesimit të të rinjve për studime në arsim e lartë dhe trendi në rritje i dëshirës së të rinjve për të emigruar;
- 10) Nevoja imediate e digjitalizimit të sistemit të edukimit në arsimin e lartë;
- 11) Hartimi i programeve të përbashkëta studimi me institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë me mundësi të diplomimit të dyfishtë;
- 12) Profilizimi i universiteteve publike dhe programeve të tyre;
- 13) Krijimi i mekanizmave bashkëpunues me bizneset private dhe mirëmbajtja e lidhjeve;
- 14) Harmonizimi i programeve studimore me nevojat e tregut të punës;
- 15) Rritja e shkallës së punësueshmërisë / vetëpunësimit të të diplomuarve.

Tabela nr. 9. Shkalla e punësimit sipas gjinisë dhe grupmohës, shprehur në përqindje. Burimi: ASK, 2022

Punësimi sipas profesioneve dhe gjinisë për vitet 2019 dhe 2020 (mosha 15 e më shumë) shprehur në përqindje							
		2019			2020		
		Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Pjesëmarrja e punësimit sipas profesioneve (%)	Menaxherët	9.5	6.2	8.8	9.9	6.3	9.0
	Profesionistët	11.0	32.5	15.9	11.4	33.4	16.8
	Teknikët dhe bashkëpunëtorët profesionalë	5.5	7.8	6.0	5.7	7.7	6.2
	Punëtorë zyrash dhe asistentë	4.6	10.2	5.9	5.0	11.1	6.5
	Punëtorë për shërbim dhe shitje	23.5	22.6	23.3	23.8	21.5	23.2
	Punëtorë të kualifikuar (aftësuar) në bujqësi, pylltari dhe peshkatari	3.0	1.9	2.8	2.7	2.3	2.6
	Punëtorë të zejeve dhe profesion. të ngjashme	11.8	6.4	10.6	11.6	4.9	10.0
	Operatorët dhe instaluesit në fabrika e makina	7.2	0.6	5.7	7.2	0.7	5.6
	Profesionet elementare	23.8	11.7	21.1	22.7	12.1	20.1
	Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0

2. Analiza e konkurrencës si pjesë e planit strategjik

2.1. IAL-të publike dhe private

Sipas të dhënave zyrtare të MASHTI-t, sistemi i arsimit të lartë në Kosovë në vitin akademik 2020/21, përbëhet nga 24 institucione të akredituara, prej të cilave 9 institucione janë publike dhe 15 private. Këtij numri duhet shtuar edhe Universitetin e Mitrovicës së Veriut, i cili ofron programe në gjuhën serbe. Me këtë numër të institucioneve të arsimit të lartë, Kosova vazhdon të mbetet një ndër vendet me numrin më të madh të institucioneve të arsimit të lartë për 1 milion banorë. Institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Kosovë, në vitin akademik 2020/2021, ofrojnë 400 programe të studimit, prej të cilave 236 programe të studimit janë të nivelit baçelor, 156 programe të studimit janë të nivelit master dhe 8 programe të studimit të nivelit të doktoratës.³

Në vijim prezantohet tabela e IAL-ve publike dhe private të akredituara në Kosovë, sipas njësive akademike. Për shkak se UHZ ka 5 njësi akademike, në tabelë përfshihen vetëm njësitë akademike / fakultetet e IAL-ve tjera të ngjashme me ato të UHZ-së, pavarësisht numrit të tyre. Në këtë mënyrë mundësohet krahasimi i të gjitha IAL-ve që ofrojnë studime të organizuara nëpër njësitë e tyre akademike, gjegjësisht nëpër fakultete

¹⁴ Strategjia e arsimit 2022-2026 / <https://masht.rks-gov.net/strategjia-e-arsimit2022-2026/>

përkatëse. Disa nga IAL-të private (kolegjet) nuk janë të organizuara sipas njësive akademike, prandaj jepen shënime sipas fushës së studimit të programeve të tyre. Gjithashtu, në tabelë përfshihen vetëm IAL-të, të cilat kanë programe të ngjashme me ato të UHZ-së dhe të cilat konsiderohet se mund të kenë ndikim konkurrues me programet e UHZ-së. Megjithatë, ndikim më të theksuar kanë të gjitha programet e ngjashme që ofrohen në qytetet e regionit të Dukagjinit, për shkak të distancës relativisht të shkurtër me Pejën.

Tabela nr.1 Krahasimi i UHZ me IAL-të sipas njësive akademike

	Fakulteti i Biznesit	Fakulteti i MTHM –së	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Agrobiznesit	Fakulteti i Arteve – dega e muzikës
1	UNIVERSITETI I PRISHTINËS				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Bujqësisë	Fakulteti i Artit – Dega e muzikës
2	UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN – 6 FAKULTETE				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
3	UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË				
	Fakulteti i Fakulteti Ushqimore	Ekonomik X	Fakulteti	Juridik	Teknologjisë X
4	UNIVERSITETI “KADRI ZEKA” GJILAN				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
5	UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ				
	Fakulteti i Menaxhmentit	Fakulteti i Turizmit dhe Ambientit	X	X	Fakulteti i Arteve të Aplikuara
6	UNIVERSITETI “FEHMI AGANI” GJAKOVË				
	X	X	X	X	X

6	KOLEGJI AAB – PRISHTINË				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	Fakulteti i Arteve
6.1.	Kolegji AAB me Degë në: Gjakovë				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	X
6.2	Kolegji AAB me Degë në: Ferizaj				
	Fakulteti Ekonomik	X	Fakulteti Juridik	X	Fakulteti i Arteve

7	KOLEGJI UBT - KAMPUSI KRYESOR - PRISHTINË				
	Fakulteti Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi	X	Fakulteti Juridik	Fakulteti i Agrokulturës	Fakulteti i Arteve
7.1.	Kolegji UBT Kampusi në: Pejë - ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve. Programet konkurrencte janë nga fusha e menaxhimit dhe biznesit në të dy nivelet.				
7.2.	Kolegji UBT kampusi në Prizren - ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve				
7.3	Kolegji UBT kampusi në Lipjan - ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve				
7.4	Kolegji UBT kampusi në Gjilan – ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve				
8	KOLEGJI UNIVERSUM – PRISHTINË				
	Programe nga fusha e biznesit dhe menaxhmentit	X	Programe nga fusha e juridikut	X	X
8.1.	Kolegji Universum – Kampusi në Gjakovë – sipas AKA anjë nga programet e akredituara nuk ofrohen në Gjakovë.				
8.2.	Kolegji Universum – Kampusi në Ferizaj – ofrohen disa programe të ngjashme por për shkak të largësisë gjeografike nuk konsiderohet si konkurrentë i drejtëpërdrejt.				
9	KOLEGJI BIZNESI – PRISHTINË <i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
	Programe nga fusha e ekonomisë	X	Programe nga fusha e juridikut	X	X
9.1	Kolegji Biznesi – dega në Gjakovë - ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve				
9.2	Kolegji Biznesi – dega në Prizren - ofrohen të gjitha programet varësisht nga interesimi i studentëve				
10	KOLEGJI DARDANIA – PRISHTINË				
	Nuk ka evidencë mbi njësitë akademike apo programet e akredituara. Nuk ka ende vendim të akreditimit institucional, sipas AKA-së.				
11	KOLEGJI ISPE – PRISHTINË				

	<i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
	Programe nga fusha e ekonomisë	X	Programe nga fusha juridike	X	X
11	KOLEGJI IBC-M – MITROVICË <i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
	Programe nga fusha e ekonomisë		Programe nga fusha e juridikut	Programe nga fusha e bujqësisë	
12	KOLEGJI RIINVEST - PRISHTINË <i>Kolegji ofron programe të akredituara nga fusha ekonomike dhe juridike. Nuk organizohet në njësi akademike.</i>				
	Programe nga fusha e ekonomisë	X	X	X	X
13	Kolegji Pjeter Budi				
	Programe nga fusha e ekonomisë	X	X	X	X
14	Tempulli Academy				
	X	X	X	X	X
15	RIT Kosovo (A.U.K) College				
	Programe nga fusha e ekonomisë	X	X	X	Programe nga fusha e arteve

Burimi: UHZ, 2022

2.2. Fakulteti i Agrobiznesit pranë Universitetit “Haxhi Zeka”

UHZ ka gjithsej 17 programe të akredituara, të cilat janë pjesë e 5 njësive akademike: Fakulteti i Biznesit, Fakulteti i MTHM –së, Fakulteti Juridik, Fakulteti i Agrobiznesit dhe Fakulteti i Arteve - Dega e muzikës. Si konkurrentë të drejtpërdrejt të UHZ-së konsiderohen të gjitha IAL-të (publike dhe private) që operojnë dhe ofrojnë studime/programe të ngjashme në regjionin e Dukagjinit, përkatësisht në qytetet: Pejë, Gjakovë dhe Prizren. Më tej, ndërkaq, konkurrent mbetet Universiteti i Prishtinës, si lider i arsimit të lartë në Kosovë. Prandaj, programet e studimit të UHZ-së do të krahasohen me UP-në dhe me institucionet e tjera të arsimit të lartë që ofrojnë programe konkurrencte në rajonin e Dukagjinit.

Tabela nr.2 Programet e akredituara të FAG-it

Nr.	Programet e studimit të vlerësuara gjatë vitit 2022	Numri i studentëve të aprovuar nga KSHC	Periudha kohore e riakreditimit	Vendimi
FAKULTETI I AGROBIZNESIT				
1	Teknologji e Prodhimit Bimor, BSc	50	2022-2025	Ref: 944/22 18.07.2022
2	Agromjedis dhe Agroekologji, BSc	50	2022-2025	Ref: 944/22 18.07.2022
3	Teknologji Ushqimore, BSc	60	2022-2025	Ref: 1778/22 20.10.2022
4	Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, MSc	25	2021-2024	Ref: 3025/21 12.08.2021
5	Menaxhim Mjedis, MSc	25	2021-2024	Ref: 3025/21 12.08.2021

Burimi: UHZ, 2022

Në kuadër të Planit Strategjik 2023-2026, FAG-it është përcaktuar për profilizim të programeve dhe të institucionit. Meqenëse Peja dhe rajoni i saj është e njohur për traditën në biznes, agrobiznes, art, kulturë dhe turizëm, UHZ i ka orientuar programet e studimit drejt tyre, në mënyrë që të jetë në gjendje t'u përgjigjet nevojave të tregut të punës. Përafrimi me tregun e punës dhe nevojat e saj është planifikuar të reflektohet në programet me orientim kah biznesi dhe ndërmarrësia, të cilat besohet se do ta përforcojnë pozitën e saj përballë rivalëve të tjerë publikë ose privatë, konkurrentë në arsim e lartë.

2.3. Universiteti "Hasan Prishtina" - Prishtinë

Universiteti i Prishtinës i ka 14 fakultete, të gjitha me vendndodhje në Prishtinë. Programet e UP-së, të ngjashme me ato të UHZ-s, të cilat potencialisht mund t'i bëjnë konkurrencë UHZ-së, jepen në vijim, në katër fakultete homologe me UHZ-në. Edhe pse programet mund të jenë të njëjta ose të ngjashme me ato të UHZ-së, nuk konsiderohet si konkurrente e drejtpërdrejtë për shkak të largësisë gjeografike të Prishtinës nga Peja prej rreth (90 km). Sidoqoftë, për shkak të tendencës së mundshme të të rinjve për të studiuar në Prishtinë, një numër i të rinjve migrojnë nga qyteti i Pejës dhe nga rajoni i Dukagjinit. Sidoqoftë, nuk ka të dhëna për një numër të tillë të lëvizjeve brenda vendit për qëllime studimi.

Në përgjithësi, UP me programet e saj është një konkurrent për të gjitha IAL publike dhe private në tërë vendin për shkak të traditës, emrit, personelit me reputacion dhe vendndodhjes së njësive të saj akademike në Prishtinë, si kryeqendër e Kosovës. Për të gjitha IAL-të që veprojnë në rajonin e Prishtinës, UP është konkurrent i fortë për programet e njëjta apo të ngjashme. Në tabelën e mëposhtme, programet e UP-së që

konsiderohen se kanë ndikim latent rivaliteti me programet e UHZ-së janë të shënuara me ngjyrë të kuqe, për t'u dalluar.

Tabela nr.3 Programet e akredituara të UP "Hasan Prishtina" – Prishtinë

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"						
Faculty of Economics						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
Faculty of Agriculture and Veterinary						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
1	Agricultural Economics	Prishtinë	BSc	180	100	9/30/2024
2	Agriculture and Food Economics	Prishtinë	MSc	120	20	9/30/2024
3	Applied Animal Sciences	Prishtinë	MSc	120	20	9/30/2024
4	Animal Production	Prishtinë	BSc	180	70	9/30/2024
5	Plant Sciences	Prishtinë	MSc	120	15	9/30/2026
6	Food Technology with Biotechnology	Prishtinë	BSc	180	100	9/30/2024
7	Plant Production	Prishtinë	BSc	180	100	9/30/2024
8	Plant Protection-Phytomedicine	Prishtinë	MSc	120	20	9/30/2024
9	Veterinary Medicine	Prishtinë	DVM	300	20	9/30/2024
10	Pomology and Viticulture	Prishtinë	MSc	120	20	9/30/2024
11	Urban Agriculture	Prishtinë	MSc	120	20	9/30/2023

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, identifikohen 3 programe, të cilat emërtohen ngjashëm / përafërt me ato të FAG-it, sipas njësisë akademike. Më saktësisht, 3 në Fakultetin e Agrobiznesit.

Programet e UP-së që janë të ngjashme dhe që potencialisht mund t'i bëjnë konkurrencë FAG-it, jepen në vijim sipas fakultetit homologe me ato të FAG-it:

1. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

- ▶ Ekonomia e Bujqësisë - bachelor;
- ▶ Ekonomia e Bujqësisë dhe Ushqimit - master;
- ▶ Teknologji Ushqimore me Bioteknologji - bachelor;

2.4. Universiteti "Isa Boletini" – Mitrovicë

Universiteti i Mitrovicës ka gjithsej 18 programe të akredituara, nga të cilat vetëm 2 janë të ngjashme me programet e UHZ. Kampusi universitar ka ndërtesa të reja, konvikt dhe hapësirë të mjaftueshme për studentë. Largësia gjeografike e Mitrovicës nga Peja është rreth 70 km. Prandaj programet e ngjashme me ato të UHZ-së nuk shihen me peshë konkurruese. Konsiderohet se konkurrent i drejtpërdrejt i programeve të tij studimore është kolegji IBCM dhe UP-ja. Programet që kanë ndikim të lehtë të konkurrencës me ato të UHZ-së janë të shënuara me të kuqe.

Tabela nr.4 Programet e akredituara të Universitetit “Isa Boletini” – Mitrovicë

University of Mitrovica "Isa Boletini"						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
1	Technology	Mitrovicë	Bsc	180	100	9/30/2025
2	Technology	Mitrovicë	Msc	120	20	9/30/2025
3	Food Engineering and Technology	Mitrovicë	Bsc	180	100	9/30/2025
4	Food Engineering and Technology	Mitrovicë	Msc	120	30	9/30/2022

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Asnje nga programet nuk janë të ngjashme me ato të UHZ-së, që të dyja në nivelin baçelor të studimit.

2.5. Universiteti “Ukshin Hoti” - Prizren

Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren ka gjashtë njësi akademike me 20 programe studimi, në nivelin baçelor dhe master. Disa nga programet janë në gjuhën boshnjake dhe turke. Prizreni gjendet në regjionin e Dukagjinit, përderisa largësia nga Peja është rreth 70 km.

Tabela nr. 5. Programet e akredituara të universitetit “Ukshin Hoti” – Prizren

University of Prizren "Ukshin Hoti"						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
1	Forest and Environmental Sciences	Prizren	BSc	180	50	9/30/2024
2	Agribusiness	Prizren	BSc	180	80	9/30/2024
3	Agribusiness Management	Prizren	MSc	120	15	9/30/2024

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

dy programe (të shenjuara në tabelën e sipërme) janë të ngjashme ose të përafërta me programet studimore të FAG-ut, të shpërndara sipas fushës së studimit, gjegjësisht njësi akademike në të dy nivelet e studimit, 2 programe me ato të Fakultetit të Agrobiznesit, të cilat listohen si në vijim:

- ▶ Shkencat e Pyjeve dhe të Mjedisit-baçelor;
- ▶ Agrobiznes - baçelor;
- ▶ Menaxhim në Agrobiznes - master;

2.6. Kolegji “AAB”

Studimet në kolegjin “AAB” zhvillohen në fusha studimi, të shpërndara nëpër fakultete përkatëse. Në kuadër të këtyre fakulteteve, veprimtarinë e vet e zhvillojnë 50 programe në nivelin bachelor dhe në nivelin master të studimeve. Përveç programeve të rregullta, ofrohen edhe programe për studentë pa shpërndarje nga puna. Kolegji është i shpërndarë në 3 kampuse: Prishtinë, Ferizaj dhe Gjakovë. Dega në Gjakovë është gjeografikisht më afër Pejës (36 km) dhe konsiderohet se nuk është konkurrent i drejtëpërdrejt i FAG-it. Në këtë degë nuk organizohen studime të programeve të ngjashme me ato të FAG-it.

Programet e kolegjit nuk janë të ngjashme me FAG, në tabelën vijuese.

Tabela nr. 6. Programet e akredituara të kolegjit “AAB”

AAB College						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Nga programet e veçuara, të identifikuar në degën e Gjakovës, të ngjashme me programet e FAG-në, të cilat organizohen në kampusin e Prishtinës. Megjithëse, potenciali konkurrues i këtyre programeve konsiderohet të jetë i lehtë për shkak të largësisë gjeografike, FAG duhet të merr parasysh për të modifikuar / ndryshuar programet plotësisht identike, në mënyrë që të jenë në harmoni me planifikimin strategjik për profilizim të programeve.

Përparësi e dukshme e FAG-ut është se kolegji “AAB” nuk ka kampus në Pejë, nuk ofron studime në gjuhën boshnjake dhe aplikon tarifa të konsiderueshme për studentë. Megjithatë, ajo nuk ofron programe të ngjashme me FAG-it.

2.7. Kolegji “UBT”

“UBT” aktualisht ka programe të akredituara të ndryshme studimi. Këto karakteristika e bëjnë këtë kolegji një rival të fortë për të gjitha IAL-të në Kosovë. Degët e saj në Pejë dhe në Prizren e bëjnë konkurren të drejtpërdrejtë me UHZ-në sa u përket programeve të ngjashme apo të përafërta studimi. Megjithatë, pjesa dërmuese e programeve janë nga kampusi kryesor i kolegjit, në Prishtinë. Në vijim jepet tabela me të gjitha programet e saja studimore sipas degëve në të cilat organizohen studimet.

Tabela nr.7 Programet e akredituara të kolegjit “UBT”

UBT College						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
1	Agriculture and Environmental Engineering	Prishtinë	BSc	180	100	9/30/2025
2	Food Science and Technology	Prishtinë	MSc	120	100	9/30/2025
3	Food Science and Technology	Prishtinë	BSc	180	100	9/30/2024
4	Food Science and Biotechnology	Prizren	BSc	180	40	9/30/2024

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Dega e Kolegjit në Pejë organizon studime në dy programe në nivelin e studimeve themelore:

Që të 2 këto programe janë identike me programet / specializimet që ofron FAG-it.

Dega në Prizren, po ashtu konsiderohet me potencial konkurrues. Në nivelin e studimeve themelore, ekzistojnë 4 programe të krahasueshme apo të ngjashme me ato të UHZ-së. Njëra nga to, e fushës së agrobiznesit përmban 4 specializime, të cilat janë:

✚ Shkencat e ushqimit dhe bioteknologjisë / specializimet:

- a) Teknologjia e Ushqimit;
- b) Nutricion (Të ushqyerit);

- c) Menaxhimi dhe Sigurimi i Cilësisë të Ushqimit;
- d) Shkenca dhe Inxhiniera e Ushqimit;
- e) Inxhinieria e Agrokulturës dhe Mjedisit;

Përveç programeve e lartcekura nga degët në Pejë dhe në Prizren, që identifikohen si të ngjashme me ato të UHZ-së, ekzistojnë edhe 6 programe të tjera, të cilat janë të krahasueshme / mjaft të ngjashme me programet aktuale të UHZ-së. Këto programe organizohen në kampusin kryesor në Prishtinë, e të cilat jepen në vijim:

- ✚ Shkenca e Ushqimit dhe Teknologjia – master;
- ✚ Bujqësia dhe Inxhinieria e Mjedisit - e studime themelore;

2.8. Kolegji “Universum”

Sipas AKA, kolegji ka gjithsej 16 programe të akredituara në nivelin bachelor me disa specializime. 2 nga programet janë të modelit “diplomë e dyfishtë”. 6 programe/specializime me diplomë nga universiteti Northampton dhe 5 programe profesionale nga niveli 3, 4 dhe 5 të KKK-së. Programi: Biznes dhe Menaxhment, në nivelin e studimeve themelore është specifik sepse u ofron studentëve tri mundësi: . studime të zakonshme 3-vjeçare me diplomë të kolegjit, me diplomë të dyfishtë dhe me diplomë nga universiteti Northampton, Britani e Madhe.

Diploma e dyfishtë në Biznes dhe Menaxhment është program trevjeçar i cili ofrohet bashkërisht nga kolegji “Universum” në Kosovë dhe “Kajaani University of Applied Sciences” në Finlandë. Në kuadër të këtij programi, studentët i përfundojnë dy vjet në kolegjin “Universum” dhe vazhdojnë vitin e tretë në Kajaani University of Applied Sciences në Finlandë. Lista e programeve të akredituara jepet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.8 Programet e akredituara të Kolegjit “Universum”

Universum College						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Ka evidencë nje programë i perbashket me FAG-un.

Distanca gjeografike që Peja e ka me Prishtinën, bashkë me pagesën për studime që aplikojnë kolegjet private (nuk ka të dhëna mbi lartësinë e pagesës), çështja e konkurrencës së drejtpërdrejtë me FAG-it konsiderohet se zbutet shumë. Njëkohësisht, faktet e lartcekurakonsiderohen përparësi për UHZ-në. Përparësi tjetër e FAG-ut në raport me këtë konkurrent janë se kolegji “Universum” nuk ka kampus në Pejë. Përparësi e kolegjit është infrastruktura moderne, pajisjet digjitale dhe ndërtesat e reja dhe joshëse për studentë.

2.9. Kolegji “Biznesi”

Kolegji “Biznesi” është një tjetër institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë. Përveç selisë në Prishtinë, kolegji ka njësi edhe në Prizren, Gjakovë dhe Vushtrri, ku zhvillohen studime në programet e akredituara në nivelin e studimeve themelore dhe master. Me disa nga programet e saj në degën e Gjakovës dhe Prizrenit trajtohet si konkurrente e UHZ nga pikëpamja gjeografike. Programet e akredituara të saj janë:

Tabela nr. 9. Programet e akredituara të kolegjit “Biznesi”

Biznesi College						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Nga të dhënat e AKA-së, të paraqitura në tabelën e mësipërme, është e dukshme se dega në Gjakovë nuk ka program të akredituar.

Në përgjithësi, potenciali konkurrues i kolegjit në raport me programet e FAG-ut duket mjaft i zbehtë, pavarësisht se ka infrastrukturë moderne. Konsiderohet, se FAG-it ka përparësi ngase vetëm një program i kolegjit ofrohet në diametrin e zonës së konkurrencës, që është regjioni i Dukagjinit.

2.10. Kolegji “ICBM” - Mitrovicë

Kolegji “ICBM” është institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë me seli në Mitrovicë. Secili program ofron dy nivele të kualifikimit: Academy Profession (AP): 2 vjet studimi, i barasvlershëm me 120 ECTS kredi dhe Bachelor: 3.5 vjet, ekuivalent me 210 ECTS kredi. Programet e akredituara të saj janë:

Tabela nr. 10. Programet e akredituara të kolegjit “IBC-M”

International Business College Mitrovica (IBC-M)						
Nr.	Study Program English	Campus	Level	ECTS	Quota	Accredited Until
1	Environment and Agriculture Management	Mitrovicë	BA Professional	210	100	12/31/2024
2	Sales and International Marketing	Mitrovicë	BA Professional	210	100	12/31/2024
3	Public Service Management	Mitrovicë	BA Professional	210	100	12/31/2024
4	Public Administration and Ëelfare	Mitrovicë	BA Professional	210	100	12/31/2024
5	Applied Information Technology	Mitrovicë	BA Professional	210	60	9/30/2025
6	International Management and Leadership	Mitrovicë	MSc	120	132	12/31/2025

Burimi: AKA (dhjetor, 2022)

Programe të ngjashme me FAG-it janë identifikuar të jenë një sish, nga të cilat njëra është e nivelit profesional dhe tjetra e nivelit master.

✚ Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë- BA;

Përparësi e kolegjit është infrastruktura moderne dhe pajisjet digjitale për mësimdhënie. Dobësi e kolegjit është se aplikon tarifa të larta për studime, njëjtë sikurse IAL-të private. Përparësi e FAG-it janë programet nga fusha të ndryshme studimi.

2.11. Matrica e krahasueshmërisë së programeve

Tabela matricë e krahasueshmërisë së programeve të UHZ me programet e ngjashme që ofrohen nga institucionet rivale të arsimit të lartë në Kosovë jep një pasqyrë përmbljedhëse mbi intensitetin e konkurrencës në mes tyre.

Tabela nr.11 Matrica e krahasimit

UHZ PROGRAMS IN COMPARISON WITH COMPETITIVE HEI PROGRAMS									
Nr.	Study Programs of UHZ	UP Prishtinë	UM. Isa Boletini	UPZ Prizren	AAB	UBT	Univer-s-um	ICBM	Kolegji Biznesi
1	Agro-environment and Agroecology	Yes	NO	Yes	NO	Yes	NO	NO	NO
2	Food Technology	Yes	NO	NO	NO	Yes	NO	NO	NO
3	Plant Production Technology	Yes	NO	NO	NO	NO	NO	NO	NO
4	Environmental Management	NO	NO	Yes	NO	NO	NO	Yes	NO
5	Sustainable Food Production Systems	Yes	NO	NO	NO	Yes	NO	NO	NO

Burimi: UHZ, 2022

Nga të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme, mund të nxjerrim këto konstatime:

- ✚ Programet me konkurrencë të lehtë janë (1-2 konkurrentë): Teknologji Ushqimore, Teknologji e Prodhimit Bimor, Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor, Menaxhimi i Mjedisit, (BA dhe MA);
- ✚ Programet me konkurrencë mesatare, Agromjedis dhe Agroekologji.

3. Analiza e bazës ligjore

Ligji për Arsimin e Lartë - krijon bazë ligjore gjithëpërfshirëse për: “rregullimin, funksionimin, financimin, sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në përputhje me standardet evropiane si dhe rolin e shtetit dhe shoqërisë në zhvillimin e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës” (Neni 1). Struktura e kredive mësimore që studenti duhet t’i arrijë për diploma të niveleve përkatëse është e bazuar në Sistemin Evropian të Transferimit të Kredive dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Nga institucionet përkatëse për formimin dhe ecurinë e suksesshme të politikave për arsim të lartë, ligji identifikon Ministrinë e Arsimit si institucionin primar për zhvillimin e planeve, autorizimin, shpërndarjen e fondeve, etj.; Agjencinë e Akreditimit si trup përgjegjës për

akreditim etj., për të cilat ndahen edhe parimet dhe dispozitat relevante. Ligji cakton edhe dispozitat për licencim të bartësve privat të arsimit.¹⁴

Ligji përcakton parimet dhe standardet e ofrimit të arsimit të lartë në Republikë, në përputhje me synimet strategjike të zonës evropiane të arsimit të lartë të shprehura në Deklaratën e Ministrave Evropianë të Arsimit të Lartë nga Bolonja (1999).

Ligji për Arsimin e Lartë ka futur një numër të madh risish sa i përket autonomisë dhe organizimit të institucioneve të arsimit të lartë, kushte që duhet t'i plotësojnë institucionet e arsimit të lartë Për ta kryer veprimtarinë e tyre, organizimin e studimeve, si dhe çështje të tjera të rëndësishme.

Ato janë:

- ✚ angazhohet në punë mësimore dhe kërkimore shkencore dhe kryen studime të ciklit të parë me synime që përfshijnë përgatitjen dhe aftësimin e individëve për zhvillimin profesional, ekonomik e kulturor dhe promovimin e një shoqërie demokratike dhe arritjen e standardeve të larta të mësimdhënies dhe të nxënit;
- ✚ realizon të paktën një program studimi në një fushë të arsimit.
- ✚ Kolegji është një institucion i arsimit të lartë që: Institucionet e arsimit të lartë janë universitetet dhe kolegjet.
Universiteti është një institucion i arsimit të lartë që:
- ✚ angazhohet në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, kryen të tre ciklet e studimit me synime që përfshijnë përmirësimin e njohurive, mendimit dhe shkollimit në Republikë, zhvillimin arsimor, kulturor, social dhe ekonomik, promovimin e një shoqërie demokratike dhe arritjen e standardeve më të larta të punës mësimore dhe kërkimore-shkencore dhe
- ✚ realizon të paktën pesë programe të ndryshme studimi nga të paktën pesë fusha të arsimit.

Institucionet e arsimit të lartë janë jofitimprurëse dhe e kryejnë veprimtarinë e tyre si shërbim publik. Procedura e akreditimit kryhet për: ata që i shfrytëzojnë arritjet për zhvillimin dhe përmirësimin e veprimtarive të tyre të arsimit të lartë.

Institucioni i arsimit të lartë gëzon lirinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor mbështetur në licencës së marrë.

Institucionet e arsimit të lartë të sapokrijuar dhe për programe të reja studimi, me synim përcaktimin: Universitetet kanë njësi organizative: fakultete, akademi, institute shkencore, si dhe njësi të tjera organizative që kryejnë punë mësimore, kërkimore shkencore dhe artistike në një ose më shumë fusha arsimore dhe shkencore. Institucioni i arsimit të lartë mund të fillojë me punë dhe të kryejë veprimtari nëse i plotëson kushtet e përcaktuara organizative, kadrore, hapësinore, materiale dhe teknike, nëse ka bibliotekë dhe pajisje informatike për zhvillimin e mësimin dhe plotëson kërkesat e tjera të përcaktuara me ligj dhe akte të tjera. Institucionet e arsimit të lartë që para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë marrë leje pune nga ministria përkatëse, konsiderohen të licencuara (plotësojnë kushtet për kryerjen e veprimtarive të përcaktuara me ligj) dhe të akredituara (institucioni i arsimit të lartë përmbush standardet e cilësisë dhe kualifikimi që i cakton titullarit, i jep titullarit të caktuara të drejta, pra akses në fazën e ardhshme të arsimit, një profesion të caktuar, përdorimin e titullit etj.), në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

¹⁴ Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2761>

Ligji i mundëson universitetit të punësojë asistentë nga një universitet tjetër, pra një fakultet ose akademi arti, brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me rregulloret që rregullojnë fushën e punësimit. Kurrikula përcakton: kohëzgjatjen e studimeve, lëndët dhe orarin e tyre sipas viteve dhe semestrave, si dhe numrin e orëve për forma të ndryshme të mësimdhënies. Sipas ligjit, të gjithë personat që kanë përfunduar shkollën e mesme katërvjeçare në Republikën e Kosovës, si dhe studentët që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, kanë akses në arsimin e lartë.

Në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe me [Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës](#),⁵ një institucion i arsimit të lartë plotëson kërkesat e personelit për punën dhe kryerjen e veprimtarive nëse ka të paktën gjysmën e numrit të përgjithshëm të mësimdhënësve që kërkohen për mësimdhënien e të gjitha lëndëve mësimore, për të gjitha vitet e studimit, në punë me kohë të plotë për çdo studim. program.

Institucioni i arsimit të lartë (IAL) zhvillon në mënyrë të vazhdueshme, në fund të çdo viti akademik dhe më së largu në interval prej tre vjetësh, procedurën e vetëvlerësimit dhe vlerësimit të cilësisë së programeve të tij të studimit, mësimdhënies dhe kushteve të punës. Institucioni i arsimit të lartë, pra njësi organizative e institucionit të arsimit të lartë, e kryen këtë procedurë në përputhje me procedurat për sigurimin e cilësisë së institucionit të arsimit të lartë dhe kriteret e vetëvlerësimit. Raporti për vetëvlerësimin dhe vlerësimin e cilësisë publikohet në mënyrë që të jetë në dispozicion të stafit akademik dhe studentëve në atë institucion. Akreditimi është procesi i sigurimit të cilësisë së një institucioni të arsimit të lartë ose program studimi, bazuar në vetëvlerësimin e institucionit të arsimit të lartë dhe vlerësimin e ekspertëve të pavarur, me qëllim njohjen dhe përmirësimin e cilësisë së arsimit të lartë brenda BE-së. fusha e arsimit të lartë. Akreditimi kryhet në tre faza:

- a) vetëvlerësimi nga institucionet e arsimit të lartë,
- b) verifikimi i jashtëm nga një komision ekspertësh dhe
- c) miratimi i vendimit për akreditim.

Ligji për Kualifikimet Kombëtare. Qëllimi kryesor i ligjit është krijimi i një sistemi të kualifikimeve. Ky sistem bazohet në Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve. Kjo nënkupton që shteti themelon Kornizën e Kualifikimeve në nivel kombëtar, në bazë të kriterëve dhe kërkesave që përputhen me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Ligji ka si objektiva: “të përmirësojë njohjen e kualifikimeve në të gjitha nivelet e arsimit dhe aftësimin formal dhe joformal; të sigurojë se kualifikimet përmbushin nevojat e tregut të punës, ekonomisë dhe shoqërisë; të rregullojë kualifikimet, vlerësimin dhe certifikimin, në bazë të cilësisë dhe standardeve; të përmirësojë qasjen në vlerësim dhe njohjen e mësimit paraprak; të bëjë sistemin e kualifikimeve fleksibil dhe transparent; të përmirësojë mundësitë për përmirësim dhe transferimin për të gjithë.”¹⁷

Ligji për Veprimtari Kërkimore-Shkencore. Me këtë ligj rregullohen: themelimi, veprimtaria, organizimi, qeverisja, të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve shkencorë dhe të hulumtuesve në këtë veprimtari, pozita e Këshillit Kombëtar të Shkencës, miratimi dhe zbatimi i Programit Kombëtar të Shkencës, bazat e

¹⁶[https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/10/Udhezim Administrativ MASHT Nr. 015 2018 per Akreditimin e Institucioneve te Arsimit te lart e ne Republiken e Kosoves.pdf](https://akreditimi.rks-gov.net/ep-content/uploads/2020/10/Udhezim_Administrativ_MASHT_Nr._015_2018_per_Akreditimin_e_Institucioneve_te_Arsimit_te_lart_e_ne_Republiken_e_Kosoves.pdf)

financimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore¹⁸, si dhe çështje të tjera lidhur me veprimtarinë kërkimore-shkencore në Kosovë.

Ligji për inovacion shkencor dhe transfer të dijes dhe teknologjisë. Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i fushës së inovacionit shkencor, transferit të dijes dhe teknologjisë në Republikën e Kosovës.¹⁹

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Neni 107 Arsimit dhe Trajnimi:²⁰ Palët bashkëpunojnë me synim ngritjen e nivelit të arsimit të përgjithshëm dhe arsimit dhe aftësitë profesionale, ashtu si edhe të politikave për rininë dhe punës me rininë, si mënyrë për të nxitur zhvillimin e aftësive, punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik në Kosovë. Një nga përparësitë për sistemin e arsimit të lartë është arritja e standardeve adekuate të cilësisë të institucioneve dhe programeve të saj në përputhje me objektivat e Procesit dhe Deklaratës së Bolonjës. Palët bashkëpunojnë gjithashtu për të garantuar që qasja në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit në Kosovë të mos i nënshtrohet diskriminimit në bazë të gjinisë, origjinës racore ose etnike, fesë apo besimit, aftësisë së kufizuar, moshës ose orientimit seksual. Bashkëpunimi do të synojë trajtimin e nevojave të studentëve me aftësi të kufizuara në Kosovë. Bashkëpunimi do të synojë gjithashtu zhvillimin e kapaciteteve për hulumtim dhe inovacion, sidomos përmes projekteve të përbashkëta të kërkimit dhe inovacionit që përfshijnë të gjitha palët e interesit, duke siguruar transferimin e ekspertizës. Programet dhe instrumentet përkatëse të BE-së do të kontribuojnë në përmirësimin e strukturave dhe veprimtarive arsimore, trajnimeve, kërkimit dhe inovacionit në Kosovë. Bashkëpunimi merr në konsideratë fushat prioritare që lidhen me “acquis” të BE-së në këtë fushë.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2021-2025,

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) 2021-2025 është programi i gjashtë me radhë për zbatimin e MSA-së ndërmjet Bashkimit Evropian (BE) dhe Republikës së Kosovës. Ai është dokumenti kryesor kombëtar i politikave dhe planifikues për zbatimin e reformave për adoptimin e tërë acquis-së së BE-së në legjislacionin kombëtar. Ai zbatohet krahas fazës së dytë të Agjendës për Reforma Evropiane (ERA II), e cila përcakton prioritetet politike dhe reformat për përmbushjen e tyre, dhe është e ndërlidhur me të. ERA II do të zbatohet brenda dy vjetësh nga miratimi i saj, përmes një plani veprimi (PV ERA II), të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës (Kapitulli 25 i “acquis”, Arsimit dhe kultura).²¹

¹⁷Ligji Nr. 03/L-060 Për Kualifikimet Kombëtare, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2606>

¹⁸Ligji nr. 04/L-135 për veprimtari kërkimore – shkencore.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=8660>

¹⁹Ligji nr. 06/L-049 për Inovacion Shkencor dhe Transfer të Dijes dhe Teknologjisë,

<https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18188>

²⁰ Marrëveshja e Stabilizim Asociimit mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian, tetor 2015: Këshilli i Bashkimit Evropian. <https://www.mei-ks.net/en/stabilization-association-brprocess->

²¹Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (PKZMSA) 2021-2025,

[https://meiks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202021-2025%20\[miratuar%20nga%20Kuvendi\].pdf](https://meiks.net/repository/docs/1%20PKZMSA%202021-2025%20[miratuar%20nga%20Kuvendi].pdf)

4. Analiza e profilit të fakultetit

4.1. Vendndodhja e fakultetit

Fakulteti i Agrobiznesit pranë Selise se universitetit "Haxhi Zeka" është në Pejë, në Republikën e Kosovës. Komuna e Pejës është njësi administrative në pjesën veri-perëndimore të Kosovës. Peja gjithashtu është qendër e regjionit të Dukagjinit me gjerësi afro 1.500 km², kurse me gjithë fshatrat i ka 603 km². Brenda kufijve administrativë të Komunës së Pejës ka 97 vendbanime të organizuara në 28 bashkësi territoriale. Komuna e Pejës kufizohet me: Istogun, Klinën, dhe Deçanin. Kurse, me komunën e Plavës, Beranës dhe Rozhajës kufizohet me Malin e Zi. Në anën tjetër, kufizohet me Republikën e Shqipërisë. Territori i Komunës së Pejës përbehet nga dy tërësi gjeografike: njëra me klimë kontinentale të shprehur klimë mesdhetare që përfshin përafërsisht 30% të sipërfaqes së përgjithshme, dhe vargmalet e Alpeve shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar që ndikon si modifikim i klimës në këtë pjesë.

Peja është qyteti me perëndimor i Kosovës dhe zë vend me rëndësi në tërë Rrafshin e Dukagjinit. Peja, së bashku me tërë Rrafshin e Dukagjinit, shtrihet ndërmjet gjerësisë veriore gjeografike 45-50' dhe 42-53' dhe gjatësisë gjeografike lindore 19o58'30"-210. Qyteti i Pejës është i vendosur në terasën neogjene aluviale në lartësi mbidetare 505- 520m. Ky qytet shtrihet në fushën e Rrafshit të Dukagjinit dhe rrëzë bjeshkëve të larta. Me rrjedhë të shpejtë Grykës shkëmbore të Rugovës, lumi Lumbardh (Bistrica) fillon të gjarpërojë fushën e Pejës, duke kaluar mes për mes qytetit dhe duke e ndarë atë në dy pjesë. Lumbardhi gjatë rrjedhës formon fusha pjellore, derdhet në lumin më të madh, të quajtur Drini i Bardhë, që buron nga bjeshka e Zhlebit në fshatin Radavc. Drini i Bardhë gjarpëron nëpër tërë anën perëndimore të Rrafshit të Dukagjinit për t'u bashkuar me Drinin e Zi, që vie nga jugu (Dibra) në Kukës, për të formuar lumin Drini, që derdhet në Detin Adriatik.

Qyteti është i rrethuar me Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare), që janë pjese e masivit Dinarik, i cili e përfshin tërë Ballkanin Perëndimor. Këto bjeshkë formojnë një kurorë majash të larta, siç janë: maja e Kopraniikut (2460m), malet e Lumbardhit, gjegjësisht Guri i Verdhë (2522m), maja e Vjedullakut (2012m), Peklena, maja e Hasanit etj.

Me t'u gjendur kudo në qytet bie në sy dukshëm Gryka e Rugovës, e cila flet për veten, për bukurinë e saj që tërheq çdo vizitor për të shtegtuar brendapërbrenda saj. Vetë Rugova, me fshatrat që e përbejnë, si p.sh., Drelaj, Shtupeq, Kuqishte, Boge etj., janë grumbull i bukurive të rralla natyrore. Rugova, me të gjitha karakteristikat e saj, mund të shndërrohet në qendër sportive-rekreative dimërore të nivelit botëror. Që tani atje ekzistojnë filizat e hotelarisë malore. Në fshatin Bogë janë hapur shumë hotele, që ofrojnë shërbime të nivelit të lartë. Nga këtu, gjatë stinës së verës, brenda ditës organizohen shumë shëtitje. Shtigjet kalojnë nëpër gryka, kullosa e liqene glaciale me bukuri të rrallë, por gjatë rrugës mund të kalohet edhe pranë bjeshkëve të thepisura, në të cilat hasen dhi të egra e nganjëherë edhe shqiponja, që janë simbol i popullit që i banon këto bjeshke. Shtigjet që dredhojnë nëpër bjeshkë të dërgojnë deri te vendbanimet sezonale të barinjve, që ju ofrojnë mikpritje tradicionale. Dimrit, livadhet që shfrytëzohen për kullosa jo rrallë shndërrohen në shtigje skijimi.

Fushat rreth e përqark qytetit në jug, juglindje, lindje dhe verilindje janë pjellore dhe kanë qenë të shfrytëzuara si të tilla ndër shekuj. Përpos bimëve foragjere, këtu kultivohen pemët dhe perimet e ndryshme, por edhe në kodrinat verilindore të qytetit është kultivuar dhe kultivohet edhe sot, madje në masë të vogël, hardhia e rrushit, nga e cila disa qytetare me tradite të lashtë nxjerrin verë dhe raki të cilësisë së lartë.

Që në kohërat e lashta, Peja ka qenë udhëkryq lidhjeje, që lidhte rajone të rëndësishme tregtare. Edhe sot këndeje kalojnë rrugët që kryqëzohen nga brendia e Ballkanit kah detërat e ngrohta (Adriatik dhe Egje). Peja,

me vija rrugore e hekurudhore, lidhet me qendra tjera të Kosovës, por edhe jashtë saj. Ne drejtim verilindje lidhet me qytetin industrial, Mitrovicën, për të vazhduar me tutje me autostradën bregdetare që dërgon në bregdetin e Shqipërisë dhe të Malit të Zi. Me vijë rrugore e hekurudhore përmes Fushë-Kosovës qyteti lidhet me kryeqendrën e Kosovës, Prishtinën. Nga këtu me automjet, autobus ose tren mund të vazhdohet tutje për Egje, gjegjësisht Selanik, përmes Shkupit. Në jug me vijë rrugore Peja lidhet me Gjakovën, përmes qytezës së Deçanit. Ne këtë qytezë gjendet një monument i rëndësishëm historik: kisha ortodokse shqiptare - bizantine e punuar nga mjeshtri i Kotorit. Stili i punimit të saj është i ngjashëm me atë të bazilikave bregdetareose faltoreve të stilit romak bregdetar. Më tutje, nga Gjakova rruga dërgon në Prizren e Shkup ose Tetovë, ose në Kukës e Tiranë.

Ne rrugën Pejë-Mitrovicë, jo larg qytetit, gjendet burimi termal i njohur qysh nga koha antike - romake. Aty sot gjendet hoteli "Onix" me qendrën rehabilituese rekreative. Gjatë tërë vitit këtu vijnë vizitorë të shumtë, moshash të ëndryshme. Vetë qyteti është mjaft tërheqës. Aty mund të hasni në shumësi kulturash. Gjatë shëtitjeve, mund të hasni në banorë shqiptarë që përbejnë shumicën dërmuese të strukturës së popullatës por ka edhe boshnjakë, serbë, malazezë etj.

Për në shumë informata për qytetin e Pejës dhe Rajonin e Dukagjinit ju mund të lexoni në këto vegza:

1. <https://www.youtube.com/watch?app=desktop&v=cj9b2413HOE>
2. <https://pejatourism.org/en/info-te-nevojshme/>
3. <https://www.britannica.com/place/Peja>
4. <https://albania.123.st/t4088-gjeografia-e-pejes>
5. <https://en.wikipedia.org/wiki/Peja>
6. <https://en.wikivoyage.org/wiki/Peja>
7. https://wonderland.cx/wp-content/uploads/2021/03/Community-Development-Heritage- - Roadmapfor-the-region-of-Peja-_FINAL-ëbsite.pdf
8. https://unhabitat-kosovo.org/ëp-content/uploads/2019/06/MDP_angl_135548.pdf
9. <http://ismailhalili.blogspot.com/2012/05/peja-dhe-historia-e-pejes.html> Peja dhe historia e Pejës
10. <https://turizmiipejes.weebly.com/historiku.html>

4.2. Historik i shkurtër i Fakultetit të Agrobiznesit

Historiku. – Peja ka qenë dhe mbetet njëra ndër qendrat më të njohura dhe më me ndikim të Regjionit të Dukagjinit dhe të Kosovës në përgjithësi. Kjo qendër dhe ky regjion njihen me lashtësinë e saj, me pozitën gjeostrategjike, e ne veçanti me demografinë, hidrografinë, klimën dhe biodiversitetin e përshtatshme. Si e tillë vetëm Peja, pa qendrat tjera regjionale, ka një sipërfaqe prej 603 km², dhe pothuajse gjysma e territorit është zonë malore - Rugova, e pasur më pyje e kullosa dhe e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë. Sektori i bujqësisë jo vetëm në Pejë por edhe në regjion dallohet edhe për karakteristikat që kanë vendbanimit, për lavërtarinë, pemëtarinë, blegtorinë, pylltarinë, etj. Pjesa tjetër qyteti më rrethin është tokë pjellore e punueshme, e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, pemëtarisë, vreshtarisë, etj. Komuna e Pejës kufizohet me: Istogun, Klinën, dhe Deçanin. Kurse me komunën e Plavës, Beranës dhe Rozhajës kufizohet me Malin e Zi. Në anën tjetër, kufizohet me Republikën e Shqipërisë. Territori i Komunës së Pejës përbehet nga dy tërësi gjeografike: njëra me klimë kontinentale të shprehur klimë mesdhetare që përfshin përafërsisht 30% të sipërfaqes së përgjithshme, dhe vargmalet e Alpeve shqiptare në veriperëndim, me një rrjet hidrografik të zhvilluar që ndikon si modifikim i klimës në këtë pjesë. Historikisht bujqësia në Kosovë, në veçanti në Regjionin e Dukagjinit, ka qenë sektor i rëndësishëm për ekonominë familjare. Ky regjion dallohet për një rrjet të përshtatshëm rrugorë dhe transport publik. Qyteti i Pejës dhe regjioni i Dukagjinit që pas Luftës së Dytë Botërore kanë qenë të njohura me kapacitete të fuqishme industriale në fushën e bujqësisë. Në Pejë ka funksionuar Kombinati Bujqësor – Industrial, një numër i madh i Kooperativave Bujqësore nëpër zona rurale,

në Gjakovë Kombinati Industrial - Bujqësor “Ereniku”, “Virgjinia”, Kooperativa Bujqësore e Becit, në Klinë Kombinati Malushgani, etj. Tani një pjesë e madhe e këtyre kapaciteteve, pas procesit të privatizimit, janë transformuar në ndërmarrje private ose janë shuar. Megjithatë pas Luftës së fundit ekonomia dhe bujqësia ka marrë drejtimin e zhvillimit në baza krejtësisht të reja duke u modernizuar dhe duke zbatuar, gjithnjë e më shumë, teknikat, metodat dhe teknologjitë më bashkëkohore për shfrytëzimin maksimal të të gjitha kapaciteteve të mundshme. Si ndërmarrje të suksesshme të cilat në këtë fushë dallohen janë: Fabrika e Birrës Pejë, Fabrika e Bimëve Aromatike “Agroprodukt” në Istog, Fabrika e ëmbëlsirave në Klinë, Fabrika për përpunimin e farave në Klinë, Fabrika e përpunimit të grurit Sillosi në Xërxe, kapacitetet prodhuese të Kompanisë Elkos, Shoqata e njohur “Molla” e njohur për kultivimin e pemëve, etj, dhe shumë institucione të tjera që kanë një ndikim në këtë sferë siç është Instituti Bujqësor i Kosovës në Pejë, Instituti Pyjor i Kosovës në Pejë, Instituti për mbrojtjen e monumenteve, etj,.

Themelimi i Fakultetit të Agrobiznesit. - Menaxhmenti dhe personaliteti akademik i Fakultetit të Shkencave të Aplikuara të Biznesit të cilët kishin marrë barrën për inicimin dhe themelimin e universitetit në Pejë që në vitin 2009 kishin filluar parapërgatitjet për t’i identifikuar se cilat do të jenë njësitë akademike të universitetit të ardhshëm. Në këtë drejtim analizohen shumë dokumente, strategji sektoriale e ndërsektoriale të zhvillimit të bujqësisë dhe agroekonomisë jo vetëm të Pejës por edhe në Regjion të Dukagjinit dhe të vendit. Identifikohen qendrat e mesme arsimore në regjion të cilat ofronin programe të kësaj natyre. Studiohen raporte me të dhëna statistikore për numrin e popullsisë që jetonin në vise rurale, kapacitetet teknike e teknologjike, programet të cilat ofroheshin në Fakultetin e Bujqësisë të Universitetit të Prishtinës, numri i kapaciteteve biznesore private dhe publike të angazhuara në këtë sferë. Faktori më i rëndësishëm i cili sintetizonte të gjitha këto komponentë ishte Instituti Bujqësor të Kosovës më seli në Pejë si njëri ndër institucionet më të rëndësishme edhe në fushën e kërkimeve laboratorike dhe potenciali njerëzor – ekspertë me nivel të lartë shkencor. Nisur nga këto të dhëna, së bashku edhe me propozimet për njësitë të tjera të cilat do mund të themeloheshin në universitetin e ardhshëm theksohet edhe fakulteti i agrobiznesit. Themelimi i kësaj njësie u bazua në karakteristikat që i posedonin qytetet e Regjionit të Dukagjinit Peja, Istogu, Deçani, Juniku, Klina dhe Gjakova duke i identifikuar nevojat e tyre të cilat do të kombinoheshin me komponentë të biznesit duke vlerësuar se këto profile i duheshin ekonomisë e cila pas luftës së fundit po mëkëmbej në vend. Mbi këto ide e vlerësime Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në fundin e vitit 2009 e angazhon Këshillin Britanik që t’i analizojë këto propozime e të dhëna dhe të del më një raport konkret. Në fillim të vitit 2010 Profesor Stiv Bristow i Këshillit Britanik ia dorëzon MASHT – it, raportin e fisibilitetit duke i dhënë orientimet për fushat dhe drejtimet të cilat do të mund të ishin të qëndrueshme dhe të dobishme për themelimin e njërive të caktuara në Universitetin i cili po përgatitej të themelohej. Në këtë dokument eksperti gjegjësisht profesori Bristow i rekomandon MASHT – it, themelimin e universitetit në Pejë. Gjatë periudhës nga marrja e raportit deri të marrja e vendimit për themelimin (mars – nëntor) Menaxhmenti dhe personaliteti akademik i FSHAB –it kontaktojnë dy ekspertë të bujqësisë me titull doktorë në punë në Institutin e Bujqësor të Kosovës në Pejë dhe nga ata kërkohet që t’i bashkëngjiten ekipit për themelimin e universitetit në Pejë dhe përgatitjen e programeve të cilat duheshin të zbatoheshin në të ardhmen pasi që ato të akreditoheshin. Puna rreth themelimit dinamizohet edhe më tutje tani drejt përgatitjes së programeve mësimore. Në këtë fazë analizohet edhe më thellë kombinimi i komponentëve të agros me biznesin. Qëllimi ishte që në universitetin e ardhshëm afirmimi i një qaje të integruar të programeve, nëpër të gjitha njësitë akademike, pavarësisht nga natyra që kishin, të ndërlihdeshin në mes vete me komponentin e biznesit duke qenë të bindur se kjo këtë universitet do bënte me vlerë dhe të veçantë në vend dhe më gjerë. Me 14.11.2011, Ministri i MASHT- it nxjerrë vendimin për themelimin e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë. Ndërkaq, mbi bazën e raportit të fisibilitetit, të dhënave të mbledhura për

qëndrueshmërinë dhe aqyeshmerinë e themelimit të kësaj njësie akademike dhe ekzistencës të burimeve njerëzore me kualifikime shkencore adekuate. Ministri i MASHT –it, me datën 06.01.2012, nxjerrë dhe nënshkruan Statutin e Përkohshëm të Universitetit “Haxhi Zeka” ku në neni 26 të tij themelohet Fakulteti i Agrobiznesit si fakultet në kuadër të këtij institucioni. Pas këtij vendimi grupi punues në fjalë, tani nën drejtimin e dy ekspertëve të Institutit Bujqësor të Kosovës, përkatësin programet të cilat duheshin të kalonin procesin e vlerësimit – akreditimit. Në Qershor të vitit 2012 Agjencisë Kosovare të Akreditimit i dorëzohet dokumentacioni për fakultetin dhe për vlerësimin e dy programeve: Teknologji e prodhimit bimor dhe Agromjedis dhe Agroekologji. Pas kësaj faze Agjencia Kosovare e Akreditimit i akrediton programet në fjalë me çfarë hapet rruga e hapjes së konkursit për pranimin e personalit të rregullt akademik dhe të angazhuar dhe po ashtu hapet e konkursit për pranimin e studentëve të rinj në vitin akademik 2012/13. Me datën 01. Tetor 2012 Fakulteti i Agrobiznesit e fillon punën. Programet e studimit të ofruara janë programe të studimit të organizuara sipas sistemit të Bolonjës, tri vjeçare me 180 ECTS, përkatësisht 4 vjeçare me 240 ECTS në nivelin Bachelor ndërsa dy vjeçare me 120 ECTS, përkatësisht 1 vjeçare me 60 ECTS. Njësi akademike e Universitetit "Haxhi Zeka" që nga viti 2012 është edhe Fakulteti i Agrobiznesit (FAB), i cili aktualisht është i organizuar në tri departamente dhe ofron programe të studimeve në nivelin bachelor dhe master. Programet e studimit të ofruara nga FAB janë programe të studimit të organizuara sipas sistemit të Bolonjës, tri vjeçare me 180 ECTS, Msc. 2 vite 120 ECTS. Përndryshe, këto programe të studimit ofrohen sipas metodave bashkëkohore të mësimdhënies siç janë: studentin në qendër; organizimi i studentëve në grupe më të vogla, aplikimi i metodave interaktive të ligjëruarit, përfshirja e studentëve në procesin mësimor përmes vlerësimeve të ndryshme, aplikimi i metodave transparente të vlerësimit etj. FAB aktualisht organizon dhe zhvillon studime universitare themelore të rregullta në katër programe:

- Teknologji e Prodhimit Bimor (BSc, 180 ECTS);
- Agromjedis dhe Agroekologji (BSc, 180 ECTS);
- Teknologji Ushqimore (BSc, 180 ECTS).
- Sistemet e qëndrueshme të prodhimit ushqimore (Msc. 120 ECTS).
- Menaxhim Mjedis (MSc. 120 ECTS)

Struktura organizative e FAB dhe fushëveprimi i tij është i rregulluar me shumë dokumente ligjore, ndërsa dokumentet bazë të cilat e përcaktojnë organizimin dhe funksionimin e tij janë: Ligji për Arsimin e Lartë (aneksi 1), i miratuar në vitin 2015, Statuti i UHZ-së i vitit 2013 (aneksi 4), Rregullorja për Organizimin e Brendshëm të UHZ-së (aneksi 6).

Programet në nivelin Bachelor janë hartuar konform Ligjit të Arsimit të Lartë 04/L-037 (aneksi 1), Udhëzimit Administrative nr.15/18 (aneksi 2) për akreditimin e institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovë, Manualit të AKA për akreditim (aneksi 3), sipas deklaratës së Bolonjës, Statutit të Universitetit “Haxhi Zeka” (aneksi 4) dhe Planit Strategjik të Universitetit Publik “Haxhi Zeka”. Programet janë përpiluar me një qasje bashkëkohore që e bën të krahasueshëm me kurrikulat e universiteteve të njohura ndërkombëtare. Në secilin hap të hartimit të këtij programi, vëmendje e veçantë i është kushtuar ndërlidhjes me nevojat e tregut të punës që të diplomuarit nga ky program të ofrojnë vlerë për institucionet kërkimore/shkencore dhe ekonominë e vendit në përgjithësi. Gjithashtu, programi ka marrë parasysh hulumtimet e tregut të realizuara nga organizata të ndryshme që dëshmojnë se aftësitë menaxhuese dhe janë mjaft të kërkuara në tregun e punës. Plan-programet e Fakultetit të Agrobiznesit janë të hartuara sipas modelit evropian të transferimit të kredive ECTS ndërsa raporti në mes punës teorike dhe asaj praktike është 60% me 40%.

Udhëheqja institucionale, strukturat e menaxhimit dhe marrëveshjet e administratës dhe personelit

Kjo njësi akademike e Universitetit udhëhiqet nga Dekani dhe dy Pro-dekanë (prodekani për çështje mësimore dhe prodekani për çështje financiare). Dekani dhe dy prodekanët zgjedhën nga Këshilli i Fakultetit i cili përbëhet nga profesorë, asistentë, anëtarë nga personalia jo akademik dhe nga radhët e studentëve. Dekani dhe dy prodekanët janë gjithashtu anëtarë të Këshillit të Fakultetit.

Menaxhimi i punëve dhe detyrave administrative të përditshme përkrahet nga koordinatori për cilësi dhe zhvillim akademik, zyrtarët ligjorë dhe administrativë si dhe nga asistentët administrativë.

Aktualisht, personeli akademik i përhershëm përbëhet nga, 2 Profesorë të rregullt, 6 Profesorë të Asocuar, 8 Profesorë asistentë, dhe 2 asistentë. Përveç personelit të rregullt akademik, Fakulteti i Agrobiznesit angazhon edhe personel akademik në cilësi të bashkëpunëtorëve (ligjërues dhe asistentë).

Studentët, prejardhja e tyre socio-ekonomike

Sipas Statutit, Universiteti është i detyruar të krijojë mundësi të barabarta për të gjithë pa asnjë diskriminim të bazuar në gjini, racë, orientim seksual, status martesor, gjuhë, fe, besim politik, kombësi, përkatësi etnike ose shoqërore, etj., ose përkatësia në një komunitet kombëtar, pronë, statusi i lindjes ose ndonjë status tjetër. Studentët që studiojnë në tre programet e përmendura të studimit kryesisht janë nga Regjioni i Dukagjinit që përfshinë komunat: Pejë, Deçan, Klinë, Istog, Gjakovë, Junik, Rahovec, Malishevë, Prizren. Përveç studentëve nga Regjioni i Dukagjinit, në FAB ndjekin studimet edhe studentë nga viset dhe regjionet e tjera të Kosovës, si dhe nga shtetet e tjera si nga Shqipëria dhe Mali i Zi (4 boshnjak, 12 komuniteti RAE dhe 1 malazez). Studentët që studiojnë në këtë fakultet ju përkasin të gjitha shtresave socio-ekonomike të shoqërisë kosovare. Në përputhje me statutin e UHZ-së, studentët e FAB janë të organizuar në Këshillin e studentëve në njësinë akademike, ndërsa janë të përfaqësuar në Parlamentin e Studentëve në nivel të universitetit dhe me anëtarë me të drejtë vote edhe në Këshillin e FAG.

Më 13 maj 2013, Parlamenti i Republikës së Kosovës miratoi Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë me ç'rast pushojnë së funksionuari të gjitha dispozitat e Statutit të Përkohshëm.

(<https://drive.google.com/file/d/0B1c9UkiZAV3ZT0JaTkRjLTVFMFk/view?resourcekey=0-6jSqaBc-q4aRëK-zi1eKGA>)

4.3. Aktet juridike të FAG –së

Më 30 maj 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 65(1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 17 paragrafi 1 i Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-037, e miratoi Statutin e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë.

Meqë zakonisht hasen vështirësi në aplikimin e dispozitave ligjore gjatë punës së përditshme menaxheriale dhe administrative dhe nisur nga fakti se palët (personat juridikë dhe fizikë), kanë kërkesa të vazhdueshme për një të drejtë ose detyrim, lind nevoja e dhënies përgjigje këtyre kërkesave dhe nevoja për hartimin e një numri të konsiderueshëm të akteve administrative.

Universiteti "Haxhi Zeka" si universitet publik punën dhe shërbimet e veta i ka të fokusuar drejt parimeve, siç janë:

- ✚ Parimi i ligjshmërisë;
- ✚ Parimi i proporcionalitetit;
- ✚ Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit;
- ✚ Parimi i objektivitetit dhe paanësisë;
- ✚ Parimi i administratës së hapur;
- ✚ Parimi i joformalitetit dhe efikasitetit të procedurës administrative;
- ✚ Parimi i informimit dhe ndihmës aktive;

✚ Parimi i të drejtës në mjete juridike etj.

Që nga themelimi UHZ-ja, duke u bazuar në këto parime në vazhdimësi ka hartuar dhe ka nxjerë akte nënligjore, rregullore, strategji, udhëzues për stabilizim dhe siguri ligjore brenda universitetit.

UHZ ka të hartuara: 42 rregullore, 2 kode të etikës, 4 strategji, 9 udhëzues, 2 broshura dhe 2 dokumente të tjera.

Në tabelën e më poshtëm është paraqitur numri i akteve të nxjerra nga organet përkatëse ndër vite:

Këshilli Drejtues		Rektori		Senati	
Rregullore		Rregullore		Rregullore	
2013	1	2013	/	2013	/
2014	/	2014	/	2014	/
2015	2	2015	/	2015	/
2016	/	2016	/	2016	1
2017	4	2017	/	2017	1
2018	5	2018	/	2018	2
2019	2	2019	/	2019	2
2020	4	2020	1	2020	3
2021	/	2021	/	2021	1
2022	4	2022	/	2022	9
Total	22	Total	1	Total	19
Gjithsej 42					

Tabela nr. 10. Numri i akteve të brendshme të nxjerra ndër vite.

4.4. Struktura organizative e FAG – it

Fakulteti pranë Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë është institucion publik i themeluar mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës (shih shtojcën 1: Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës <https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2761>).

Baza ligjore e funksionimit të universiteteve publike në Kosovë, përfshirë edhe UHZ-në, është e rregulluar me ligjin themelor, atë për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe Statutin, si aktin më të lartë juridik të universitetit. Lidhur me çështjet e ndërlidhura që kanë të bëjnë me financat publike, zyrtarët e administratës, rregullimin e çështjes së punës, pushimeve, veprimet me procedurat administrative, prokurimin publik, mbrojtjen shëndetësore, pensionet etj., baza juridike zgjerohet edhe në akte të tjera ligjore parësore dhe dytësore, të cilat kanë ndikim të theksuar në hartimin e rregulloreve dhe udhëzimeve të cilat i nxjerrë UHZ-ja. Universiteti ka arritur që të ketë një gamë të mirë të akteve juridike të brendshme të cilat e garantojnë stabilitetin dhe zhvillimin institucional. Natyrisht, këto rregullore më shumë kanë të bëjnë me procedurat, të cilat në varësi të nevojave mund të plotësohen e ndryshohen.

Aspekti i udhëheqjes institucionale dhe strukturore të menaxhimit institucional bazohet në tërësi në dispozita statutare. Prandaj, në përputhje me nenin 50 të Statutit, struktura organizative e UHZ-së përbëhet prej:

- 1) Njësive akademike;
- 2) Njësive organizative.

Njësitë akademike:

Lidhur me udhëheqjen në UHZ, dispozitat e Statutit të UHZ janë të qarta. Ekziston një strukturë menaxhimi në dy nivele. Niveli i parë është i ndërlidhur me menaxhimin e universitetit dhe niveli i dytë me menaxhimin e njësive akademike – fakulteteve.

✚ Në nivelin e parë dispozitat statutare janë të qarta për rregullimin e ndarjes së kompetencave në mes të:

- 1) Këshillit Drejtues, si organ qeverisës,
- 2) Rektorit, si organ ekzekutiv – menaxherial.
- 3) Senatit, si organi më i lartë akademik; o Këshilli Drejtues i UHZ-së përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, tre (3) prej të cilëve janë të emëruar dhe të deleguar drejtpërdrejtë nga ministri i MASHTI-it, ndërsa katër (4) anëtarë janë të zgjedhur nga Senati i UHZ-së nëpërmjet procesit zgjedhor demokratik, me mandat tre (3) vjeçar. Lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e Këshillit Drejtues, shih nenet 22, 23 dhe 24 të Statutit të UHZ.

✚ Rektori është autoriteti kryesor menaxhues.

✚ Rektorin e ndihmojnë tre (3) prorektorë.

✚ Përgjegjësitë dhe detyrat e rektorit dhe prorektorëve janë të rregulluara me nenet 25- 37.

Senati i UHZ përbëhet nga 16 senatorë të zgjedhur, sipas dispozitave statutore dhe Rregullores për Zgjedhjet në UHZ, me mandat katër (4)-vjeçar. Rektori dhe tre (3) prorektorët janë “ex officio” anëtarë të senatit dhe mandati i tyre është i lidhur me mandatin e rektorit. Në rrethana normale me afat katër (4) - vjeçar.

Secila njësi akademike përfaqësohet nga një senator i zgjedhur në mënyrë demokratike nga Këshilli i njësisë akademike + dekani i njësisë akademike i cili “ex officio” është senator.

Pjesë e senatit janë edhe studentët, të cilët zgjedhen në mënyrë demokratike në Parlamentin Studentor, çdo 2 vjet. Gjithashtu, personeli i administratës, pas zgjedhjeve demokratike, përfaqësohen me një (1) senator. Detyrat, përgjegjësitë dhe autorizimet e senatit janë të rregulluara me nenet 42 – 49.

Niveli i dytë menaxherial është ai i fakulteteve.

Fakultetet janë të organizuara me këto organe:

1) Këshilli i Fakultetit, si organ vendimmarrës dhe

2) Dekani, si organ ekzekutiv.

✚ Këshilli i Fakultetit përbëhet prej 19 anëtarëve dhe ka përgjegjësi vendimmarrëse. Ai përbëhet nga dekani dhe dy (2) prodekanët të cilët “ex officio” janë anëtarë të këtij forumi, deri në pesëmbëdhjetë (15) anëtarë të zgjedhur nga radha e profesorëve të fakultetit, deri në tre (3) anëtarë të zgjedhur nga radha e asistentëve të fakultetit, një (1) anëtar nga radha e personelit joakademik, i zgjedhur nga radha e personelit joakademik dhe një (1) përfaqësues të studentëve, i zgjedhur nga Këshilli i studentëve të fakultetit. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Fakultetit është katër (4) - vjeçar, ndërkaq i anëtarit student dy (2) - vjeçar. Këshilli i fakulteteve rregullohet me nenet 73 – 77 të Statutit të UHZ.

✚ Dekani i njësisë, si organ ekzekutiv

1) Dekanin e ndihmojnë dy prodekanë

Përgjegjësitë dhe detyrat e dekanit dhe prodekanëve rregullohen me nenet 67 – 72 të Statutit të UHZ.

Fakulteti ka mundësi të organizohet në tri nivele akademike:

- 1) Departamente;
- 2) Katedra;
- 3) Institute.

Këshilli i studentëve merr pjesë në mbledhjet e Këshillit të Fakultetit me dy (2) studentë. Rregullohet me nenin 77 dhe 78 të Statutit të UHZ.

Njësitë organizative;

UHZ – ja sipas statutit ka disa njësi organizative.

Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit, në bazë të nenit 38 të Statutit të UHZ, është zyrtari më i lartë administrativ i universitetit. Pozita, përgjegjësitë dhe autorizimet e tij janë të rregulluara me nenet 39 – 41.

Në cilësi të njërive organizative në UHZ janë:

- ✚ Biblioteka Qendrore Universitare;
- ✚ Instituti për kërkime dhe arte;
- ✚ Qendre e ekselencës;
- ✚ Qendra për përkrahjen e bizneseve.

Cilësinë e njërive organizative e fitojnë edhe strukturat, Institutet dhe qendrat e tjera, të cilat themelohen me vendim të Këshillit Drejtues të UHZ.

4.5. Burimet njerëzore

Universiteti “Haxhi Zeka” punëson një numër të konsiderueshëm të personelit akademik, për zbatimin e aktiviteteve mësimore dhe kërkimore. Aktualisht, për zbatimin e planeve mësimore janë të angazhuar 84 mësimdhënës. Mësimdhënësit janë profesorë të dalluar dhe cilësorë, doktorë shkencash të fushave të ndryshme, përvoja e të cilëve në punën mësimore dhe reputacioni i tyre janë bazë për njohjen dhe reputacionin e universitetit. Struktura e stafit mësimdhënës është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

PERSONELI AKADEMIK		Deri në fund të vitit 2022			
Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune	Numri				
	Prof.dr.	2			
	Prof.asoc	6			
	Prof. asist	8			
	Asistentë	2			
	0	0			
	Gjithsejtë	18			
		<i>Fem</i>	%	<i>Mesh</i>	%
Struktura gjinore	4	22 %	14	78 %	
Struktura etnike dhe gjinore në %					
Shqiptarë	4	22 %	14	78 %	
Boshnjakë	0	0%	0	0 %	
Egjiptianë	0	0	0	0 %	

Tabela nr. 11. Përshkrimi i numrit, thirrjeve, strukturës gjinore dhe etnike

Struktura e punonjësve në këto vende pune është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

2	PERSONELI ADMINISTRATIV	<i>Deri në fund të vitit 2023</i>	
		6	
	Struktura gjinore	5 femra ose = 83 %	
		1 meshkuj ose = 17 %	
	Struktura etnike	100 shqiptarë ose = 100 %	
		0 boshnjakë ose = 0 %	

Tabele nr. 12. Struktura gjinore e personalit administrativ

Universiteti ka të punësuar numër të mjaftueshëm punëtorësh për punë administrative dhe teknike, në përputhje me Rregulloren për kushtet për themelimin dhe fillimin e punës së institucioneve të arsimit të lartë dhe procedurën për përcaktimin e plotësimit të kushteve. Rregullorja për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Universitet rregullon sistemin e vendeve të punës me përshkrimin e detyrave të kryera, kushtet e veçanta që duhet të plotësojnë punonjësit për të kryer detyrat në vendin e punës, numrin e ekzekutuesve si dhe çështje të tjera me rëndësi për punë dhe funksionim.

Numri dhe struktura e personelit joakademik, kushtet dhe mënyra e përzgjedhjes përcaktohen me aktin për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në universitet, i cili miratohet nga Këshilli Drejtues i universitetit, me propozimin e rektorit të universitetit. Rektori lidh kontratën e punës me të gjithë punonjësit e universitetit.

4.5.1. Publikimet e aktiviteteve kërkimore-shkencore

Situata dhe rezultatet aktuale të kërkimit shkencor në Fakultetin e Agrobiznesit pranë Universitetin “Haxhi Zeka” bazohen në një traditë që nga viti 2010, të cilat janë të ndërlidhura me ish-Fakultetin e Shkencave të Aplikuara të Biznesit. Agrobiyenesit se bashku me Menaxhim turizem hotileri dhe mjedis. Nga ajo kohë e deri me tani, nga njësitë akademike të UHZ –së janë botuar revista për çështje sociale dhe ekonomike, revista për kërkime shkencore, PENTZA dhe revista ndërkombëtare për studime interdisiplinare, SIPARANTUM. Gjithashtu, deri me tani, në nivel të fakulteteve dhe të universitetit janë organizuar më shumë se dhjetë konferenca ndërkombëtare dhe nacionale. Nga të gjitha këto kemi me dhjetëra punime të botuara jo vetëm nga personali akademik i FAG-it, por edhe nga autorë të njohur vendorë e ndërkombëtarë. Janë organizuar disa tryeza të rrumbullakëta: siç janë: “Menaxhimi i mbeturinave si problem urban” në shkurt të vitit 2021, “Të drejtat e grave”⁶ “Dhuna në familje dhe e ardhmja e rinisë”²³ “Pandemia COVID-19, masat e qeverisë në përgjigje të pandemisë dhe efekti i saj në ekonomi: a ishin masat të pashmangshme? Çfarë më tutje?”²⁴ etj. Në vitet e fundit, megjithatë, nuk ka pasur shumë zhvillime pozitive përsa u takon revistave. Por, me këtë strategji janë planifikuar masat dhe detyrat për ta riaktivizuar botimin e tyre. Lidhur me revistat për më shumë klikoni në këtë link: <http://www.research.unhz.eu>

4.6. Infrastruktura e FAG-it

✓ Bibliotekat

Biblioteka e Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë, është e vendosur në dy lokacione:

1. Në objektin e Fakultetit të Agrobiznesit, përveç hapësirës, ekziston edhe salla e leximit dhe një pjesë e saj mbulohet me 10 kompjuterë;
 2. Në objektin e Fakultetit Juridik, në kuadër të bibliotekës, përveç hapësirës ku janë të vendosura librat, ekziston edhe salla e leximit dhe salla e pajisur me 16 kompjuterë, që kanë qasje në internet.
- ✚ Këto pajisje kompjuterike u mundësojnë studentëve qasje në bibliotekat elektronike, qasje në sistemin elektronik për menaxhimin e studentëve (SEMS), ku gjenden të gjitha materialet e vendosura nga profesorët për lëndët e caktuara, po ashtu studentët mund t’i përdorin këto pajisje për kërkime dhe hulumtime në internet.

⁶ <https://unhz.eu/ne-uhz-u-mbajit-tryeze-e-rrumbullaket-per-te-drejtat-e-grave/>

- ✚ Në Sistemin Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS), ekziston moduli “e-library”, në të cilin janë të vendosura informatat për qasje në bazën e të dhënave dhe bibliotekat elektronike, në të cilat UHZ-ja ka siguruar abonim.
- ✚ Pajisjet kompjuterike mirëmbahen dhe përditësohen me softuer të licencuar nga stafi përgjegjës në kuadër të UHZ-së.

Në Bibliotekën e UHZ-së aktualisht janë të punësuar 3 (tre) persona, të cilët ofrojnë shërbime bibliotekare për studentët dhe stafin akademik. Biblioteka është e hapur çdo ditë punë (E hënë - E premte) nga ora 08:00-16:00 për huazimin e librave dhe leximit në salla, ndërsa çdo të shtunë dhe të diel nga ora 08:00-16:00 për lexim në sallë. Gjatë javës studentët mundën gjithashtu të qëndrojnë për lexim në sallat e leximit dhe në bibliotekë edhe përtej orës 16:00, duke iu mundësuar atyre qasje të pandërprerë sidomos gjatë periudhës së vlerësimeve dhe provimeve.

²² <https://unhz.eu/ne-uhz-u-mbajt-tryeze-e-rrumbullaket-per-te-drejtat-e-grave/>

²³ <https://unhz.eu/?s=tryeza+e+>

²⁴ <https://unhz.eu/?s=ujukan+bajra>

Librat në bibliotekën e fakultetit janë kryesisht në gjuhën shqipe, mirëpo ekzistojnë edhe libra në gjuhën angleze, gjermane, si dhe serbokroate, për studentët e komunitetit boshnjak (shih tabelën në vijim).

Nr.	Përshkrimi	Titujt	Ekzemplarët
1.	Agrobiznes	178	335
12.	Blerje nga UHZ, në vlerë 8,541 €	207	621
Gjithsej		385	956

Tabela nr. 13. Përshkrimi i titujve dhe ekzemplarëve të librave sipas gjuhës në bibliotekat e FAG

Fakulteti i Agrobiznesit në kuadër të Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë u ofron studentëve dhe stafit qasje në burimet elektronike, në gjithsej 14 platforma, bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit që ky institucion ka me Bibliotekën Kombëtare të Kosovës, “Pjetër Bogdani”, Projektin “ResearchCult” dhe me Asociacionin e Bibliotekave Elektronike të Kosovës. (Shih tabelën në vijim).

Nr.	BIBLIOTEKAT ELEKTRONIKE (ONLINE)
1.	EBSCO https://www.ebsco.com/ (Abonim nga UHZ, në kuadër të projektit ResearchCult)
2.	plagiarismcheck.org https://plagiarismcheck.org/ (Abonim nga UHZ, në kuadër të projektit ResearchCult)
3.	ASTM compass- ASTM https://www.eifl.net/e-resources/astm-compass (Abonim me pagesë nga UHZ)
4.	Edëard Elgar Publishing Journals https://wwwwww.eifl.net/e-resources/edward-elgar-publishingjournals (Abonim me pagesë nga UHZ)

5.	e-Duke Journals Scholarly Collection https://www.eifl.net/e-resources/e-duke-journals-scholarlycollection (Abonim me pagesë nga UHZ)
6.	Cambridge Journals Online https://www.eifl.net/e-resources/cambridge-journals-online (Abonim me pagesë nga UHZ)
7.	EUROPEAN RESPIRATORY JOURNAL https://www.eifl.net/e-resources/european-respiratoryjournal (Abonim me pagesë nga UHZ)
8.	EDËARD ELGAR PUBLISHING DEVELOPMENT STUDIES & ENVIRONMENT E-BOOKS https://www.eifl.net/e-resources/edward-elgar-publishing-development-studies-environment-e-books (Abonim me pagesë nga UHZ)
9.	IOPSCIENCE https://www.eifl.net/e-resources/iopscience (Abonim me pagesë nga UHZ)
10.	IËA PUBLISHING JOURNALS https://www.eifl.net/e-resources/iwa-publishing-journals (Abonim me pagesë nga UHZ)
11.	MATHEMATICAL SCIENCES PUBLISHERS JOURNALS https://www.eifl.net/e-resources/mathematical-sciences-publishers-journals (Abonim me pagesë nga UHZ)
12.	OPENEDITION JOURNALS https://www.eifl.net/e-resources/openedition-journals (Abonim me pagesë nga UHZ)
13.	THE COMPANY OF BIOLOGISTS' JOURNALS https://www.eifl.net/e-resources/company-biologists-journals https://www.eifl.net/eresources/company-biologists-journals (Abonim me pagesë nga UHZ)
14.	JSTOR https://www.jstor.org/ (Abonim në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me universitetin "Aleksandër Moisiu" - Durrës)

Tabela nr. 14. Përshkrimi i lidhjeve me biblioteka elektronike.

4.7. Objektet

Fakulteti i Agrobiznesit ofron burime të mjaftueshme infrastrukurore (salla mësimi, laboratorë dhe pajisje, bibliotekë, kompjuterë, hapësira mësimore individuale dhe grupore etj.) për të gjithë personelin dhe studentët e regjistruar, në mënyrë që të sigurojë përmirësimin e mjedisit dhe të mbështesë përdorimin efikas të tyre. Përshtatshmëria e burimeve për realizimin e programeve të studimit, funksionaliteti, mosha dhe sigurimi i qasjes në to vlerësohen vazhdimisht nga vlerësimet e brendshme. Universiteti ka objekte me sipërfaqe prej rreth 5734.3 m², në të cilat kryhen veprimtari mësimore dhe kërkimore, si dhe aktivitete të tjera. Universiteti ka bibliotekë dhe objekte të tjera mbështetëse në dispozicion të studentëve - dhoma interneti, dhoma rekreacioni, fusha sportive, klub studentor etj. Plani është që në të ardhmen të vazhdojhet investimi në ndërtesa, klasa dhe pajisje, të cilat do ta rrisin nivelin e punës mësimore dhe kërkimore.

UHZ e zhvillon aktivitetin e vet në disa objekte të ndryshme me gjithsej 5734 m² sipërfaqe të shfrytëzueshme. Për njesitë akademike. Përveç objekteve, në kuadër të hapësirave universitare të UHZ-së, ka edhe hapësirë të gjelbëruar dhe ambiente të jashtme (pa përfshirë hapësirën që zënë objektet), me një total prej rreth 6 hektarësh.

Hapësirat	shërbime studentore	klasa mësimi	kabinete	Biblioteka	informatikë	Zyre për organizatat e studentëve	Byfe	Administrata	Të tjera	TOTAL (m2)
Objektet	Gjendja (m2)	Gjendja (m2)	Gjendja (m2)	Gjendja (m2)	Gjendja (m2)	Gjendja (m2)	Gjendja	Gjendja	Gjendja	Gjendja
Qendër										
"D"- Dekanati	62.5							150.5	76	289
"A"	15	512.5	136.5			65.5		128	244.5	1102
"B"		200	23.5	118	44.5	21			72	479
"C"	64	221							89	374
"E"	9.5	142				9.5		79.5	119.5	360
Gjithësejtë (Qendër)	151	1075.5	160	118	44.5	96	0	358	601	2604
Kampus										
Arte-Jur	89.7	888.7	96	228				298.5	440.4	2041.3
Rektorati							12	261.7	135.3	409
Gjithësejtë (Kampus)	89.7	888.7	96	228			12	560.2	575.7	2450.3
Obj.FSK										
Agrobisnesi	7.1	181	103.7					69.3	318.9	680
Gjithësejtë (FSK)	7.1	181	103.7					69.3	318.9	680
GJITHËSEJTË										
	247.8	2145.2	359.7	346	44.5	96	12	987.5	1495.6	5734.3

Tabela nr. 15. Numri dhe m² i të gjitha objekteve në FAG

Në kuadër të këtyre hapësirave përfshihen:

Përshkrimi	nr	Përshkrimi	nr
Amfiteatër	1	Zyrë administrative	3
Salla mësimi	2	Zyrë e studentëve	1
Kabinete	3	Shërbim i i studentëve	2
Kabinete IT	1	Depo	1
Laboratorë	5	Mirëmbajtje	1
Bibliotekë	2	Ngrohje	1

Tabela nr. 16 Përshkrimi i sallave dhe zyrave

Në mënyrë që t'u përgjigjet nevojave të stafit dhe studentëve për hapësira të mjaftueshme dhe të përshtatshme për aktivitetet e tyre, është e nevojshme që FAG të shtojë hapësirat e veta të të gjitha llojeve e destinacioneve.

4.8. Pajisjet

Fakulteti krahas Universitet ka siguruar pajisje kompjuterike adekuate për studentët dhe personelin akademik dhe administrativ. Të gjitha sallat e mësimi, zyrat punuese, kabinete, laboratorët, bibliotekat dhe ambientet janë të pajisura me teknologji informative (kompjuter, internet, projektor etj).

Aktualisht, në nivel fakulteti ka këto pajisje kompjuterike:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1	Kompjuter për personel	20
2	Kompjuter për shërbim të studenteve, kabinete, laboratore, salla të leximit dhe salla të mësimin	48
3	Projektor	7
4	Printer	9
5	Printer multifunksional	2
6	Fotokopje	10

Tabela nr. 18. Përshkrimi i pajisjeve aktuale

Gjatë tre vjetëve të fundit, UHZ ka investuar në digjitalizimin e sistemit informativ, furnizim me pajisje të IT-së, të cilat shërbejnë për përmirësimin e shërbimeve që ofrohen për studentë dhe stafin e vet. Njëkohësisht, ato ndikojnë në rritjen e sigurimit në shërbime të internetit, sigurimin e cilësisë, informacionit dhe sigurimin fizik. Universiteti ka të mbuluar me ĒIFI (falas) të gjitha hapësirat e kampusit universitar për studentët dhe personelin.

4.9. SEMS-i

Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve (SEMS), po ashtu ofron qasje për shfrytëzimin e materialeve të ndryshme si: ligjëratat, materialet e përgatitura nga profesorët. Sistemi Elektronik për Menaxhimin e Studentëve përditësohet në kohë të vazhdueshme Çdo ndryshim paraprihet me shpërndahjen e materialeve dhe videove manuale për përdorim.

Në Wfaqen zyrtare të fakultetit në internet, për secilin program janë të publikuara të gjitha programet e lëndëve (syllabusët). Këto programe aktualizohen vazhdimisht, sipas ndryshimeve nga profesorët.

4.10. Studentët, numri aktual dhe pritshmeritë

Për të siguruar cilësi të studimeve, fakulteti përmes një konkursi, sipas kriterëve të paracaktuara dhe të shpallura publikisht, përzgjedh nxënësit e regjistruar të shkollave të mesme. Konkursi siguron regjistrimin e kandidatëve të cilët fitojnë sasi të mjaftueshme të njohurive nëpërmjet suksesit të tyre në shkollën e mesme dhe numrin e pikëve që kanë marrë në provimin pranues për përfshirje të suksesshme në procesin mësimor të programeve të studimit të fakultetit.

Fakulteti siguron barazinë e studentëve në qasje në programet e studimit. Me propozimin e njesisë akademike Senati i Universitetit merr vendim për shpalljen e konkursit për regjistrim në studime, i cili ndër të tjera përmban kushtet për regjistrim, kriteret për përcaktimin e renditjes së kandidatëve, procedurën e zhvillimit të konkursit, mënyrën dhe afatet për paraqitjen e ankesave. Numri i studentëve për regjistrim përcaktohet nga Senati në bazë të propozimeve të njësive organizative. Konkursi për pranim në programet e studimit shpallet publikisht.

Ēshtë parashikuar që radha e kandidatëve për regjistrim në vitin e parë të studimeve të përcaktohet në bazë të suksesit të arritur në arsimin e mesëm dhe rezultatin e arritur në provimin pranues.

Numri i studentëve të cilët studiojnë në UHZ është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Fakulteti	Niveli	Total studentë	Femra	Në %	Meshkuj	Në %
Fakulteti i Agrobiznesit	Bachelor	413	217	52,54%	196	47,46%
	Master	73	41	82,00%	9	18,00%
Gjithsej	Bachelor	413	1411	47,54%	1557	52,46%
	Master	839	470	56,02%	369	43,98%
Gjithsej studentë (bachelor & master)		3807	1881	49,41%	1926	50,59%

Tabela nr. 19. Numri i studentëve në të gjitha fakultete e UHZ-së në nivelin e studimeve tghemelore dhe në master


Numri i studentëve: Aktualisht, numri i përgjithshëm i studentëve në UHZ është 3.807. Nga ta, 1.881 ose 49.41% janë femra, ndërkaj 1.926 ose 50.59% meshkuj.

Fakulteti i Agrobiznesit ka gjithsej 492 studentë. Në bachelor 217 ose 52.54% janë femra dhe 196 ose 47.46% meshkuj. Në master janë 50 studentë, nga të cilët 41 ose 82% janë femra dhe 9 ose 18% meshkuj.

Këto të dhëna janë paraqitur edhe në mënyrë grafike si më poshtë.


Studentët e regjistruar nga vitin akademik 2020-2021 deri 2023-2024 duke hequr studentët e diplomuar dhe cregjistruar

Fakulteti	Niveli	Total studentë	Femra	Në %	Meshkuj	Në %
Fakulteti i Biznesit	Bachelor	758	365	48,15 %	393	51,85%
	Master	619	344	55,57 %	275	44,43%
Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, Hoteleri dhe Mjedis (MTHM)	Bachelor	305	130	42,62 %	175	57,38%
	Master	43	25	58,14 %	18	41,86%
Fakulteti Juridik	Bachelor	437	232	53,09 %	205	46,91%
	Master	130	73	56,15 %	57	43,85%
Fakulteti i Agrobiznesit	Bachelor	378	224	59,26 %	154	40,74%
	Master	70	53	75,71 %	17	24,29%
Fakulteti i Arteve	Bachelor	91	43	47,25 %	48	52,75%
	Master	26	14	53,85 %	12	46,15%
Total	Bachelor	1969	994	50,48 %	975	49,52%
	Master	888	509	57,32 %	379	42,68%
Total studentë (bachelor & master)		2857	1503	52,61 %	1354	47,39%




Përkatësia etnike

Fakulteti	Fakulteti i Biznesit		Fakulteti i Menaxhimit në Turizëm, (MTHM)		Fakulteti Juridik		Fakulteti i Agrobiznesit		Fakulteti i Arteve	
	BSC	Ma	BSC	MA	BSC	MA	BSC	MA	BSC	MA
Kosovar	709	568	283	41	429	126	368	68	88	26
Në %	93,54%	91,76%	92,79%	95,35%	98,17%	96,92%	97,35%	97,14%	96,70%	100,00%
Boshnjakë	37	45	18	1	6	2	0	0	2	0
Në %	4,88%	7,27%	5,90%	2,33%	1,37%	1,54%	0,00%	0,00%	2,20%	0,00%
Shqiptar	6	1	4	1	0	0	6	0	0	0
Në %	0,79%	0,16%	1,31%	2,33%	0,00%	0,00%	1,59%	0,00%	0,00%	0,00%
Tjere	6	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Në %	0,79%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Turk	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Në %	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
REA	0	5	0	0	2	2	4	2	1	0
Në %	0,00%	0,81%	0,00%	0,00%	0,46%	1,54%	1,06%	2,86%	1,10%	0,00%
Serb	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Në %	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%




Nacionaliteti


Fakulteti	Fakulteti i Biznesit		Fakulteti MTHM		Fakulteti Juridik		Fakulteti i Agrobiznesit		Fakulteti i Arteve	
	BSC	Ma	BSC	MA	BSC	MA	BSC	MA	BSC	MA
Shqipëria	3	1	1	1	0	0	0	0	2	0
Në %	0,40%	0,16%	0,33%	2,33%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	2,27%	0,00%
Mali i Zi	45	16	20	0	0	0	0	0	0	0
Në %	5,94%	2,58%	6,56%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Bosnja			0	0	0	0	0	0	0	0
Në %	0,00%	0,00%		0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Maqedonisë			0	0	0	0	0	0	1	0
Në%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	1,14%	0,00%
Kosovë	709	602	283	42	437	130	378	68	85	26
Në%	93,54%	97,25%	92,79%	97,67%	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	96,59%	100,00 %
Serbi	1		1	0	0	0	0	0	0	0
Në%	0,13%	0,00%	0,33%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%	0,00%
Gjithesëjt	758	619	305	43	437	130	378	68	88	26
	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %	100,00 %



Fakulteti i Agrobiznesit



Numri i studenteve i regjistruar nga viti 2020/2021 deri 2023/2024			Student Aktiv			Ne cilin vite gjinden			Student të Diplomuar		
T	F	M	T	F	M	I	II	III	T	F	M
492	301	191	273	185	88	139	66	68	14	9	5
			Student Pasiv			Ne cilin vite gjinden			Student të cregjistruar		
			T	F	M	I	II	III	T	F	M
			175	79	94	131	29	15	30	15	15







Agromjedis dhe Agroekologji

Numri i studenteve i regjistruar nga viti 2020/2021 deri 2023/2024			Student Aktiv			Ne cilin vite gjinden			Student të Diplomuar		
T	F	M	T	F	M	I	II	III	T	F	M
84	36	48	41	20	21	27	4	10	3	1	2
			Student Pasiv			Ne cilin vite gjinden			Student të cregjistruar		
			T	F	M	I	II	III	T	F	M
			33	14	17	28	2	3	7	2	5



Teknologji e Prodhimit Bimor


Numri i studenteve i regjistruar nga viti 2020/2021 deri 2023/2024			Student Aktiv			Ne cilin vite gjinden			Student të Diplomuar		
T	F	M	T	F	M	I	II	III	T	F	M
113	52	61	61	37	24	34	14	13	2	0	2
			Student Pasiv			Ne cilin vite gjinden			Student të cregjistruar		
			T	F	M	I	II	III	T	F	M
			44	13	31	38	0	6	6	1	5




Teknologji Ushqimore

Numri i studenteve i regjistruar nga viti 2020/2021 deri 2023/2024			Student Aktiv			Ne cilin vite gjinden			Student të Diplomuar		
T	F	M	T	F	M	I	II	III	T	F	M
223	158	65	121	92	29	56	20	45	8	7	1
			Student Pasiv			Ne cilin vite gjinden			Student të cregjistruar		
			T	F	M	I	II	III	T	F	M
			78	35	43	61	11	6	16	11	5

Raporti student aktiv, pasiv, diplomuar dhe cregjistruar






Raporti student aktiv, pasiv, sipas viteve



Sistemet e Qëndrueshme të Prodhimit Ushqimor

Numri i studenteve i regjistruar nga viti 2020/2021 deri 2023/2024			Student Aktiv			Ne cilin vite gjinden			Student të Diplomuar		
T	F	M	T	F	M	I	II	III	T	F	M
72	55	17	50	36	14	22	28		1	1	0
			Student Pasiv			Ne cilin vite gjinden			Student të cregjistruar		
			T	F	M	I	II	III	T	F	M
			20	17	3	4	16		1	1	0






Fakulteti	Fakulteti i Agrobiznesit	
	BSC	MA
Niveli		
Shqiptarë	404	48
Në %	97,82%	96,00%
Boshnjakë	5	2
Në %	0,73%	0,00%
REA	0	0
Në %	0,00%	0,00%
Egjiptian	4	2
Në %	1,45%	4,00%
Turk	0	0
Në %	0,00%	0,00%
Tjerë	0	0
Në %	0,00%	0,00%
Gjithsejtë	413	50
	100,00%	100,00%

Tabela nr. 20. Studentët sipas përkatësisë nacionale


Studentët sipas përkatësisë nacionale: Nga të dhënat statistikore rezulton se në UHZ përveç studentëve shqiptarë nga Kosova, të cilët përbëjnë numrin me të madh me 97.91%, ka edhe studentë shqiptarë nga

Shqipëria: 0.51%, Mali i Zi me 1.53%, dhe nga Maqedonia e Veriut me 0.06%. Më poshtë të dhënat janë pasqyruar në grafikun.



Grafikoni nr. 4

Studentët sipas qyteteve prej nga vijnë: Bazuar në të dhënat e përpunuara statistikore lidhur me qytetet e Kosovës nga të cilat vijnë studentët tanë, rezulton se 54.42% e tyre janë nga Peja, 7,56% nga Gjakova, 7.39% nga Deçani, 6.88% nga Istogu, 3.10% nga Klina, 3.08% nga Prishtina, 2.17% nga Skenderaj, 1.25% nga Mitrovica, 1.69% Prizreni, ndërsa pjesa tjetër nga qytetet tjera të Kosovës ose jashtë saj. Kjo nënkupton që rreth 43.58% të studentëve janë jashtë qytetit të Pejës. Të dhënat janë paraqitur edhe në mënyrë grafike si më poshtë.



Grafikoni nr. 5

Nr	Sipas gjuhës	Bsc.	Msc.	Gjithsejt
1	Shqipe	2767	770	3537
2	Boshnjake	201	69	270
3	Gjithsej	2968	839	3807

Vërejtje:

Të dhënat e paraqitura më poshtë janë përpunuara vetëm për katër (4) vjet, ngase në Planin Strategjik 2020 – 2023 janë përpunuar të dhënat e mëparshme. Si rregull, përpunimi dhe analizimi i të dhënave të mëposhtme ka qenë dashur të bëhej për tri (3) vjet, 2020-2023, por ka qenë e pamundur që të merren të dhënat për vitin 2019, ngase, në atë vit akademik UHZ-ja kishte dështuar të akreditohej në nivel institucional. Duke e pasur parasysh këtë rrethanë, del se dhe të dhënat e paraqitura, posaçërisht ato të diplomimit në raport me numrin e studentëve të regjistruar, nga një herë duken dhe dalin si të çrregullta. Kjo për faktin se në vitin akademik 2019/2020 në UHZ nuk është pranuar asnjë student e në anën tjetër ka pasur numër të caktuar diplomimesh.

Viti akademik	Numri i studentëve të regjistruar		Numri i studentëve të diplomuar		Përqindja e të diplomuarve në raport me studentët e regjistruar	
	Bch.	Msc.	Bch.	Msc.	Bch.	Msc.
2018/2019	1033	259	533	244	52%	94%
2019/2020			406	203		
2020/2021	793	247	313	204	39%	83%
2021/2022	535	369	268	123	50%	33%

Tabela nr. 23. Numri i studentëve të regjistruar në raport me studentët e diplomuar në kuadër të UHZ-së Në nivel të UHZ-së, nga të dhënat e siguruar dhe të paraqitura në tabelën e mësipërme, për vitet 2018/2019, 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, rezulton se në studime të nivelit themelor, raporti ndërmjet studentëve të pranuar dhe atyre të diplomuar është; në vitin 2018 / 2019 me 52%, 2020/2021 me 39% dhe 2021/2022 me 50%. Në nivelin e studimeve master ky raport është me sa vijon: në vitin akademik 2018/2019 me 94%, 2020/2021 me 83% dhe 2021 – 2022 me 30%. Të dhënat e paraqitura më sipër janë paraqitur më poshtë edhe në grafikon.

5. Analiza SWOT – Fakulteti i Agrobiznesit

Komisioni për hartimin e Planit Strategjik, pas analizës së gjerë të mjedisit të jashtëm dhe të brendshëm në të cilin operon FAG-it, analizoi pikat e forta, të dobëta, mundësitë dhe kërcënimet ndaj fakultetit (SWOT analizë). Megjithatë lista nuk është shteruese, ajo ofron një kontekst të dobishëm për zhvillimin e kornizës së Planit Strategjik. Çështjet kryesore në SWOT janë identifikuar si më poshtë:

PËRPARËSITË (Faktorët e brendshëm)	DOBËSITË (Faktorët e brendshëm)
► Traditë mbi 60-vjeçare pranë UHZ-së;	► Shkalla e mundshme e mospërputhjes ndërmjet nevojave të tregut të punës dhe kualifikimeve të ofruara;

<ul style="list-style-type: none"> ▶ Vendndodhja - I përket zonës arsimore në rrafshin e Dukagjinit me potencial të jashtëzakonshëm shoqëror-ekonomik; ▶ Fakultet i akredituar dhe me reputacion; ▶ Autonomia e fakultetit; ▶ Financimi 100 % nga buxheti i shtetit i studentëve në programe të studimit; ▶ Programe studimi atraktive dhe cilësore; ▶ Programe profesionale; ▶ Programe unike dhe me intensitet te ulet konkurrence; ▶ Kornizë kurrikulare fleksibile dhe moderne; ▶ Misioni i të nxëniet dhe mësimdhënies me studentin në qendër; ▶ Personel mësimdhënës kompetent; ▶ Hapësirë të përshtatshme dhe të mjaftueshme, me komoditet infrastrukturor për mësim. Një pjesë e ndërtesave të fakultetit janë ndërtuar dhe pajisur në vitin 2023 sipas të gjitha standardeve të arsimit të lartë; ▶ Organizimi i ngjarjeve shkencore dhe akademike ndërkombëtare (universiteti veror, konferenca shkencore, simpoziume... FAG); ▶ Partneritet i qëndrueshëm me industrinë, punëdhënësit dhe shoqërinë civile; ▶ Financim stabil; ▶ Besimi në orientim të fuqishëm ndërkombëtar; ▶ Digjitalizimi, aplikimi i biznesit elektronik dhe arsimor modern i teknologjive të informacionit dhe komunikimit; ▶ Bashkëpunimi me subjektet kryesore të biznesit (vizita në kompani, ligjërata etj.); ▶ Marrëdhëniet të afërta të studentëve me personelin mësimdhënës (këshillimi për karrierë); ▶ Bibliotekë cilësore - hapësirë fizike dhe koleksion librash; ▶ Përfshirja e studentëve në trupa dhe procese vendimmarrëse; ▶ Qendra për përkrahje të biznesit; ▶ Qendra e Ekselencës; ▶ Instituti për shkencë dhe arte; 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Personel i pamjaftueshëm për menaxhim të Zyrës së Karrierës ne kuader te Universitetit; ▶ Shumica e mësimdhënësve (veçanërisht të rinjtë) janë të mbingarkuar me detyrime mësimore dhe profesionale; ▶ Konvikti; ▶ Numri i pamjaftueshëm i trajnimeve specifike; ▶ Mungesa e një brendi të institucionit dhe mungesë e strategjisë së marketingut dhe komunikimit; ▶ Numri i caktuar i mësimdhënësve me deficite në kompetencë në relacion me programet e studimit; ▶ Mungesë e infrastrukturës për rekreacion për studentët; ▶ Aktivizëm i dobët i studentëve dhe organizatave studentore.
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Avokati i studentëve (Ombudperson). 	

Mundësitë (Faktorët e jashtëm)	RREZIQET (Faktorët e jashtëm)
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Pjesëmarrje në thirrje për projekte të ndërlidhura ▶ me edukimin, kërkimin dhe inovacionet; ▶ Mësimi në distancë; ▶ Kurse biznesi në IT dhe gjuhë angleze për të gjithë te interesuarit; ▶ Programe të reja studimi të bazuara 100% në nevojat e tregut; ▶ Organizimi i studimeve doktorale; ▶ Zgjerimi i rrjetëzimit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar; ▶ Vetëdijesimi për zhvillimin e qëndrueshëm; ▶ Ngritja e imazhit në relacion me IAL-të e tjera; ▶ Të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe punësimi; ▶ Krijimi i një strategjie marketingu dhe komunikimi për të promovuar dhe qëndruar më afër publikut; Krijimi i kushteve për punësimin e studentëve më të mirë nëpërmjet zyrës së karrierës dhe këshillimit në karrierë; ▶ Gjurmimi i studentëve pas përfundimit të studimeve dhe ngritja e imazhit të institucionit nëpërmjet suksesit të tyre; ▶ Ligjërata nga ekspertë të njohur ndërkombëtarë nëpërmjet video-konferencave dhe prezantimi mediatic i ngjarjeve të tilla; ▶ Gjenerim i të hyrave vetanake. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Konkurrenca ndërmjet IAL-ve; ▶ Rënie e natalitetit; ▶ Tendenca e rritjes së migracionit; ▶ Largimi i trurit (brain drain); ▶ Lobimi i fortë i kolegjeve private; ▶ Fonde të kufizuara nga ana e qeverisë; ▶ Moskuptimi i arsimit si investim i pashmangshëm për të ardhmen; ▶ Hapja e pakontrolluar dhe e pabazuar e kampuseve të IAL-ve private; ▶ Shumë informacione të pasistemuara të brendshme dhe të jashtme lidhur me zhvillimet në arsimin e lartë; ▶ Proces i ngadalshëm dhe i dobët në ndërtimin dhe rindërtimin e objekteve; ▶ Procedurat e ngadalshme të prokurimit për zbatimin e projekteve infrastrukturore; ▶ Kriza ekonomike-inflacioni; ▶ Rënia e numrit të studentëve për shkak të ndryshimeve demografike dhe rritjes së konkurrencës.

5.1. Krahasimi me fakultetet e tjera

Tabela e mëposhtme tregon pikat e forta të IAL-ve publike dhe private konkurruese, si dhe pikat e forta të universitetit tonë. Gjithashtu është paraqitur një krahasim i dobësive të UHZ-së dhe të konkurrentëve të UHZ-së.

KONKURRENCA	FAKULTETI I AGROBIZNESIT
PIKAT E FORTA TË IAL-ve PUBLIKE	PIKAT E FORTA TË FAG-it
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Financim nga buxheti i shtetit; ▶ Tradita; ▶ Studime pa pagesë për studentë; ▶ Të hyra nga studentët e vetëfinancuar; ▶ Personel me reputacion akademik; ▶ Konvikte për akomodimin e studentëve; 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Tradita; ▶ Financimi stabil nga buxheti i shtetit; ▶ Studimi pa pagesë për studentë; ▶ Personal akademik i dëshmuar dhe i njohur; ▶ Hapësira e nevojshme për ndërtimin e një kampusi modern universitar;

<ul style="list-style-type: none"> ▶ Restorante që ofrojnë ushqim për studentët; ▶ Bashkëpunimi me IAL brenda dhe jashtë vendit; ▶ Kërkimi shkencor; ▶ Përkrahje nga organizatat ndërkombëtare për zhvillimin e kapaciteteve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Hapësira të mjaftueshme për mësim dhe laboratorë; ▶ Evidencë e përditësuar dhe transparente e provimeve; ▶ Infrastrukturë në qendër të qytetit; ▶ Studime në gjuhën boshnjake; ▶ Programe unike / jokonkurrenente me IAL-të; ▶ Universiteti veror;
PIKAT E FORTA TË KOLEGJEVE PRIVATE	
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Lobim i avancuar; ▶ Infrastrukturë të shkëlqyeshme; 	
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Pajisje teknologjike të avancuara mësimi; ▶ Fleksibiliteti në hartimin e programeve të reja; ▶ Hapësirë të mjaftueshme për aktivitete studentore; ▶ Disiplina në punët administrative dhe akademike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Konferenca shkencore ndërkombëtare; ▶ Qendra për Përkrahje të Biznesit; ▶ Qendra e Ekselencës; ▶ Instituti për Shkencë dhe Arte; ▶ Avokati i studentëve (Ombudpersoni).
DOBËSITË E IAL-ve PUBLIKE	DOBËSITË E FAG –it
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Kurrikula të pa përditësuara; ▶ Mungesë të hapësirave për mësim; ▶ Pajisje të pamjaftueshme ose të papërshtatshme; ▶ Jo efikasitet në shfrytëzimin e burimeve; ▶ Ndërtesa dhe pajisje mësimi të amortizuara; 	<ul style="list-style-type: none"> ▶ Programe të doktoratës; ▶ Konvikti për studentë; ▶ Lobim i pazhvilluar; ▶ Pajisje moderne dhe të gjeneratës së fundit; ▶ Strategjia e marketingut; ▶ Kampus i kompletuar me terrene sportive; ▶ Kuota të kufizuara për rekrutim të personelit akademik të nevojshëm për akreditim të programeve sipas nevojave të tregut;
DOBËSITË E KOLEGJEVE PRIVATE	
<ul style="list-style-type: none"> ▶ Tarifa të larta për studime; ▶ Titujt akademik për personelin nuk janë ekuivalente me titujt e IAL-ve publike; ▶ Konviktet; ▶ Rekrutim i shpejtë i personelit sipas nevojave të kolegjit; 	

Sinteza e rezultateve të analizës së situatës tregon se FAG ka kufizime në mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm për zhvillimin e ardhshëm. Përkundrazi, janë të shumta mundësitë dhe forcat që tregojnë se mundësitë e zhvillimit të tij janë reale.

Duke i kushtuar vëmendje dobësive dhe rreziqeve me të cilat përballet FAG, zgjidhja e disa prej këtyre mangësive mund të shprehet si në vijim:

1.Ndërtimi i një konvikti - është thelbësore të ndërtohet sa më shpejt kampusi i UHZ edhe për FAG, për të zgjidhur këtë mangësi shumë të rëndësishme. Plani i kampusit përfshin ndërtimin e një konvikti studentor, fusha të sportit dhe një sallë për aktivitete sportive, një qendër argëtimi etj. Në këtë mënyrë, studentët do të mund të kalonin kohë në kampus si pas dhe ndërmjet orëve

të mësim, dhe do të kishin një ditë më të kënaqshme, që është synimi i çdo universiteti - t'i mbajë studentët brenda ofertës së tij.

2.Sistemi lobues / promovues i pazhvilluar – duke investuar në “Shoqërinë e Miqve të FAG dhe Universitetit”, ky investim në dukje i rëndësishëm do të shpërblehej shumë shpejt, duke qenë se informacioni është faktori më i shtrenjtë në biznes sot. Për këtë arsye, është shumë e rëndësishme për ne që të kemi një Shoqëri të krijuar, e cila do të ishte “sytë dhe veshët” tanë dhe do të na mundësonte “shkrirjen” më shpejt dhe më lehtë me mjedisin në të cilin ndodhemi.

3.Hapja e pakontrolluar dhe e pabazuar e programeve – hapja e programeve të reja në FAG para së gjithash duhet të hulumtohet mirë. Pas konstatimit të nevojës për një orientim të ri, duhet të bëhet një projeksion financiar e kadrovik. Nëse përcaktohet domosdoshmëria e zgjerimit në këtë aspekt, duhet të krijohet fillimisht një burim i sigurt financimi për këtë risi.

5.2. Identifikimi i faktorëve kritikë të suksesit

Faktorët që duhen përmbushur FAG në mënyrë që të arrijë sukses janë:

Ndërtimi dhe ruajtja e marrëdhënieve cilësore me studentët ekzistues dhe potencialë;

- ▶ Personeli cilësor e me kompetencë;
- ▶ Sistem më të zhvilluar lobimi e promovimi;
- ▶ Marrëdhënie më të mira me organizatat, komunitetin lokal, shoqatat dhe organet shtetërore në vend dhe më gjerë;
- ▶ Bashkëpunim me universitetet e tjera të vendit dhe përreth;
- ▶ Intensifikim i bashkëpunimit me shkollat e mesme në vend dhe rrethinë nëpërmjet zyrës për zhvillimin e karrierës;
- ▶ Bashkëpunim me ndërmarrjet dhe institucionet me reputacion ku janë të punësuar të diplomuarit e universitetit;
- ▶ Një shërbim i zhvilluar për studentë;
- ▶ Kornizë kurrikulare të integruar dhe rritje të mobilitetit të brendshëm dhe të jashtëm;
- ▶ Qëndrueshmëri buxhetore;
- ▶ Ndërkombëtarizim.

III. Analiza e objektivave strategjike Prrshkrim i shkurtër i tetë objektivave strategjike

1. Prioritetet strategjike

Plani Strategjik 2023-2026 ka tetë prioritete strategjike, të përcaktuara për tetë fusha prioritare:

Nr.	PËRSHKRIMI I PRIORITETEVE STRATEGJIKE	
1.	Menaxhim i brendshëm	Përgjegjësi, efikasitet, qëndrueshmëri, komunikim dhe bashkëpunim
2.	Mësimdhënia dhe mësimnxënia	Përparim i mëtejme i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies
3.	Sigurimi i cilësisë	Sistemi i konsoliduar: Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë brenda universitetit
4.	Shkencë, kërkime dhe art	Rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike
5.	Ndërkombëtarizimi	Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstucional
6.	Studentët	Motivimi, kënaqshmëria dhe aktivizmi më i madh studentor
7.	Ndërmarrësia	Zhvillimi i relacionit funksional ndërmjet universitetit dhe palëve të interesit
8.	Infrastruktura	Krijimi i një kampusi modern studentor sipas standardeve bashkëkohore
<i>Tabela: Objektivat strategjike të Fakultetit të Agrobiznesit pranë Universitetit "Haxhi Zeka" 2023 – 2026</i>		

Çdonjëra nga tetë fushat prioritare të identifikuara dhe të zhvilluara në Planin Strategjik 2023-2026 adreson problemet kyce dhe veshtirësit nëpër fushat përkatëse.

Prioritetet strategjike të FAG të përcaktuara në këtë plan paraqesin fushat kryesore të zhvillimit akademik dhe organizativ, të cilat i përcaktojnë rezultatet dhe objektivat strategjike të këtij plani. Secila nga objektivat është e zërthyer në rezultatet të pritura të matshme përmes indikatorëve të rezultateve përmes aktiviteteve

të parapara në planin e veprimit. Indikatorët e rezultateve përputhen me objektiva specifike dhe paraqesin efektet e pritshme, të ndërlidhura me fushën dhe objektivën përkatëse.

1.1. PRIORITETI STRATEGJIK 1 – Menaxhimi i brendshëm

PRIORITETI STRATEGJIK 1: Përgjegjësi, efikasitet, qëndrueshmëri, komunikim dhe bashkëpunim

Reformimi i proceseve të menaxhimit të brendshëm është proces i domosdoshëm të cilit FAG-it do t'i nënshtrohet gjatë periudhës së zbatimit të këtij plani. Ky proces do të mundësojë rritjen dhe fuqizimin e përgjegjësive të të gjitha niveleve vendimmarrëse, efikasitetit në kryerje të detyrave, qëndrueshmërisë së të gjitha segmenteve institucionale, ngritjes së kulturës së komunikimit dhe të bashkëpunimit si brenda, ashtu edhe jashtë institucionit. Më tutje, ky objektivi krijon linja të qarta të raportimit e të komunikimit, krijim të matricave për identifikimin dhe planifikimin e nevojave për burime njerëzore në FAG, ndryshim dhe rishikim të bazës ligjore, zhvillim të proceseve drejt një fakulteti me komponentë të ndërmarrësisë, duke i dhënë promovimit institucional një rëndësi strategjike.

FAG-it synon që përmes reformimit të proceseve të brendshme të menaxhimit:

- ▶ Të sigurohet fleksibilitet dhe efikasitet në kryerjen e procedurave të qeverisjes në fakultet;
- ▶ Të ketë ndarje të qarta të funksioneve në mes të personelit të angazhuar në nivele të ndryshme të menaxhimit, duke avancuar më tej autonominë akademike dhe përcaktimin për decentralizim;
- ▶ Rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në qeverisje të brendshme të fakultetit duke rishikuar, përmirësuar dhe zhvilluar më tej procedurat menaxheriale, të monitorimit, të raportimit, planifikimit të burimeve njerëzore;
- ▶ Të fuqizohen kanalet e komunikimit dhe krijimi i grupeve të lobimit e avokimit me subjekte nga biznesi, OJQ-të, të diplomuarit tanë, institucionet shtetërore, individët etj.

Arritja e kësaj objektivë do të mbështetet nga rezultatet e mëposhtme.

REZULTATI 1.1:	Fuqizimi i vendimmarrjes institucionale dhe ngritja e përgjegjësive
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përmirësimi i sistemit të vendimmarrjes dhe akteve të brendshme, me qëllim forcimin e funksioneve drejtuese, duke ruajtur funksionalitetin e integruar të fakultetit dhe duke reduktuar vendimmarrjen e centralizuar; 2. Racionalizimi dhe ristrukturimi i burimeve; 3. Numri i proceseve administrative dhe operacionale të ristrukturuar për efikasitet dhe efektivitet; 4. Avancimi i proceseve për menaxhim dhe monitorim të integruar financiar; 5. Strategjia e krijimit të kornizës kurrikulare në FAG; 6. Rregulloret për zbatimin e kornizës kurrikulare; 7. Zhvillimi i konceptit për një "Fakultet i Hapur".
REZULTATI 1.2:	<i>Menaxhimi i burimeve njerëzore (kadrovike)</i>

INDIKATORI I REZULTATIT:	1.	Matrica e nevojave për personel akademik në bazë të kornizës kurrikulare;
	2.	Matrica e nevojave për personal administrativ në bazë të kornizës kurrikulare;
	3.	Punësimi i planifikuar i personelit mësimor dhe administrativ;
	4.	Politikat e angazhimit të profesorëve vizitorë dhe të tjerë;
	5.	Avancim i vazhdueshëm i personelit akademik dhe administrativ nëpërmjet trajnimeve profesionale.
REZULTATI 1.3:	Promovimi dhe komunikimi me publikun (PR)	
INDIKATORI I REZULTATIT:	1. Komunikimi brenda fakultetit; 2. Komunikimi jashtë fakultetit; 3. Reputacioni i fakultetit; 4. Promovimi i brendshëm; 5. Promovimi i jashtëm.	

1.2. PRIORITETI STRATEGJIK 2 - Mësimdhënia dhe mësimnxënia

PRIORITETI STRATEGJIK 2: Avancim i cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies

Objektivi strategjik: FAB ofron mësimdhënie dhe mësimnxënie të avancuar

Në fushën e mësimdhënies, FAB gjatë katër viteve të ardhshme do të synojë avancimin e mëtutjeshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies që aktualisht bazohet në hulumtim të secilit anëtar nga personeli akademik dhe të studentëve të nivelit Bachelor dhe Master. Avancimi në këtë fushë të rëndësishme do të ketë për bazë qasjen strategjike të universitetit, e cila është ndërtuar në komponente siç janë:

- Programe studimi të ristrukturuara dhe rihvilluara në funksion të zhvillimit të kompetencave të studentëve;
- Programe studimore të reja të përshtatura me kërkesat e tregut;
- Zhvillimi profesional për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- 100% e stafit akademik kanë realizuar planin zhvillimor individual;
- Kulturë dhe frymë bashkëpunuese dhe motivuese për studentëve;
- Qendra e Ekselencës;
- Ekselencë në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe
- Mbështetje për studentët me nevoja të veçanta.

Përmes këtij objekti strategjik, FAB gjatë 4 viteve të ardhshme do të fokusohet në përballje me sfidat që ndërlidhen me ofrimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore.

Aktivitetet e para në realizimin e këtij objekti strategjik do të jenë në rrafshin e rishikimit dhe ristrukturimit të programeve studimore në të dy nivelet, si në atë Bachelor ashtu edhe në atë Master. Gjatë procesit të rishikimit të programeve, FAB do të bashkëpunojë ngushtë me sektorin e industrisë, por do të kërkojë gjithashtu përkrahje nga organizatat donator të cilat janë të përfshira në përkrahje të Arsimit të lartë në Kosovë.

Programet e rishikuara përveç se do të jenë në funksion të rritjes së kompetencave dhe shkathtësive të studentëve, ato do t'ju përshtaten kërkesave të tregut. Këto programe do të ofrojnë njohuri teorike dhe praktike dhe to të përgatisin studentë të aftë për tregun e punës dhe konkurrent në raport me institucionet e tjera të arsimit të lartë.

Gjatë viteve në vazhdim, FAB do të angazhohet rreth diversifikimit, profilizimit dhe zhvillimit të programeve të reja si përgjigje ndaj kërkesave të tregut. Ofertat e reja programore do ta bëjnë FAG një institucion atraktiv për studentë, dhe do të ndikojnë në rritjen e numrit të tyre.

Përveç profilizimit dhe zhvillimit të programeve të reja, dhe me qëllim të tërheqjes së studentëve të rinj, FAG do të angazhohet që të aplikojë për programe të përbashkëta qoftë me njësitë e tjera akademike brenda UHZ-së, qoftë programe të përbashkëta me universitete kombëtare e ndërkombëtare.

Mësimdhënia dhe mësimnxënia do të vazhdojë të jenë e bazuar në hulumtim, por me një rritje të fokusit në pjesën praktike. FAB do të fuqizojë bashkëpunimin me sektorin privat duke zbatuar marrëveshjet aktuale të bashkëpunimit, por edhe duke nënshkruar marrëveshje të reja bashkëpunimi me kompani dhe institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

FAB do të shfrytëzoj skemat aktuale të përkrahjes nga universiteti, ministria e arsimit dhe institucionet e tjera donatore duke aplikuar me projekte hulumtuese në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.

FAB do të promovojë inovacionin dhe përdorimin e teknologjisë informative në funksion të përmirësimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Gjatë viteve në vazhdim, FAB do të vazhdojë përkrahjen e personelit akademik në zhvillimin e mëtutjeshëm të metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies

FAB planifikon që të bëjë profilizimin e personelit akademik dhe do të kërkojë nga Qendra e Ekselencës që të hartojë dhe organizojë trajnime për personelin akademik të FAB.

FAB si njësi akademike në bashkëpunim me Qendrën e Ekselencës do të ofrojë përkrahje përmes planeve për zhvillim profesional dhe ngritje në karrierë të personelin akademik. Përkrahje do t'u ofrohet personelit akademik që janë para përfundimit të doktoratës, ndërsa një synim tjetër do të jetë rritja e avancimeve brenda njësisë akademike. Me qëllim të nxitjes së punës akademike, FAB do të kërkojë nga UHZ-së që të financojë tekstet universitare për nevoja të FAB dhe të mbështes

pjesëmarrja e personelit akademik në programe profesionale dhe trajnime jashtë vendit me qëllim të avancimit të mësimdhënies dhe mësimnxënies

FAB do të inkurajojë frymën bashkëpunuese në mes të studentëve duke zbatuar sistemin e ngritur nga Universiteti për vlerësimin student-student (peer to peer) dhe duke zbatuar këshillimin në karrierë për studentët e fakultetit.

FAG synon gjithashtu që edhe më tutje të përmirësohet raporti mësimdhënës-student deri në 1 mësimdhënës për 25 studentë.

Në funksion të përmirësimit të mëtutjeshëm të mësimnxënies, studentët do të përfshihen në të gjitha aktivitetet që ndërliken me hartimin/rishikimin e programeve, aktivitetet shoqërore e shkencore, mobilitet ndërmjet fakulteteve pjesëmarrja në trajnime/punëtori, zhvillimin e shkathtësive të buta etj.

FAB si njësi akademike do të përmbushë synimet e definuara në planin strategjik të UHZsë ku kërkohet fokus në ofrimin e kushteve të përshtatshme studimore të studentëve me nevoja të veçanta. Për ta promovuar këtë dimension, do të rritet bashkëpunimi me organizata të cilat i trajtojnë grupet e të rinjve me nevoja të veçanta.

Përshkrimi i rezultateve dhe indikatorëve për realizimin e objektivit strategjik: Mësimdhënie dhe mësimnxënie e avancuar

Mësimdhënia dhe mësimnxënia

<i>REZULTATI 2.1:</i>	<i>Programe studimi të ristrukturuara dhe të zhvilluara rishtas në funksion të zhvillimit të kompetencave të studentëve</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. FAG planifikon rishikimin e programeve që aktualisht ofrohen në fakultet (në bashkëpunim me bordin industrial dhe me palët e treta). 2. Tre programe Bachelor dhe një program Master të rishikuara dhe të ristrukturuara. 3. Ndryshimet inkorporohen në kurikulë gjatë hartimit të ardhshëm të raporteve të vetëvlerësimit për programet e rishikuara.
<i>REZULTATI 2.2:</i>	<i>Programe studimore të reja të përshtatura kërkesave të tregut</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hartimi i programeve të reja në studimet themelore dhe master (5 programe). 2. 3 programe Bachelor dhe 2 programe Master të aprovuara nga Agjencia Kosovare e Akreditimit 3. Rritje e numrit të stafit akademik për programet e reja (2 programe) 4. Rritje e numrit të studentëve në FAG (studentë) 5. Programe studimi online' 6. Programe studimi në distancë.
<i>REZULTATI 2.3:</i>	<p>Zhvillim profesional për metodologji bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies</p> <p>Metodologji bashkëkohore për mësimdhënie dhe mësimnxënie</p>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. FAB siguron teknologjisë inovative për mësimdhënie dhe mësimnxënie (x) 2. Qendra e Ekselencës pranë UHZ-së përkrah stafin akademik të punësuar në FAG me trajnime mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies (x staf akademik të trajnuar) 3. Bashkëpunim me institucione relevante për rritje të mundësisë dhe cilësisë së mësimdhënies; 4. Trajnime mbi metodat bashkëkohore të mësimdhënies;

<i>REZULTATI 2.4:</i>	Rritje e bashkëpunimit me sektorin privat, institucione lokale, kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e bujqësisë dhe ushqimit.
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ripërtëritje të marrëveshjeve aktuale dhe krijimi i marrëveshjeve të reja me sektorin privat dhe palët e treta (x marrëveshje të ripërtërira dhe x marrëveshje të reja) 2. Sudentët e FAG bashkëpunojnë përmes sistemin student-student (peer to peer) (x studentë kanë bashkëpunuar në sistemin peer to peer) 3. Promovimi i kërkimeve shkencore të mësimdhënësve në fushat përkatëse të studimit; 4. Ndërlidhja ndërmjet mësimit dhe kërkimit.
<i>REZULTATI 2.5:</i>	<p>Studentët e FAG janë të përfshirë në të gjitha aktivitetet e njësisë akademike dhe bashkëpunojnë përmes sistemin student-student (peer to peer)</p> <p><i>Kulturë dhe frymë bashkëpunuese dhe motivuese për studentët</i></p>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Forcimi i sistemit “peer to peer” për rritje të kalueshmërisë së studenteve; 2. Studentët përmes përfaqësuesve të tyre marrin pjesë në hartimin/rishikimin e programeve, aktivitetet shoqërore e shkencore, mobilitet ndërmjet fakulteteve pjesëmarrja në trajnime/punëtori, zhvillimin e shkathtësive të buta etj. (studentë kanë marrë pjesë në trajnime; studentë janë përfshirë në mobilitete) 3. Përmirësim për 50% i raportit profesor/student; 4. Sudentët e FAG bashkëpunojnë përmes sistemin student-student (peer to peer) (studentë kanë bashkëpunuar në sistemin peer to peer) 5. Zgjerimi i bashkëpunimit me industrinë dhe punëdhënësit, me qëllim të rritjes së punës praktike të studentëve dhe rezultateve të të nxënësve të tyre; 6. Përfshirja e studentëve në hartimin/rishikimin e programit të lëndëve; 7. Numri i bursave për studentët në të dy nivelet e studimit me qëllim të motivimit të studentëve aktualë dhe tërheqjes së studentëve të rinj; 8. Bashkëpunimi me parlamentin dhe organizatat studentore në drejtim të avancimit të mësimnxënies; 9. Mobilitetit të studentëve mes fakulteteve të UHZ-së përmes ofertës për ndjekjen e ligjëratave të ofruara në fakultetet e tjera, si dhe njohjes së kredive të marra; 10. Masa për zhvillimin e shkathtësive të buta të nevojshme për studentët.

1.3. PRIORITETI STRATEGJIK 3 – Sigurimi i cilësisë

PRIORITETI STRATEGJIK 3: *Sistem i konsoliduar - Përmirësim i vazhdueshëm i cilësisë brenda fakultetit*

Sigurimi i cilësisë është jetik për funksionimin e FAG-it. Andaj, krijimi i një sistemi të konsoliduar, i cili do të mundësojë përmirësim dhe kontrollin e vazhdueshëm të cilësisë brenda fakultetit, është një nga prioritetet kryesore të FAG-it për vitet e ardhshme. Sistemi do të jetë i bazuar në sigurim të qëndrueshmërisë dhe efikasitetin në të gjitha segmentet e fakultetit. FAG-it tashmë ka sistem funksional të sigurimit të cilësisë dhe është e motivuar që të ndërmarrë një varg reformash për administrim të sigurimit të cilësisë, reforma këto që do të kontribuojnë në zhvillimin e mëtejshëm të FAG-it.

FAG-it është i motivuar që në vazhdimësi ta përmirësojë nivelin e cilësisë në institucion. FAG-it synon që në periudhën e ardhshme të ketë strukturë të kompletuar të sistemit të sigurimit të cilësisë. Kjo do të bëhet përmes rritjes së numrit të zyrtarëve në Zyrën për Sigurim të Cilësisë, dhe rritjes së numrit të studentëve, palëve të brendshme dhe të jashtme, të angazhuar si bashkëpunëtorë në proceset e sigurimit të cilësisë. Kompletimi i tillë i strukturës së sistemit për sigurim të cilësisë do të mundësojë vazhdimësi në kultivimin e të gjitha segmenteve dhe komponenteve për sigurim të cilësisë. Fakulteti do të vazhdojë t'i zhvillojë kapacitetet e stafit në fushën e sigurimit të cilësisë, për të siguruar që ata të kenë aftësi të zhvillimit të karrierës menaxheriale dhe teknike. Kjo do të arrihet përmes trajnimeve për stafin, përgjegjës të drejtpërdrejtë për sigurim të cilësisë, përfshirë stafin akademik, administrativ dhe studentët.

Studentët kanë rol thelbësor në vlerësimin, zhvillimin dhe përmirësimin e cilësisë së fakultetit. Përveç pjesëmarrjes në vlerësim, ata janë pjesë e organeve vendimmarrëse të fakultetit, janë të përfshirë në organe dhe komisione të sistemit të sigurimit të cilësisë, prandaj FAG-it do të bëjë përpjekje të vazhdueshme që pjesëmarrja e tyre të rritet. Komentet e studentëve janë nxitësi më i madh i përmirësimin në fakultet. Informatat kthyes (**feedback-u**) mundëson që fakulteti të ndërgjegjësohet për problemet e perceptuara ose të hasura nga studentët dhe ofron mundësi për kryerjen e vetëvlerësimit dhe rishikimit, aty ku është e nevojshme.

Gjatë zbatimit të këtij plani strategjik, FAG-it do të angazhohet që t'i rishikojë instrumentet e brendshme për sigurim dhe vlerësim të cilësisë. Ajo do t'i identifikojë mungesat eventuale që mund të ekzistojnë në këto instrumente dhe do t'i plotësojë dhe përmirësojë ato sipas nevojave.

Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim do të angazhohet për zgjerimin e fushëveprimit të vlerësimit në të gjitha segmentet e fakultetit. Vlerësimi do të kontribuojë në identifikimin e ngecjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, duke ndikuar kështu drejtpërsëdrejti edhe në cilësinë e zhvillimit të aktiviteteve në këtë njesi akademike.

FAG-it e konsideron tejet të rëndësishme punën kërkimore shkencore dhe artistike, pastaj ndërkombëtarizimin, punën praktike të studentëve, zhvillimin e programeve të studimit, nivelin e kalueshmërisë, zhvillimin e infrastrukturës, prandaj parasheh zgjerimin e fushëveprimit të sigurimit të cilësisë, duke i vlerësuar këto fusha.

Fakulteti i Agrobiyenesit ka një sistem të sigurimit të cilësisë të mirë përcaktuar, i cili gjatë gjithë kohës synon të lëvizë drejtë përmirësimit-përsosmërisë. Është e domosdoshme që te studentët, stafi akademik, stafi administrativ si dhe të palët e jashtme të promovohet një kulturë e qëndrueshme për sigurim të cilësisë,. FAG-it do të zhvillojë dhe organizojë aktivitete që kanë për qëllim rritjen e vetëdijes së studentëve, stafit akademik dhe administrativ mbi sigurimin e cilësisë në të gjitha segmentet e institucionit. Promovimi i

kulturës për sigurim të cilësisë bëhet nëpërmjet takimeve/punëtorive, shpërndarjes së materialeve, fletushkave, broshurave informuese etj.

Duke qenë se wueb faqja e FAG-it është burim i rëndësishëm i informatave për studentët, stafin akademik, administrativ dhe publikun e gjerë, Zyra për Sigurim të Cilësisë dhe Vlerësim në vazhdimësi do të sigurojë informacione të qarta, të sakta dhe objektive me një nivel të lartë të cilësisë së përmbajtjeve të tyre. Fakulteti synon modernizimin e gjithë procesit të sigurimit të cilësisë, duke i transferuar proceset manuale në platforma digjitale, duke reduktuar përdorimin e letrës dhe duke e rritur efikasitetin. Përdorimi i një baze të digjitalizuar të të dhënave do të krijojë siguri për informacionet e mbledhura, duke reduktuar futjen e dyshimtë të rezultateve që kanë të bëjnë me fushat e sigurimit të cilësisë në FAG.

Ridizajnimi i wueb faqes do ta bëjë të mundur publikimin e sa më shumë informatave për rëndësinë e sigurimit të cilësisë, këto informata përveç ëueb faqes do të shpërndahen edhe në platformat e mediave sociale të universitetit.

FAG-it është e motivuar që ta zgjerojë më tej digjitalizimin e proceduarve, përfshirë këtu edhe digjitalizimin e plotë të proceseve të Zyrës së Sigurimit të Cilësisë. Finalizimi i një procesi të tillë do të krijojë kushte më të përshtatshme për stafin e angazhuar në këtë zyrë, duke i thjeshtuar skajshmërisht procedurat burokratike dhe aspektet teknike të funksionimit. FAG-it do të angazhohet për digjitalizim sa më të madh të të gjitha instrumenteve të sigurim të cilësisë.

Shkëmbimi i përvojave profesionale në fushën e sigurimit të cilësisë është shumë më rëndësi për fakultetin tonë. Prandaj, FAG-it do të bashkëpunojë dhe do të shkëmbejë përvoja profesionale për fushën e sigurimit të cilësisë, me organizata/projekte, fakultetet vendore dhe rajonale, dhe fakultete ndërkombëtare. Shkëmbimi i përvojave profesionale me institucionet relevante ka për qëllim shkëmbimin e njohurive, përvojave dhe praktikave më të mira në përpjekje për të promovuar sigurimin e cilësisë.

Shkëmbimi i përvojave do të realizohet në disa mënyra, si: vizita pune dhe pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme.

Qëndrueshmëria është një nga parimet kryesore të funksionimit të FAG-it. Andaj, FAG-it është e motivuar dhe maksimalisht e përkushtuar që të sigurojë riakreditim të suksesshëm institucional dhe të programeve të studimeve si një proces i rëndësishëm i sigurimit të cilësisë. Universiteti do t'i shtojë përpjekjet për të siguruar vazhdimësi të akreditimeve instucionale dhe të programeve të studimeve.

REZULTATI 3.1:	Strukturë e kompletuar dhe ngritje e vazhdueshme e kapaciteteve për sigurim të cilësisë dhe vlerësim
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i zyrtarëve në Zyrën për Sigurim të Cilësisë; 2. Numri i trajnimeve për stafin përgjegjës të drejtpërdrejtë për sigurim të cilësisë; 3. Numri i trajnimeve për stafin akademik, administrativ dhe studentëve që kontribuojnë në proceset e sigurimit të cilësisë; 4. Numri i trajnimeve për studentë, në varësi të përgjegjësive që u atribuohen, ose të kontributit të tyre të pritshëm; 5. Numri i studentëve pjesëmarrës në proceset e sigurimit të cilësisë; 6. Numri i palëve të brendshme dhe të jashtme, pjesëmarrëse në proceset e sigurimit të cilësisë.

<i>REZULTATI 3.2:</i>	<i>Rishikimi i rregullativës, instrumenteve të rregullta dhe strukturës së sistemit të sigurimit të cilësisë, me synim të avancimit të sigurimit të cilësisë</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i dokumenteve të brendshme të rishikuara për sigurim dhe vlerësim të cilësisë; 2. Numri i instrumenteve të brendshme të rishikuara për sigurim dhe vlerësim të cilësisë; 3. Rishikim i aranzhimeve të sigurimit të cilësisë në përputhje me rrethanat.
<i>REZULTATI 3.3:</i>	<i>Zgjerim i fushëveprimit të sigurimit të cilësisë</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Dizajnim dhe realizim i pyetësorit për vlerësimin e punës kërkimore shkencore dhe artistike; 2. Dizajnim dhe realizim i pyetësorit për vlerësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërkombëtarizimit; 3. Dizajnim dhe realizim i pyetësorit për vlerësimin e punës praktike të studentëve; 4. Dizajnim dhe realizim i pyetësorit për vlerësimin e programeve të studimit; 5. Kalueshmëria e studentëve për secilin program, e vlerësuar; 6. Dizajnim dhe realizim i pyetësorit për vlerësimin e infrastrukturës, it dhe sistemeve elektronike online.
<i>REZULTATI 3.4:</i>	<i>Avancimi dhe promovimi i një kulture të qëndrueshme për sigurim të cilësisë</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i takimeve/punëtorive për ndërgjegjësimin/sensibilizimin e studentëve, për rëndësinë e sigurimit të cilësisë; 2. Numri i takimeve punëtorive, për ndërgjegjësimin/sensibilizimin e stafit akademik, për rëndësinë e sigurimit të cilësisë; 3. Numri i takimeve dhe punëtorive të mbajtura me stafin akademik për mbikëqyrjen e cilësisë së programeve të studimit; 4. Numri i takimeve dhe punëtorive të mbajtura me studentë për rishikimin e programeve të studimit; 5. Numri i takimeve të mbajtura me stafin administrativ për përmirësimin e shërbimeve administrative; 6. Materialet informuese të shpërndara, për rëndësinë e sigurimit të cilësisë.
<i>REZULTATI 3.5:</i>	<i>Avancim i infrastrukturës digjitale për procedurat e sigurimit të cilësisë</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e qasjes dhe transparencës së fakultetit përmes ridizajnit të web faqes; 2. Publikim i informacioneve dhe të dhënave për proceset dhe vlerësimet e sigurimit të cilësisë; 3. Numri i instrumenteve të brendshme të sigurimit të cilësisë të digjitalizuara; 4. Platformë elektronike e krijuar, e cila përfshinë të gjitha procedurat dhe proceset e sigurimit të cilësisë.

<i>REZULTATI 3.6:</i>	<i>Krijim i rrjetit dhe lidhjeve dhe shkëmbim i përvojave profesionale për sigurim të cilësisë</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i bashkëpunimeve dhe shkëmbimit të përvojave profesionale për sigurim të cilësisë, me organizata/projekte vendore, rajonale dhe ndërkombëtare; 2. Numri i bashkëpunimeve dhe shkëmbimit të përvojave profesionale për sigurim të cilësisë me universitete vendore dhe rajonale;
	3. Numri i bashkëpunimeve dhe shkëmbimit të përvojave profesionale për sigurim të cilësisë me fakultetet ndërkombëtare.
<i>REZULTATI 3.7:</i>	<i>Riakreditim i suksesshëm institucional dhe i programeve të studimit</i>
<i>INDIKATORI I REZULTATIT:</i>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Realizim i vetëvlerësimit të brendshëm në nivel institucional për qëllime të riakreditimit të programeve; 2. Realizim i vetëvlerësimeve të brendshme në nivel të programeve të studimit për qëllime të riakreditimit.

1.4. PRIORITETI STRATEGJIK 4 – Shkencë, kërkime dhe art

PRIORITETI STRATEGJIK 4: Rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe artistike

Rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore ka një rol kyç në performancën e Fakultetit të Agrobiznesit (FAG). Duke e konsideruar si fushën e katërt në planin strategjik të fakultetit, veprimtaria kërkimore-shkencore trajtohet me një kujdes të veçantë dhe i jepet një prioritet i lartë. Pas një analize të thelluar të kësaj fushe dhe me synimin e përmbushjes së vizionit dhe misionit të FAG, rritja e veprimtarisë kërkimore-shkencore është identifikuar si një prioritet strategjik i domosdoshëm.

Në këtë kontekst, veprimtaria kërkimore-shkencore shihet si një fushë mjaft e rëndësishme që ndikon në performancën dhe funksionimin e FAG. Ky prioritet strategjik ka për qëllim të forcojë cilësinë e arsimit të lartë, të nxisë konkurrencën dhe të kultivojë mendimin kritik, krijues dhe inovativ në institucionin tonë. Avancimi i kësaj fushe jo vetëm që e përshpejton zhvillimin e institucionit tonë, por gjithashtu e dallon atë nga institucionet e tjera të arsimit të lartë. Përmirësimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore shërben si një mjet për të thelluar cilësinë e mësimdhënies dhe për të krijuar një mjedis akademik të pasur me mundësi për studentët dhe stafin. Kjo gjithashtu forcon reputacionin e FAG në fushën e agrobiznesit dhe shpërblen punën e palodhur të stafit dhe studentëve të angazhuar në projekte të ndryshme kërkimore.

Me këtë plan strategjik, Fakulteti i Agrobiznesit shpreson të bëhet një referencë e rëndësishme në botën e arsimit të lartë, duke kultivuar një mjedis të përgatitur për sfidat e sotme dhe të ardhshme dhe duke kontribuar në inovacionin dhe zhvillimin e fushës së agrobiznesit.

Rritja e intensitetit të kërkimit shkencor në fakultetin e Agrobiznesit do të përfshijë stafin akademik, studentët, grupet e interesit dhe grupet e tjera të rëndësishme. Me qëllim të arritjes së këtyre synimeve, FAG dhe Zyrja për Kërkime Shkencore do të zhvillojnë një bashkëpunim të thellë në disa fusha kyçe si:

- ✚ **Cilësia dhe sasia e publikimeve shkencore në FAG:** Fokusi do të jetë në avancimin dhe shtimin e njohurive në fushën e Agrobiznesit përmes cilësisë dhe sasisë së publikimeve shkencore. Synohet të kontribuohet në zhvillimin dhe inovacionin e këtij sektori.

- ✚ **Rritja e kapaciteteve kërkimore:** FAG do të punojë në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve kërkimore të stafit akademik dhe studentëve të saj. Kjo ka për qëllim të përmirësojë hulumtimet dhe studimet në lidhje me sfidat dhe mundësitë në fushën e agrobiznesit.
- ✚ **Sigurimi i cilësisë dhe integritetit akademik:** Zhvillimi i mekanizmave dhe procedurave efektive për sigurimin e cilësisë në veprat shkencore specifike për Agrobiznesin do të përqëndrohet në verifikimin e autenticitetit. Kjo synon të promovojë integritetin akademik dhe të njohë kontributin e vërtetë të kërkimeve në këtë fushë.

Fakulteti i Agrobiznesit (FAG) synon të ndikojë në zhvillimin ekonomik dhe social në nivel lokal dhe kombëtar duke shtuar vlerë nëpërmjet rritjes së kërkimit shkencor dhe pjesëmarrjes aktive në projekte të ndryshme. Në fokus të FAG është që të forcohet lidhja ndërmjet kërkimit, arsimit dhe shoqërisë së gjerë, duke thelluar bashkëpunimin me universitete vendore dhe ndërkombëtare. Me një qasje ndërdisiplinore, FAG synon të adresojë sfidat komplekse të shoqërisë dhe të kontribuojë në zhvillimin shoqëror përmes ideve kreative dhe sinergjisë së krijuar nëpërmjet multidisiplinaritetit.

Fakulteti i Agrobiznesit (FAG) ka përkushtim për të avancuar veprimtarinë kërkimore-shkencore duke ofruar mbështetje teknike dhe infrastrukturore të nevojshme. Në vitin e parë të planit strategjik, FAG synon të identifikojë dhe adresojë mangësitë e infrastrukturës që mund të ndikojnë në realizimin e aktiviteteve kërkimore. Për të forcuar lidhjen ndërmjet kërkimit, arsimit dhe shoqërisë, FAG synon të jetë pjesë një revistë shkencore dhe një revistë studentore sebashku me fakultetet tjera të UHZ-së.

Për të përmirësuar aksesin dhe efikasitetin në kërkime, FAG planifikon të marrë licencat e nevojshme për programet softuerike dhe të pajise laboratorët me aparatura të nevojshme. Në përpjekje për të optimizuar suksesin, FAG do të mbështesë profesionistët akademikë në zhvillimin e tyre përmes instrumenteve mbështetëse të ofruara nga Zyra për Kërkim Shkencor. FAG synon të forcojë gamën e aktiviteteve kërkimore duke stimuluar bashkëpunimet me institute të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe biznese vendore. Përmes Instituti për Shkencë dhe Art, FAG synon të inicojë projekte kërkimore shkencore me ndikim në komunitetin akademik dhe sektorin e biznesit. Ky fokus interdisiplinor synon të krijojë një mjedis ku kërkimi shkencor, social dhe kulturor zhvillohet me cilësi dhe krijon vlerë.

FAG synon të intensifikojë veprimtarinë e veprimtarisë kërkimore-shkencore nëpërmjet promovimit dhe stimulimit të vazhdueshëm dhe sistematik në këtë fushë. Prandaj, për të përmbushur prioritetin strategjik për veprimtarinë kërkimore-shkencore, FAG synon arritjen e rezultateve të mëposhtme;

- ✚ Rezultati 4.1: Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime shkencore
- ✚ Rezultati 4.2: Nxitja e veprimtarisë kërkimore-shkencore
- ✚ Rezultati 4.3: Rritja e numrit të kërkimeve dhe publikimeve shkencor
- ✚ Rezultati 4.4: Ndërlidhja e rezultateve të kërkimeve shkencore me tregun e punës

Rezultati 4.1:	Përmirësimi i infrastrukturës për kërkime shkencore
Indikatorët e rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Identifikimi i mangësive infrastrukturore: 2. Investimet dhe përmirësimet infrastrukturore: 3. Krijimi i laboratorëve dhe pajisjeve të nevojshme: 4. Krijimi i platformave për kërkime të përbashkëta:

	5. Përdorimi efikas i teknologjisë dhe softuerëve të avancuar:
Rezultati 4.2.	Nxitja e veprimtarisë kërkimore-shkencore
Indikatorët e rezultatit	<ol style="list-style-type: none"> 1. Projekte kërkimore: 2. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe vendor: 3. Publikimet shkencore dhe konferencat: 4. Ndarja e çmimeve: 5. Organizimi i aktiviteteve shkencore: trajnime, seminare, punëtori, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta, konferenca shkencore 6. Rritja e nivelit të pjesëmarrjes së studenteve në hulumtime:
Rezultati 4.3.:	Rritja e numrit të kërkimeve dhe publikimeve shkencor
Indikatorët e rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i projekteve kërkimore: 2. Numri i publikimeve shkencore në revista të njohura: 3. Pjesëmarrja në konferenca shkencore ndërkombëtare: 4. Numri i pjesëmarrjes së personelit akademik në aktivitete shkencore: trajnimeve, seminareve, punëtorive, simpoziume, tryeza të rrumbullakëta 5. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitete kombëtare 6. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me universitetet ndërkombëtare 7. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me kolegët e brendshëm 8. Realizimi i punës kërkimore në bashkëpunim me studentët 9. Realizimi i kërkimeve aplikative 10. Përfshirja e punimeve shkencore në syllabusë
Rezultati 4.4.:	Ndërlidhja e rezultateve të kërkimeve shkencore me tregun e punës
Indikatorët e rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Raporti i përfshirjes së studentëve në projekte të përbashkëta me industrinë: 2. Feedback nga ndërmarrjet dhe punëdhënësit: 3. Ndërtimi i lidhjeve me kompani dhe organizata të agrobiznesit: 4. Raporti i diplomuarve që zhvillojnë bizneset e tyre: 5. Përfshirja e studenteve në trajnime dhe stazh në industrinë e agrobiznesit: 6. Krijimi i forumeve dhe ngjarjeve për bashkëveprim me industrinë:

1.5. PRIORITETI STRATEGJIK 5 – Ndërkombëtarizimi

PRIORITETI STRATEGJIK 5: Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstitucional

Fakulteti i Agrobiznesit gëzon një prezencë të fortë në bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar. Aktualisht është i përfshirë në disa projekte kërkimore ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare dhe po vazhdon aktivisht të zgjerojë këtë bashkëpunim. Rritja e këtij bashkëpunimi synon të prekë drejtpërdrejt shumë aspekte të zhvillimit akademik, administrativ dhe hulumtues. Fakulteti i Agrobiznesit synon të thellojë bashkëpunimin ndërkombëtar duke marrë pjesë në aplikime për projekte të skemave ndërkombëtare, si "Erasmus+," "HORIZON," "Jean Monet," KUSA, projekte të financuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë, dhe Inovacionit, e Kosovës (MASHT), etj., si anëtarë apo udhëheqës të projekteve. Synimi është gjithashtu të zgjerohet rrjeti i numrit të universiteteve dhe institucioneve me të cilat do të bashkëpunojë, për të zhvilluar programe të reja arsimore të njohura ndërkombëtarisht, të nevojshme për tregun vendor dhe ndërkombëtar, për të forcuar pozicionin akademik në nivel ndërkombëtar, për të rritur diversitetin dhe për ta përmirësuar cilësinë, duke organizuar ngjarje ndërkombëtare shkencore dhe akademike, si dhe duke zhvilluar projekte të përbashkëta ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare. Aktualisht, Fakulteti i Agrobiznesit është partner në dy projekte ndërkombëtare dhe ndërinstitucionale, "Bugi ERASMUS+ Urban Agriculture", "STEPS ERASMUS+", si dhe bartës i një projekti hulumtues të financuar nga MASHT, në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe Institutin e ushqimit në Shkup. Fakulteti i Agrobiznesit synon ta rrisë numrin e bashkëpunimeve ndërkombëtare për kërkime shkencore, bashkëpunim ndërinstitucional, shkëmbim dhe zbatim të projekteve. Kjo rritje korrespondon me objektivat strategjike të kërkimit shkencor dhe kapaciteteve organizative për zbatim. Fakulteti i Agrobiznesit është duke e zgjeruar ndjeshëm rrjetin e bashkëpunitorëve, por edhe cilësinë dhe përmbajtjen e bashkëpunimeve. Shtimi i numrit të projekteve të skemave evropiane të financimit të kërkimit shkencor dhe mobilitetit paraqet pikësynim shtesë. Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar, Fakulteti i Agrobiznesit i kushton rëndësi të veçantë realizimit të bashkëpunimit me industrinë dhe institucionet vendore. Misioni dhe vizioni i ri i UHZ-së, i cili korrespondon edhe me atë të Fakultetit të Agrobiznesit, përqendrohet drejt profilizimit dhe ndërmarrësisë. Bashkëpunimi me industrinë biznesore do të jetësojë këtë mision dhe vizion. Gjithashtu, Fakulteti i Agrobiznesit është i përqëndruar dhe e konsideron si të rëndësishëm bashkëpunimin me komunitetin. Profilizimi i institucionit lidhet ngushtë me bashkëpunimin me industrinë. Ky fakultet do ta fuqizojë bashkëpunimin me institucione e biznese vendore edhe në funksion të ofrimit të mundësisë për punë praktike të studentëve, por edhe të ndërlidhjes dhe harmonizimit të programeve të studimeve me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Synimi i Fakultetit të Agrobiznesit, sic është edhe i tërë Universitetit Haxhi Zeka, është që në programet e tij, sidomos në ato që lidhen me praktikën e punës, të zgjerojë pjesëmarrjen e studentëve në punë praktike si dhe të rregullojë raportin e mësimit teorik dhe atij praktik në dobi të rritjes së përqindjes së punës praktike në raport me njohuritë teorike. Ky synim tanimë është duke u jetësuar poashtu edhe përmes bashkëpunimit me projektin e shtetit të IOWA-s, të financuar nga USAID, "Private sector partnerships to strengthen higher education", i cili do të implementohet në pesë vitet në vijim në Fakultetin e Agrobiznesit dhe në bashkëpunim ndërinstitucional vendor, poashtu. Ndërkombëtarizimi institucional i Fakultetit të Agrobiznesit parasheh aktivitete të cilat do të rrisin vizibilitetin e institucionit si brenda dhe jashtë vendit. Në vitin 2022 UHZ-ja ka organizuar universitetin e parë veror, i cili do të jetë i përvitshëm, ku edhe Fakulteti i Agrobiznesit ka ofruar kurse në bashkëpunim me profesorë ndërkombëtar. Përveç qëllimit studimor, universiteti veror synon edhe

socializimin, bashkëpunimin dhe shkëmbimin e studentëve dhe profesorëve nga vende të ndryshme të botës. Në janar të vitit 2023 UHZ-ja do të organizojë edhe Universityetin e pare dimëror, ku poashtu do të jetë pjesëmarrës edhe Fakulteti i Agrobiznesit. Konferencat shkencore ndërkombëtare do të jenë të përvitshme dhe do të shërbejnë në rritjen e bashkëpunimit shkencor të brendshëm dhe ndërmjet studentëve të Fakultetit të Agrobiznesit me pjesëmarrësit e tjerë lokalë dhe ndërkombëtarë. Vizitat studimore të personelit dhe të studentëve do ta ndërkombëtarizojnë edhe më shumë institucionin. Trajnimet për rritjen e kapaciteteve për shkrim të projekteve ndërkombëtare do të jenë prioriteti kryesor i UHZ-së dhe i Fakultetit të Agrobiznesit, poashtu. Kjo njëkohësisht do të përmirësojë kushtet për studentë, personel akademik dhe infrastrukturën.

Arritja e objektivit të kësaj fushe do të mbështetet nga rezultatet e mëposhtme:

REZULTATI 5.1.:	Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe projekteve ndërkombëtare
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i kontributeve në projekte ndërkombëtare: Numri i kontributeve të stafit dhe studentëve në projekte ndërkombëtare, duke përfshirë pjesëmarrjen në aplikime për financim ndërkombëtar. 2. Numri i marrëveshjeve të reja me universitete dhe institucione ndërkombëtare: Numri i marrëveshjeve të reja ose të rinovuara për bashkëpunim me universitete dhe institucione tjera ndërkombëtare. 3. Numri i pjesëmarrjeve në ngjarje ndërkombëtare: Pjesëmarrja në konferenca, seminare, dhe ngjarje tjera ndërkombëtare për të përcjellë zhvillimet në fushën akademike dhe shkencore. 4. Numri i projekteve të përbashkëta ndërinstitucionale: Numri i projekteve që zhvillohen bashkë me universitete dhe institucione të tjera ndërkombëtare. 5. Numri i studentëve të shkëmbimit/mobilitetit: Numri i studentëve që marrin pjesë në programe shkëmbimi ndërkombëtar për një periudhë të caktuar. 6. Numri i kursit të ofruar me pjesëmarrje ndërkombëtare: Numri i kurseve që ofrohen në bashkëpunim me universitete të tjera ndërkombëtare. 7. Numri i artikujve shkencorë të bashkëpunimit ndërkombëtar: Numri i artikujve shkencorë të publikuar bashkë me kolegë ndërkombëtarë në revista shkencore prestigjioze. 8. Rritja e numrit të konferencave shkencore ndërkombëtare: Rritja e numrit të konferencave shkencore ndërkombëtare të organizuara nga fakulteti. 9. Rritja e vizibilitetit ndërkombëtar në rrjetet sociale: Rritja e prezencës dhe ndikimit në platformat e rrjeteve sociale për të përcjellë sukseset dhe zhvillimet e fakultetit në nivel ndërkombëtar.

	10. Përpilimi i raporteve vjetore të bashkëpunimit ndërkombëtar: Përpilimi dhe prezantimi i raporteve vjetore që përmbajnë rezultatet dhe zhvillimet e bashkëpunimit ndërkombëtar.
REZULTATI 5.2.:	Projekte të përfituara si anëtar ose udhëheqës i skemave ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare.
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i projekteve të përfituara: Numri i projekteve në të cilat fakulteti ka përfituar si anëtar ose udhëheqës. 2. Vlera e financimit për projektet e përfituara: Vlera e financimit që është siguruar nga projektet e përfituara, duke përfshirë burimet nga skemat ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare. 3. Numri i partnereve në projektet e përfituara: Numri i institucioneve dhe universiteteve partnere në projektet e përfituara. 4. Numri i publikimeve shkencore nga projektet e përfituara: Numri i artikujve shkencorë që janë prodhuar dhe publikuar si rezultat i projekteve të përfituara. 5. Numri i studentëve të përfshirë në projekte: Numri i studentëve që janë përfshirë aktivisht në projektet e përfituara për të pasur një përvojë praktike dhe hulumtuese. 6. Numri i evenimenteve të organizuara si pjesë e projekteve: Numri i seminareve, punëtorive dhe ngjarjeve tjera që janë organizuar si pjesë e projekteve të përfituara. 7. Rritja e kapaciteteve të stafit dhe studentëve: Përmirësimi i njohurive dhe aftësive të stafit dhe studentëve përmes pjesëmarrjes aktive në projekte të përfituara. 8. Feedback pozitiv nga partnerët dhe pjesëmarrësit: Matur nga feedback pozitiv i dhënë nga partnerët dhe pjesëmarrësit në projekte, duke përfshirë vlerësimin e bashkëpunimit dhe arritjeve. 9. Përpilimi i raporteve vjetore të projekteve: Përpilimi dhe prezantimi i raporteve vjetore që përmbajnë rezultatet dhe impaktin e projekteve të përfituara. 10. Ndikimi i projekteve në zhvillimin e fakultetit: Përcaktimi i ndikimit të projekteve në zhvillimin e fakultetit në aspektet akademike, hulumtuese dhe administrative.
REZULTATI 5.3.:	Avancimi i bashkëpunimit me bizneset
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i marrëveshjeve të reja me bizneset: Numri i marrëveshjeve të reja të nënshkruara për bashkëpunim me kompanitë dhe bizneset lokale. 2. Numri i projekteve të përbashkëta me bizneset: Numri i projekteve dhe iniciativave të përbashkëta të zhvilluara me bashkëpunimin e bizneseve.

	<ol style="list-style-type: none"> 3. Vlera e kontributeve financiare nga bizneset: Vlera e kontributeve financiare që janë siguruar nga bizneset për projekte dhe aktivitete të fakultetit. 4. Numri i studentëve në praktika pune në biznese: Numri i studentëve të përfshirë në programe të praktikës së punës në kompani dhe biznese të ndryshme. 5. Numri i programeve të trajnimeve të përbashkëta: Numri i programeve të trajnimeve dhe punëshopave të organizuara së bashku me bizneset për të zhvilluar aftësi specifike. 6. Ndikimi në zhvillimin e kurrikulës: Përcaktimi i ndikimit të bashkëpunimit me bizneset në zhvillimin dhe përmirësimin e kurrikulës së programeve të studimit. 7. Numri i evenimenteve të organizuara me pjesëmarrjen e bizneseve: Numri i konferencave, seminareve dhe ngjarjeve të tjera ku bizneset kanë marrë pjesë si bashkëorganizatorë apo pjesëmarrës. 8. Feedback pozitiv nga bizneset: Matur nga feedback pozitiv i dhënë nga bizneset në lidhje me bashkëpunimin dhe kontributin e tyre në projektet dhe aktivitetet e fakultetit. 9. Krijimi i rrjeteve të reja biznesore: Krijimi i rrjeteve të reja dhe të përforcuara me bizneset lokale dhe sektoret relevante të industrisë. 10. Numri i studentëve që sigurojnë punë pas përfundimit të studimeve: Numri i studentëve që sigurojnë vend pune në bizneset dhe kompanitë me të cilat ka bashkëpunuar fakulteti.
REZULTATI 5.4.:	Rritja e aktiviteteve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i artikujve shkencorë të publikuar: Numri i artikujve shkencorë të publikuar në revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare. 2. Numri i konferencave shkencore të pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve: Numri i konferencave shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilat stafi dhe studentët kanë marrë pjesë. 3. Numri i projekteve hulumtuese të ndërmarrë: Numri i projekteve hulumtuese të ndërmarrë në fusha të ndryshme shkencore, përfshirë financimin nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare. 4. Numri i bashkëpunimeve shkencore me institucione të tjera: Numri i marrëveshjeve dhe bashkëpunimeve shkencore me universitete dhe institucione tjera kombëtare dhe ndërkombëtare. 5. Numri i punimeve të konferencave shkencore organizuar nga fakulteti: Numri i konferencave shkencore të organizuara nga fakulteti, duke përfshirë pjesëmarrjen e personaliteteve shkencore nga brenda dhe jashtë vendit.

	<ol style="list-style-type: none"> 6. Numri i publikimeve në mediat shkencore: Numri i publikimeve në mediave shkencore, përfshirë intervistat dhe artikujt e stafit shkencor në media të specializuara. 7. Përqindja e projekteve shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare: Përqindja e projekteve hulumtuese dhe shkencore që përfshijnë bashkëpunim ndërkombëtar në krahasim me ato me pjesëmarrje lokale. 8. Numri i studentëve që marrin pjesë në aktivitete shkencore: Numri i studentëve që marrin pjesë në projekte dhe aktivitete hulumtuese shkencore. 9. Numri i publikimeve në gjuhë të huaja: Numri i artikujve shkencorë të publikuar në gjuhë të huaja, tregues i prezantimit ndërkombëtar të punimeve shkencore. 10. Numri i projekteve të financuara nga fonde ndërkombëtare: Numri i projekteve hulumtuese dhe shkencore të financuara nga fonde ndërkombëtare, si pjesë e konkurseve dhe programeve ndërkombëtare.
REZULTATI 5.5.:	Rritja e kapaciteteve të personelit për shkrim të projekteve ndërkombëtare
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i trajnimeve për shkrim të projekteve ndërkombëtare: Numri i trajnimeve dhe punës dhe workshopave të ofruara për të përmirësuar aftësitë e personelit për shkrim të projekteve ndërkombëtare. 2. Përqindja e personelit të përfshirë në trajnime: Përqindja e personelit që ka marrë pjesë aktive në trajnime dhe aktivitete të tjera për zhvillimin e aftësive për shkrim të projekteve ndërkombëtare. 3. Numri i projekteve të shkruara nga personeli: Numri i projekteve që janë zhvilluar dhe paraqitur nga personeli si rezultat i njohurive të përmirësuara për shkrim të projekteve ndërkombëtare. 4. Përqindja e projekteve të suksesshme: Përqindja e projekteve që janë të suksesshme në marrjen e financimit ndërkombëtar pas përmirësimit të aftësive për shkrim të projekteve. 5. Numri i aplikimeve të reja për financim ndërkombëtar: Numri i aplikimeve të reja për financim ndërkombëtar nga personeli, si rezultat i njohurive të përmirësuara për shkrim të projekteve. 6. Numri i pjesëmarrjeve në seminare dhe trajnime: Numri i pjesëmarrjeve të personelit në seminare, konferenca, dhe trajnime për shkrim të projekteve ndërkombëtare. 7. Ndikimi i njohurive të reja në projekte aktuale: Përcaktimi i ndikimit të njohurive të reja të fituara në trajnime në projekte aktuale të zhvilluara nga personeli.

	<p>8. Numri i artikujve shkencorë: Numri i artikujve shkencorë dhe publikimeve të tjera të personelit, si rezultat i përdorimit të njohurive të fituara në trajnime për shkrim të projekteve.</p> <p>9. Rritja e aftësisë për krijimin e partneriteteve ndërkombëtare: Vlerësimi i aftësisë së personelit për të identifikuar dhe krijuar partneritete ndërkombëtare për shkrim të projekteve.</p>
--	--

1.6. PRIORITETI STRATEGJIK 6 – Studentët

PRIORITETI STRATEGJIK 6: Motivimi, kënaqshmëria dhe aktivizmi më i madh studentor

Në arsim, motivimi përkufizohet si diçka që inkurajon studentët të studiojnë, përcakton drejtimin, intensitetin dhe kohëzgjatjen e të nxëniet. Motivimi është një nga përcaktuesit kryesorë të suksesit të çdo nxënësi. Vetëmotivimi dhe motivimi janë jashtëzakonisht të rëndësishme për arritjen e qëllimeve dhe ndjenjën e kënaqësisë duke studiuar. Dallimet individuale midis studentëve janë të mëdha dhe motivohen nga faktorë të ndryshëm.

Ky plan strategjik është hartuar në fund të vitit 2023, të cilin Fakulteti i Agrobiznesit “Haxhi Zeka” në Pejë, do ta përdor si dokument bazë për zhvillimin e periudhës tre vjeçare 2023-2026. Andaj, studentët janë përfituesit kryesor të procesit të përvetësimit dhe transferit të dijes funksionale. Këtë grup të interesit e përbëjnë studentët të rregullt vendor dhe ata ndërkombëtarë. Diversiteti, numri i madh i studentëve, numri i programeve dhe nevojat e tregut për njerëz të kualifikuar shtojnë sfidat për zhvillim të vazhdueshëm për të mbajtur hapin dhe plotësuar nevojat e ekonomisë kosovare.

Thjeshtë, studentët paraqesin palën kryesore apo nukleusin e interesit për zhvillimin e fakultetit. Pritshmërit: Sinteza e rezultateve të analizës së situatës tregon se për ndryshim nga dy vitet paraprake sidomos aj i kaluar, viti i fundit 2023 kishte një rritje të lehtë të studentëve për të tri programet në nivelin Bachelor - Bsc. Ndërsa, për nivelin Master – Ma, kërkesat janë më të mëdha se sa mundësia apo numri i lejuar në akreditim.

Angazhimi i stafit akademik në promovimin e programeve në shkollat e mesme në Pejë dhe komunat tjera në regjion në periudhën e përfundimit të vitit shkollorë, ka bërë që numri i studentëve të rinjë të vendosin për studime në këtë Fakultet. Po ashtu, motivimi, kënaqshmëria dhe aktivizmi më i madh studentor i Alumnit (studentët e diplomuar të cilët vazhdojnë të gëzojnë shërbimet e Fakultetit të Edukimit) në lidhjen e urave të bashkëpunimit, ka bërë që të rritet besueshmëria me këtë fakultet.

Qëllimi dhe Objektivat:

Objektivi kryesor i Fakultetit, është formimi i profesionistëve të niveleve të ndryshme (bachelor dhe master) të aftë për të përballuar me sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave teknologjike, bujqësore dhe atyre ekologjike.

Objektiv tjetër madhor është përgatitja më cilësore, e studentëve në fushat e lartëcekura, që do të realizohet nëpërmjet rritjes së cilësisë së aftësisë teorik dhe praktik, në Ndërmarrësi dhe Institute hulumtuese shkencore.

Fakulteti i Agrobiznesit njëri nga objektivat synon të ofrojë studime universitare në cikle të ndryshme dhe në përputhje me Strategjinë e Universitetit “Haxhi Zeka” Pejë, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën në aplikim, për të përgatitur Bachelor, Inxhinier dhe Master të mirëformuar.

Fakulteti ka për qëllim të zhvillojë kërkime shkencore të aplikueshme në koordinim të vazhdueshëm me Universitetet dhe Institutet (Instituti Bujqësor në Pejë) dhe ato në bashkpunim (IOWA) dhe me nevojat e operatorëve zbatues në ekonomi, shoqëri dhe Ndërmarrësi.

Fakulteti, po ashtu, synon të realizojë projekte të ndryshme zhvillimi, të cilat mund të fokusohen në ndërtim, pajisje të infrastrukturës së nevojshme, laboratorë dhe hapësira të caktuara në shërbim të procesit akademik, rekreacionit, aktivitetit sportiv apo të jetës së studentëve, stafit ku zhvillohet aktiviteti. Nuk bën të kalohet pa u potencuar se Agrobiznesi, gjatë viteve të fundit, ka punuar pa reshtur në forcimin dhe zgjerimin e institucionit, duke ndjekur trendët e zhvillimit të arsimit të lartë në regjion, Evropë dhe SHBA, për këtë dëshmon edhe puna intensive e stafit akademik dhe administrative në kuadër të projektit të IOWA-s mbi 'Aktivitetet e partneritetit në sektorin privat për forcimin e arsimit të lartë'. Rekomandime: Rekomandohet që menaxhmenti i fakultetit së bashku me zyrën për karrierë në të ardhmen të bëjnë hulumtimin ndër vite në shkollat e mesme të larta në komunat e regjionit të Pejës mbi numrin aktual të nxënësve dhe trendët e luhatjes. Po ashtu, në kuadër të këtij aktiviteti të bëjë edhe promovimin e programeve, mundësitë e punësimit dhe ato të vazhdimit të studimeve pasdiplomike brenda universitetit, brenda shtetit dhe jashtë shtetit, pas përfundimit të studimeve të të dy niveleve.

Arritja e objektivit të kësaj fushe do të mbështetet nga rezultatet e mëposhtme:

REZULTATI 6.1.:	Rritja e motivimit për angazhim me të madh në mësim, etj.
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Shkalla dhe niveli i motivimit të studentëve për mësimnxënie, kërkime shkencore, anëtarësim në organizata studentore, aktivizëm studentor, 2. Strategjia me Plan të veprimit që Fakulteti duhet t'i ndërmarë, me qëllim të rritjes së motivimit të studentëve në të gjitha segmentet universitare, 3. Mjedisi pozitiv brenda dhe jasht universitar.
REZULTATI 6.2.:	Rritja e kënaqshmërisë së studentëve me shërbimet dhe jetën studentore
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Aktivitetet e studentëve të realizuara suksesshëm, 2. Aktiviteteve të ndërmarra nga studentët për studentët, 3. Aktiviteteve për rritjen e kapaciteteve të këshillave studentore.
REZULTATI 6.3.:	Rritja e kënaqshërisë së studentëve për proceset në universitet
INDIKATORI I REZULTATIT:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Besimi në cilësinë e studimeve dhe në shërbimet e fakultetit; 2. Perceptimi pozitiv për performancën e fakultetit; 3. Mobiliteti i brendshëm dhe i jashtëm i studentëve; 4. Kërkesa për regjistrim të studentëve në fakultet; 5. Vlerësimi i programit të studimit;

	6. Vlerësimi i programit të lëndëve; 7. Vlerësimi i punës praktike.
REZULTATI 6.4.:	Rritja e punësimit të studentëve të diplomuar
INDIKATORI I REZULTATIT:	1. Raporti për gjurmimet e iniciuara dhe të realizuara me të diplomuarit; 2. Raporti për punësimin e të diplomuarve; 3. Raporti për aktivitetet përkrahëse për punësim të të diplomuarve, të realizuara nga Zyra e Karrierës, etj.
REZULTATI 6.5.:	Rritja e interesimit të studentëve për regjistrim.
INDIKATORI I REZULTATIT:	1. Promovimi i fakultetit dhe ofertës programore; 2. Ofertë për vetprofilizim nëpërmjet kurrikulës së integruar, 3. Lidhja e mirë me institucionet dhe organizata biznesore për punë praktike dhe stazh, etj.
REZULTATI 6.6	Fuqizimi organizimit studentor
INDIKATORI I REZULTATIT:	1. Shtimi i numrit të organizatave studentore; 2. Rritja e konkureshmerisë programore; 3. Dialogu ndërmjet mësimdhënës – studentë.

1.7. PRIORITETI STRATEGJIK 7 – Ndërmarrësia

PRIORITETI STRATEGJIK 7: Zhvillimi i raportit funksional ndërmjet fakultetit dhe palëve të interesit

Ndërmarrësia është një nga fushat më të rëndësishme të shoqërisë së globalizuar të shekullit XXI. Të jesh ndërmarrës është një nga aftësitë më të kërkuara në tregun e punës, si dhe një nga gjeneruesit më të shpeshtë të bizneseve të reja dhe rrjedhimisht edhe vendeve të reja të punës. Në një ekonomi si ajo e Republikës së Kosovës me kapital njerëzor (ku afërsisht 27% e popullsisë janë të moshës nga 15 deri në 29 vjeç, provokimi i frymës ndërmarrëse është parakusht për të mbështetur këtë kategori të të rinjve, e që për rrjedhojë do të ketë gjenerim të ekonomisë. Për ta inicuar frymën ndërmarrëse në mesin e të rinjve është e domosdoshme inkorporimi i ndërmarrësisë në ofertën e studimeve të FAG-it. Marrë në konsideratë programet studimore të cilat aktualisht ofrohen nga FAG, rritja e prezencës së ndërmarrësisë si rezultat i të nxëniet për të gjithë studentët, padyshim që do të rris vet-punësimin e studentëve. Ky prioritet strategjik në periudhë afatgjatë do të kontribuoj edhe në mirëqenie ekonomike e sociale në rajonin e Pejës.

FAG-it e promovon ndërmarrësinë dhe të gjitha aktivitetet dhe shërbimet në zbatim do të rishikohen dhe vlerësohen me qëllim të përmirësimit, përditësimit dhe përshtatjes së tyre me konceptin sipërmarrës të FAG-it.

Krijimi i programeve mbështetëse do të paraprihet nga identifikimi i rrugëve të veprimit. Më konkretisht, këshillat industriale, në bashkëpunim me personelin e njësisë akademike, përfaqësues të studentëve,

përfaqësues nga bizneset lokale dhe hisedarë të tjerë, do të bëjë analiza të nevojshme dhe vlerësime mbi kërkesat dhe format e ndryshme të mbështetjes

Mbështetja mund të përfshijë, por nuk do të jetë e kufizuar në:

- ✦ Krijimin e rregullores së punës (strategjisë së komunikimit, planit të punës, organogramit);
- ✦ Fuqizimin e trupave këshillëdhënëse për biznese;
- ✦ Hulumtimin e tregut dhe ofrimin e programeve profesionale për të përmirësuar boshllëkun e shkathtësive dhe kërkesave të tregut të punës, duke i miratuar rekomandimet në senat;
- ✦ Zhvillimin dhe akreditimin e programeve profesionale të nivelit 5, duke ofruar trajnime për personat (stafi aktual i FAG-it) që do të përfshihen në programet profesionale. Komunikimi i vazhdueshëm me biznese bujqësore dhe ushqimore përditësimi plan programeve studimore në baze të kërkesave të tregut të punës. Ngritje të kapaciteteve në ndërmarrësi - shërbime të cilat mund të ofrohen nga FAG-it për të transferuar njohuri mbi konceptet bazë të ndërmarrësisë dhe aplikueshmërisë së tyre në praktikë.
- ✦ Ngritjen e kapaciteteve për menaxhim = ofrim të shërbimeve nga FAG-it përmes ekspertëve të fushave të menaxhimit që përkrahin bujqësinë dhe ushqimit, sigurimit të metodave të standardizuara që do të ofrohen shërbime të caktuara për bujqësi dhe ushqim, siç janë: testimet në laboratorë të fakultetit, përkrahje në bujqësi dhe ushqim dhe hulumtime të tregut;
- ✦ Përfshirjen e studentëve në mënyrë praktike në ofrimin e shërbimeve (hulumtime, punë praktike, menaxhim projekteve) nën menaxhim të personit përkatës.

Bashkëpunimi me palë të interesit është jetik për rrugëtimin strategjik dhe të përditshëm të FAG-it. Palët e interesit janë një nga kontribuesit më të mëdhenjë që përkrahin FAG-it në zhvillimin e politikave, zbatimin e tyre, monitorimin e punës, funksionimin institucional dhe arritjen e rezultateve të dëshirueshme.

Një bashkëpunim i shëndoshë dhe i qëndrueshëm me palët e interesit do t'i sigurojë FAG-it mbarëvajtje të proceseve brenda fakultetit, si dhe përgjigje për nevojat e palëve të interesit si përgjegjësi ndaj komunitetit. Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), 62% e popullsisë së përgjithshme në Kosovë jeton në zona rurale, aktiviteti në këto zona vazhdon të jetë bujqësia. Ky sektor po luan një rol të rëndësishëm në Republikën e Kosovës, duke kontribuar me 6.9% në Produktin Bruto Vendor (PBV). Me këto demografika, Fakulteti i Agrobiznesit synon të pajisë studentët me aftësi sipërmarrëse të lidhura drejtpërdrejt me veprimtaritë bujqësore dominuese në rajonin e Dukagjinit. Prandaj Fakulteti i Agrobiznesit në Universitetin Haxhi Zeka në Pejë ka një përkushtim të thellë ndaj zhvillimit të një mjedisi inovativ dhe sipërmarrës. Në kontekstin bujqësor të Kosovës, integrimi i sipërmarrjes në strukturën akademike shërben si një katalizator për një zhvillim të qëndrueshëm, rritjen ekonomike dhe krijimin e një komuniteti të gjallë në sektorin e agrobiznesit. Misioni dhe vizioni i Universitetit Haxhi Zeka (UHZ) përputhen plotësisht me ato të Fakultetit të Agrobiznesit (FAG), duke u përqendruar në profilizimin dhe sipërmarrjen në përputhje me kërkesat e tregut. Bashkëpunimi me sektorin e biznesit do të forcojë edhe më tej këtë mision dhe vizion. Aktualisht, Fakulteti i Agrobiznesit ka arritur marrëveshje bashkëpunimi me disa prej bizneseve kryesore të kësaj fushe, siç janë; Stone Castle, Grupi Appetit, Birra Peja, Me-Agro, Rugova, Konsoni, Agroelita, Abi Milk, Sharri, Pestova, Vita, Eko Wine, Korporata Devolli, Bylmeti dhe të tjerë.

Fakulteti i Agrobiznesit është i përkushtuar ndaj pjesëmarrjes aktive në komunitet dhe përforcimit të lidhjeve me institucionet dhe bizneset lokale, me qëllim që të ofrojë mundësi praktike dhe mundësi punësimi për

studentët. Nisma jonë synon jo vetëm të avancojë aftësitë teorike dhe praktike të studentëve, por gjithashtu të stimulojë mundësitë e tyre për punësim dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të regjionit të Pejës, posaçërisht në fushat e agroekologjisë, shkencave mjedisore, teknologjisë së prodhimit bimor dhe teknologjisë ushqimore.

Ky synim po forcohet edhe më tej përmes bashkëpunimit tonë me projektin e IOWA-s, i financuar nga USAID, "Bashkëpunimet me sektorin privat për forcimin e arsimit të lartë", i cili do të zbatohet në pesë vitet e ardhshme. Për më tepër, UHZ, përmes Forumit Ekonomik Rajonal, synon të krijojë dështë që Universiteti Haxhi Zeka të kthehet në qendër të sipërmarrjes në rajonin e Pejës. Ky seksion i planit strategjik shpjegon objektivat, strategjitë dhe qëllimet e qarta për zhvillimin e sipërmarrjes brenda Fakultetit të Agrobiznesit.

Arritja e objektivit të kësaj fushe do të mbështetet nga rezultatet e mëposhtme:

Rezultati 7.1.:	Ngritja dhe operimi i Qendrës Përkrahëse të Biznesit (QPB) brenda Fakultetit të Agrobiznesit për të rritur shërbimet mbështetëse për agrobizneset dhe studentët.
Indikatori i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Hulumtimi i tregut dhe programet bujqësore; për të identifikuar tendencat dhe mundësitë në industrinë e agrobiznesit poashtu përditësimi i kurrikulave për të përputhur me kërkesat e tregut dhe prezantimi i programeve apo module të reja profesionale. 2. Forcimi i Kapaciteteve në Ndërmarrjet Bujqësore; Organizimi i sesioneve të trajnimit, seminareve dhe punëtorive që përgjigjen ndaj nevojave të studentëve dhe profesionistëve të agrobiznesit. Bashkëpunimi me ekspertë të fushës për nismat e forcimit të kapaciteteve në ndërmarrjet bujqësore. 3. Bashkëpunimi dhe Zhvillimi i Shërbimeve apo Produkteve; Forcimi i bashkëpunimeve me partnerë të industrisë për zhvillimin e shërbimeve apo produkteve të reja. Duke bërë përdorimin e pajisjeve laboratorike të FAG për nevojat praktike të agrobiznesve. 4. Numri i shërbimeve të ofruara për biznese. 5. Rritja e numrit të studentëve të angazhuar në ofrim të shërbimeve.
Rezultati 7.2.:	Rritja e partneriteteve të qëndrueshme me agrobizneset
Indikatori i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Komunikimi i vazhdueshëm me palët e interesuara në bujqësi 2. Numri i bashkëpunimeve me palë të interesit dhe forcimi i partneriteteve me FAG dhe sektorin privat, 3. Numri i marrëveshjeve palët e interesit, Zyra për Zhvillim të Karrierës dhe FAG për punë praktike, 4. Numri i mentorimeve në punën praktike profesor, student dhe palët e interesit 5. Numri i palëve të interesit të përfshirë në projektet e fituara nga FAG 6. Numri i punimeve shkencore në bashkëpunim me palët e interesit

	7. Krijimi i një baze të dhënash me pjesëmarrësit interesuar.
Rezultati 7.3.:	<i>Inkurajimi I studenteve për krijimin e bizneseve të reja</i>
Indikator i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri i shërbimeve dhe trajnimeve nga ekspertët e fushës. 2. Numri i fituar i planeve të biznesit të organizuara nga QPB. 3. Krijimi i takimeve nga studentet e diplomuar për studentët e rinjë rreth përvojës praktike dhe punësimit. 4. Angazhimi i të diplomuarve dhe histori suksesi.

1.8. PRIORITETI STRATEGJIK 8 – Infrastruktura

PRIORITETI STRATEGJIK 8: Krijimi i një kampusi modern studentor sipas standardeve bashkëkohore

Për t’iu përshtatur epokës moderne akademike dhe për ta promovuar procesin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies, fakulteti i Agrobiznesit në Pejë synon vazhdimisht në përmirësimin e infrastrukturës dhe shndërrimin e ambientit mësimor në një mjedis edukues, dinamik, i cili karakterizohet nga atmosfera e hapur dhe i cili nxitë iniciativën dhe krijimtarinë e studentëve.

FAG-it do ta përmirësojë vazhdimisht infrastrukturën e gjithëmbarshme të saj, duke u siguruar që ambientet t’u përshtaten nevojave të fakultetit, prandaj do t’i bëjë renovimet e nevojshme dhe do ta rrisë nivelin e mirëmbajtjes së objekteve ekzistuese. Angazhimi i tillë do të jetë i orientuar në përmirësimin e mëtejshëm të kushteve themelore për mësimnxënie efektive, e cila mund të ketë efekt pozitiv në rezultatet, performancën dhe nivelin e kënaqshmërisë së studentëve. Në periudhën e ardhshme 4-vjeçare FAG-it do të ketë infrastrukturë të përmirësuar, të përshtatshme për nevojat e secilës njësi akademike dhe të mjaftueshme për t’i plotësuar kapacitetet e fakultetit.

Planifikohet që të zhvillohen të gjitha procedurat e parapara nga kontraktimi i punëkryesit, mbikëqyrja e projektit e deri te funksionalizimi i objektit të ri të fakultetit.

Në vazhden e angazhimeve të FAG-it për përmirësimin e infrastrukturës, do të bëhet edhe përshtatja, renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve ekzistuese. Synojmë që së shpejti të bëjmë identifikimin e nevojave dhe të kërkesave për renovime të objekteve ekzistuese dhe pastaj të bëjmë edhe ekzekutimin e punimeve në renovimin e objekteve, që do të mundësonin përshtatjen e hapësirave ekzistuese. Po ashtu, do të behët mirëmbajtja rutimore dhe do të ndërmerren veprime të ndryshme, me qëllim të evitimit të degradimit ose dëmtimit të hapësirave, me qëllim të përmirësimit të dëmtimeve (riparime të vogla), kryesisht pastrime, riparime dhe masa preventive me qëllim të mirëmbajtjes në gjendje të dëshirueshme për shfrytëzim të objekteve ekzistuese dhe hapësirave fakultative.

FAG-it është e angazhuar për të siguruar të gjitha kushtet e nevojshme për një edukim cilësor që rrit nivelin e konkurrueshmërisë së studentëve të vet. Andaj, në periudhën e ardhshme FAG-it do t’i përdorë të gjitha kapacitetet e saj për t’i përmirësuar sistemet dhe infrastukturën e teknologjisë së informacionit me qëllim që të plotsojë standardet themelore, që shpiejnë në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të ofrimit të shërbimeve, cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe përvojën e studimeve në institucion. Shërbime të avancuara elektornike për studentë do të jenë praktikë e përditshme e fakultetit.

Fakulteti i Agrobiznesit është njësi akademike pranë Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë që ofron mësimdhënie dhe mësimnxënie cilësore dhe profesionale në bujqësi, mjedis dhe shkenca të ushqimit e të cilat kontribuojnë në zhvillimin ekonomik rajonal dhe më gjerë.

Prioriteti strategjik i fakultetit të Agrobiznesit është krijimi i një kampusi modern studentor sipas standardeve bashkëkohore për t'iu përshtatur kushteve moderne akademike dhe për ta promovuar procesin efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ky kampus duhet të përfshi 5 salla për mësimdhënie 5 laboratore për ushtrime të ndara për secilin drejtim (mjedis, prodhim dhe ushqim) dy laboratore hulumtuese për arritje akademike e të cilët duhet të jenë të pajisur me aparatura të avancuara, poashtu të ketë 2 salla për profesor dhe asistent të rregullt dhe angazhuar. Gjithashtu, planifikohet të krijohet e-library, e cila do të pasurohet me literaturë të ndryshme dhe do t'i mundësojë stafit dhe studenteve qasje në literaturë nga distanca. Avancimi dhe mirëmbajtja e sistemit antiplagjiaturë është një tjetër aktivitet, i cili planifikohet të realizohet dhe i cili mundëson avancimin e sistemeve të informacionit. Përveç këtyre, synohet të investohet edhe në avancimin e infrastrukturës së TI, përmes blerjes së pajisjeve të avancuara që lehtësojnë punën e stafit dhe mundësojnë zhvillimin e një procesi mësimor bashkëkohor. Në vazhden e angazhimeve të Agrobiznesit për përmirësimin e infrastrukturës, do të bëhet edhe përshtatja, renovimi dhe mirëmbajtja e objektit ekzistues.

Arritja e objektivit të kësaj fushe do të mbështetet nga rezultatet e mëposhtme:

Rezultati 8.1.:	Krijimi i hapësirave punuese për stafin dhe studentët
Indikatori i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. 5 salla për mësimdhënie 2. 4 laboratore të paisura mirë për ushtrimet (mjedis, prodhim dhe ushqim). 3. 2 laboratorë hulumtuesë 4. 2 salla për profesor dhe asistent të rregullt dhe angazhuar. 5. Rritja e numrit të studentëve të angazhuar në ofrim të shërbimeve. 6. Paisja me aparatura të avancuara, reagjent dhe qelqurina për laboratorët 1, 2, 3, 4. 7. Përmirësimi i kushteve për punë. Përfshirë blerjen e pajisjeve të reja (Kompjuter, laptop, printer tavolinë punë).
Rezultati 8.2.:	Avancimi i sistemeve dhe infrastrukturës së teknologjisë së informacionit sipas standardeve
Indikatori i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përditësimi i Sistemit (SEMS, menaxhimi i kërkesave, web faqja); 2. Krijimi dhe mirëmbajtja e E-library; 3. Avancimi i sistemit antiplagjiatur 4. Avancimi i infrastrukturës së TI-së (Hardware and Software) 5. Ofrimi i qasjes në internet në të gjithë hapësirën e fakultetit
Rezultati 8.3.:	Përmirësimi i kushteve për punë praktike dhe hulumtuese për student dhe staf akademik
Indikatori i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rindertimi i serës dhe pemishtes 2. Infrastrukturë për zyrtar të çështjeve studentore 3. Rritja e hapësirave të bibliotekës (salla e leximit, salla elektronike dhe hapësira e vendosjes së librave); 4. 2 salla për profesor dhe asistent të rregullt dhe angazhuar. 5. Rritja e numrit të studentëve të angazhuar në ofrim të shërbimeve.
Rezultati 8.3.:	Rritja dhe zhvillimi i shërbimeve të bibliotekës

Indikator i rezultatit:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Rritja e fondit te librave (Të gjitha procedurat deri tek furnizimi me libra), 2. sigurimi I librave nga donacionet dhe projektet e ndryshme; 3. Rritja e hapësirave te bibliotekës (salla e leximit, salla elektronike dhe hapësira e vendosjes se librave); 4. Vazhdimi dhe rritja e marrëveshjeve për shfrytëzimin e qasjeve ne bibliotekat elektronike. 5. Krijimi i një baze të dhënash me pjesëmarrësit interesuar.
-------------------------	--

IV. ZBATIMI, MONITORIMI DHE RAPORTIMI

FAG ka të krijuar mekanizma të posaçëm për mbikëqyrje dhe zbatim të prioriteteve strategjike të planit. Këta mekanizma FAG-it i ka të rregulluara me rregulloren “ Komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të planit strategjik të universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë”. FAG-it është i përkushtuar për llogaridhënie dhe transparencë. Çdo aktivitet i këtij plani strategjik do të jetë subjekt i mekanizmave llogaridhënës.

1. Mekanizmat për zbatim

Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik si organ i brendshëm udhëheq me inicimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të këtij plani. Komisioni do të takohet rregullisht në baza mujore dhe do të jetë përgjegjës për zhvillim të planeve mujore të veprimit siç janë të parapara me këtë plan. Planet e veprimit të planit strategjik do të jenë pjesë përbërëse e planeve të punës së dekanit, keshillit te fakultetit, rektorit, senatit dhe Këshillit Drejtues. FAG-it do të sigurohet që zbatimi i Planit Strategjik është proces që gjen zbatim në përditshërimi dhe ndjehet si i tillë nga të gjithë në FAG. Plani Strategjik nuk është vetëm dokument, më shumë se kaq, ai është aktivitet pune për të gjithë.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Planit Strategjik udhëhiqet nga kryesuesi, i cili është njëri ndër anëtarët e Këshillit të fakultetit. Pjesë e këtij komisioni janë edhe: një përfaqësues nga rektorati, respektivisht një prorektor, dekani i njësisë akademike, një përfaqësues i studentëve dhe një përfaqësues nga bashkësia joshumicë (mësimi në gjuhën boshnjake). Mandati i këtij komisioni është 5-vjecar.

Detyrat dhe përgjegjësitë e këtij komisioni janë:

- ✚ Hartimi i planeve vjetore zbatuese;
- ✚ Hartimi i shpenzimeve financiare vjetore të aktiviteteve zbatuese sipas kufijve buxhetorë të paraparë me strategji dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH);
- ✚ Përcjellja dhe mbikëqyrja e projekteve që dalin nga lani strategjik;
- ✚ Mbledhja e informacioneve për çdo projekt të paraparë për zbatim;
- ✚ Kërkesa për raportimet e kryerjes së projekteve dhe hapave përkatës;
- ✚ Rishikimi dhe marrja e masave shtesë për sigurimin e zbatimit të planit strategjik;
- ✚ Hartimi i kërkesave dhe projekteve drejtuar donatorëve për sigurimin e fondeve relevante për zbatimin e strategjisë;
- ✚ Porpozimi për marrjen e masave adekuate në rast të përgjegjësisë subjektive për moszbatimin eventual të projekteve dhe programeve të parapara me strategji.

Komisioni mbledhet së paku një herë në muaj në mbledhje të rregullt. Përmes kryesuesit raporton çdo tre muaj para Këshillit Drejtues rreth zbatimit të planit strategjik.

1.1.Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi është proces i vazhdueshëm, i cili i siguron FAG-it dhe palëve të interesuara arritjen e objektivave të caktuara në këtë plan strategjik. Me qëllim të shpërndarjes së sa më shumë informatave të gjithë palëve për arritjen dhe progresin e objektivave të Planit Strategjik 2023-2026, hartohet Raporti i Progresit, i cili i paraqitet bordit çdo 3 muaj dhe publikohet në ueb faqe të UHZ-së edhe nga njesia akademike çdo fillimvit për vitin paraprak. Monitorimi realisht vlerëson se a janë duke u kryer aktivitetet e parapara brenda periudhës së përcaktuar dhe brenda buxhetit të përcaktuar. Për realizimin e monitorimit, komisioni duhet të bashkëpunojë me menaxhmentin e UHZ-së: Këshillin Drejtues, rektorin, prorektorët, udhëheqësin e njësisë akademike, sekretarin e Përgjithëshëm dhe me drejtorët e administratës. Komisioni mund të kërkojë informata, dokumente dhe të dhëna për shqyrtimin e aktiviteteve të realizuara. Të gjitha trupat dhe strukturat e UHZ-së dhe FAG-it detyrohen t’ia ofrojnë mbështetjen e kërkuar komisionit rreth zbatimit të Planit Strategjik. Kryesuesi i komisionit ndërlidh komisionin me organet drejtuese të universitetit, njësisë akademike, administratën dhe institucionet e tjera, të përfshira në zbatimin të këtij plani. Ndërsa, për përmbushjen e detyrave rreth zbatimit të Planit Strategjik, komisioni dorëzon në Këshillin Drejtues raportin e detajuar vjetor. Për më shumë, ky raport i progresit do të publikohet në ueb faqe të UHZ çdo vit. Në bazë të këtij raporti bëhet edhe vlerësimi i suksesit të zbatueshmërisë së këtyre objektivave. Me fjalë të tjera, vlerësohen të arriturat e çdo aktiviteti, nëse ai po e jep efektin e pritur.

V. Buxheti i strategjisë

Plani Strategjik 2023-2026 i FAG-ut pranë Universitetit “Haxhi Zeka” parasheh që për periudhën katërvjeçare të zbatimit të ketë një buxhet total prej 12,006,897.52 €, për pesë njesitë akademike ku për FAG-it 2,401,379.5 prej të cilave 9,607,547.52 € parashihen të mbulohen nga buxheti i rregullt i UHZ-së, për FAG-it 1,921,509.5 ndërsa 2,400,350.00 € parashihen të mbulohen nga donatorët e ndryshëm, për FAG-it 480,070.00. Në vijim është buxheti i përgjithshëm për katër vite të këtij plani strategjik, i ndarë sipas fushave, sipas viteve dhe sipas burimeve të financimit (i shprehur në Euro), ndërsa në shtojcë gjendet plani i veprimtimit i detajuar buxheti për secilin aktivitetet.

Fusha	Burimi i Financimit	Viti				Totali
		2023	2024	2025	2026	
Menaxhim i brendshëm	Buxheti i UHZ-së	46,000.00	74,460.00	72,460.00	72,460.00	265,380.00
	Donatorët	3,000.00	2,000.00	2,000.00	2,000.00	9,000.00
	Totali	49,000.00	76,460.00	74,460.00	74,460.00	274,380.00
Mësimdhënia dhe mësimnxënia	Buxheti i UHZ-së	136,567.92	170,329.60	204,930.24	136,969.76	648,797.52

	Donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
	Totali	136,567.92	170,329.60	204,930.24	136,969.76	648,797.52
Sigurimi i cilësisë	Buxheti I UHZ-së	22,200.00	35,600.00	79,400.00	14,700.00	151,900.00
